# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2020 – Numri: 121

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E martë, 30 qershor 2020**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 490, datë 23.6.2020 | Për një ndryshim në vendimin nr. 521, datë 20.9.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e procedurës për përzgjedhjen e kandidaturave për kryetar dhe anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik"...... | 7275 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 491, datë 24.6.2020 | Për emërimin në detyrë të kryetarit të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit e të Përpunimit të Ujërave të Ndotura...... | 7275 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 492, datë 24.6.2020 | Për emërim në detyrë...... | 7275 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 494, datë 24.6.2020 | Për një shtesë në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar...... | 7275 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 496, datë 24.6.2020 | Për organizimin, funksionimin, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Strehimit, si dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera shtetërore që veprojnë në këtë fushë...... | 7278 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 497, datë 24.6.2020 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Rrjeti shpërndarës 20 kV nga nënstacioni 110/20 kV Fier i Ri, fiderat 10 deri 12, dhe nënstacioni 110/20 kV, fideri 2, fiderat M1 deri M10"...... | 7280 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 498, datë 24.6.2020 | Për kalimin në përgjegjësi administrimi të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a., të pasurive me nr. 59/1, 59/3, 59/4, 59/5, 59/8, 59/9, 60/6, 701/17, zona kadastrale 1066, Tiranë...... | 7283 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 499, datë 24.6.2020 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 359, datë 4.5.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit, për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në Njësinë Administrative Laç, Bashkia Kurbin"...... | 7299 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 500, datë 24.6.2020 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i objektit "Sistemim, asfaltim, rruga hyrëse Berat" (shtesat)................................... | 7304 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 501, datë 24.6.2020 | Për miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2020................ | 7305 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 24.6.2020 | Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore "Regjistri elektronik i ekspertëve"................................................................................................ | 7326 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 503, datë 24.6.2020 | Për mënyrën e administrimit të informacionit elektronik shëndetësor...... | 7327 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 504, datë 24.6.2020 | Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë.................................... | 7328 |
| Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 17, datë 23.6.2020 | Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar...................................................................................... | 7329 |
| Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 376, datë 18.6.2020 | Për kriteret e dhënies dhe mekanizmin e monitorimit të ndihmës shtetërore të ndërmarrjes sociale............................................................ | 7330 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 97, datë 15.6.2020 | Mbi miratimin e "Kodit të Rrjetit TAP"................................................ | 7336 |
| | Vendim (*i shkurtuar*) për shpalljen e vdekjes të shtetasit Haxhi Tata.... | 7337 |

**VENDIM**
**Nr. 490, datë 23.6.2020**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 521, DATË 20.9.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATURAVE PËR KRYETAR DHE ANËTARË TË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 19/2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 6, të vendimit nr. 521, datë 20.9.2017, të Këshillit të Ministrave, fjalët "... dhe të paktën dy herë në 2 gazeta me tirazhin më të lartë ..." hiqen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 491, datë 24.6.2020**

**PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË KRYETARIT TË KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE TË LARGIMIT E TË PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit e të përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Emërimin e z. Ndriçim Shani në detyrën e kryetarit të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit e të Përpunimit të Ujërave të Ndotura.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 492, datë 24.6.2020**

**PËR EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Aspasjana Kongo emërohet zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 494, datë 24.6.2020**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit

nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet prona nr. 1434, me emërtim “Vendprehje të ushtarakëve grekë, të rënë gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940–1941”, me vendndodhje në Këlcyrë, sipas formularit standard të inventarizimit dhe planrilevimit që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për ta përdorur për zbatimin e projektit “Për ndërtimin e vendprehjeve të ushtarakëve grekë, të rënë gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940–1941”.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**



3. FORMULARI PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTESHME SHTETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)

| | | | |
|---|---|---|---|
| Ministria e Mbrojtjes | | Identifikoi: | Civil Rifat HASA Specialist Pronash ne Sektorin e Pronave |
| Komanda Mbështetëse | | | Civile Leonora AVDO Specialist Pronash ne Sektorin e Pronave |
| Reparti Ushtarak Nr. 4001 | | Supervizoi: | N/Kolonel Ferdi HYRAJ, Shef i Sektorit te Pronave |
| Këlcyrë | | | N/Kolonel Rudina KADRIA Shef I Degës së Financës |
| Fusha e përdorimit të pronës: Varrezë | | Aprovoi: | Komandanti i Komandes Mbeshtetese |
| | | | Gjeneral Brigade Ndriçim **SALLAKU** |

| Nr i Pronës | Zona Kadastrale , Indeksi i Hartës | Nr. i pasurisë | Emërtesa e pronës, Vendndodhja, Shtrirja Gjeografike | Sipas dok. tek. dhe identifikimit në terren, | | Adresa , vendndodhja e komponentëve përbërës | Funksioni për të cilin përdoret prona | Enti me përgjegjësi administrativ | Enti përdorues, Statusi juridik i përdorimit | Të dhëna të tjera, shënime të vecanta |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Komponentet përbërës te pronës | Përmasat e pronës në m2 ose ml | | | | | |
| **1434** | **2131 K-34-125-(21-C), (21-D)** | **364/20 364/21** | **Vendprehje e Ushtarëve Grekë të rënë gjatë luftës Greko-Italiane të viteve 1940-1941** | | **4000 m2** | **Këlcyrë** | Varrezë | MM, Rep.Usht.Nr. 4001 | Rep.Usht. Nr.4001 | Kjo pronë u inventarizua sipas shkresës së Sekretarit të Përgjitshëm të MM nr.2038, datë |
| | | | | Truall | **4000 m2** | | | | | |

**VENDIM**
**Nr. 496, datë 24.6.2020**

**PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË STREHIMIT, SI DHE MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET E TJERA SHTETËRORE QË VEPROJNË NË KËTË FUSHË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 71, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. QËLLIMI

1. Qëllimi i këtij vendimi është miratimi i rregullave të hollësishme, në lidhje me:

a) kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Strehimit, në vijim "KKS";

b) organizimin dhe funksionimin e KKS-së;

c) marrëdhëniet e KKS-së me institucionet e tjera shtetërore, që veprojnë në fushën e strehimit social.

II. KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KKS-së

2. KKS-ja kryesohet nga ministri përgjegjës për strehimin dhe ka në përbërje të tij anëtarë, si më poshtë vijon:

a) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e strehimit është zëvendësministri që mbulon çështjet e strehimit;

b) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat dhe buxhetin është zëvendësministri që mbulon çështjet buxhetore;

c) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale është zëvendësministri që mbulon çështjet sociale;

ç) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet vendore është zëvendësministri që mbulon çështjet vendore;

d) përfaqësues nga grupet e interesit dhe shoqëria civile përzgjidhet drejtuesi i një organizate jofitimprurëse që përfaqëson disa organizata në mbrojtje të interesave të grupeve prioritare që trajton ligji "Për strehimin social". Në mungesë të një organizate përfaqësuese, përzgjedhja bëhet nga çdo organizatë jofitimprurëse që përfaqëson interesat e grupeve prioritare sipas parashikimeve të ligjit "Për strehimin social";

dh) përfaqësues nga shoqata përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore përzgjidhet drejtuesi i kësaj shoqate. Në rastet kur ka më shumë se një shoqatë të tillë, përzgjedhja bëhet me rotacion.

3. Ministri përgjegjës për strehimin, jo më vonë se 1 (një) muaj para mbarimit të mandatit, apo menjëherë sapo krijohet një vend i lirë në anëtarësinë e KKS-së, në rastet e përfundimit të mandatit para kohe, për shkak të mosplotësimit të kërkesave të pikës 2, të këtij vendimi, njofton strukturat përkatëse për caktimin e anëtarit përfaqësues.

4. Njoftimi për paraqitjen e kandidaturave nga shoqatat përfaqësuese të njësive të vetëqeverisjes vendore, grupet e interesit dhe shoqëria civile shpallet në faqen zyrtare të internetit të ministrisë përgjegjëse për strehimin, të Kryeministrisë, si dhe të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, dhe përmban afatin për paraqitjen e kandidaturave, si dhe kriteret e përcaktuara sipas pikës 2, të këtij vendimi.

5. Me rastin e konstituimit për herë të parë të KKS-së, njoftimi bëhet për të gjitha shoqatat përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore pa kufizim, ndërsa njoftimet e radhës përfshijnë edhe njoftimin për përfaqësimin e tyre me rotacion, sipas pikës 2, të këtij vendimi.

6. Ministri përgjegjës për strehimin, kur kandidaturat nga grupet e interesit dhe shoqëria civile janë më shumë se një, ia paraqet Kryeministrit për emërim, pas vlerësimit bazuar në eksperiencën në fushën e strehimit dhe politika sociale, përvojën në projekte, studime, botime dhe veprimtari sociale në fushën e mbështetjes së grupeve të ndryshme sociale.

7. Me rastin e konstituimit për herë të parë të KKS-së, ministri përgjegjës për strehimin i paraqet Kryeministrit të gjitha kandidaturat nga shoqatat përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore, i cili cakton anëtarin përfaqësues. Përfaqësuesi nga shoqatat përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore në mandatet pasardhëse të KKS-së përzgjidhet me rotacion nga një shoqatë tjetër përfaqësuese e vetëqeverisjes vendore që nuk ka qenë e përfaqësuar në KKS.

Përfaqësimi me rotacion në KKS ndiqet në vijimësi për përfaqësuesit nga shoqatat përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KKS-së

8. KKS-ja kryesohet nga kryetari dhe në mungesë të tij nga zëvendëskryetari i KKS-së, i zgjedhur nga KKS-ja. Kryetari thërret mbledhjet e KKS-së, miraton rendin e ditës dhe drejton mbledhjet e KKS-së.

9. Mbledhjet e KKS-së, si rregull, mbahen 1 (një) herë në 3 (tre) muaj dhe jo më pak se 2 (dy) herë në vit. Me kërkesë të kryetarit ose një prej anëtarëve, KKS-ja mund të mblidhet edhe jashtë radhe.

10. Në mbledhjet e KKS-së ftohen të marrin pjesë, pa të drejtë vote, edhe prefektët e qarqeve, përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes vendore, të sektorit privat, të organizatave jofitimprurëse, të institucioneve financiare dhe përfaqësues të komuniteteve të interesuara, sipas kërkesës së kryetarit apo çdo anëtari të KKS-së.

11. KKS-ja i zhvillon mbledhjet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të saj.

12. KKS-ja miraton, me shumicën e votave në prani të më shumë se gjysmës të anëtarëve, rekomandime, të cilat zbardhen si të tilla dhe nënshkruhen nga kryetari. Anëtarët e KKS-së nuk gëzojnë të drejtën e abstenimit në votime, në asnjë rast.

13. Anëtarët e KKS-së kanë për detyrë të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet që zhvillon KKS-ja. Anëtarët e KKS-së nuk mund të përfaqësohen me delegim apo të zëvendësohen në mbledhjet e KKS-së. Çdo anëtar mban komunikimin me sekretariatin teknik të KKS-së për sigurimin e informacioneve të nevojshme për mbledhjet dhe veprimtarinë e KKS-së, si dhe siguron nga institucioni apo subjekti që përfaqëson çdo informacion të nevojshëm mbi çështjet që kërkohen nga KKS-ja.

14. Anëtarët me të drejtë vote të KKS-së shpërblehen për çdo pjesëmarrje në mbledhje, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

15. Në ndihmë të KKS-së krijohet sekretariati teknik i përbërë nga një specialist, pranë ministrisë përgjegjëse për strehimin, i cili luan rolin e sekretarit të KKS-së dhe ka për detyrë:

a) të njoftojë anëtarët për datën, vendin dhe orën e caktuar të mbledhjes së radhës së KKS-së;

b) të përgatisë materialet e mbledhjes dhe, pas miratimit nga kryetari i KKS-së, t'ua shpërndajë anëtarëve, të paktën 5 (pesë) ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes;

c) të mbajë procesverbalin e mbledhjes dhe të sigurojë firmosjen e tij nga çdo anëtar dhe nga vetë sekretari;

ç) të përgatisë raportin e mbledhjes dhe t'ia paraqesë atë për miratim kryetarit të KKS-së;

d) të zbardhë rekomandimet e miratuara në mbledhjet e KKS-së;

dh) të paraqesë pranë kryetarit çështje të ngritura nga struktura përgjegjëse për hartimin e politikave të strehimit në ministrinë përgjegjëse për strehimin, si edhe ato të adresuara kësaj strukture nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat kanë nevojë për t'u adresuar nga KKS-ja.

IV. MARRËDHËNIET E KKS-së ME INSTITUCIONET E TJERA

16. Kryetari i KKS-së dhe, në pamundësi të tij, zëvendëskryetari, është përfaqësuesi i KKS-së në marrëdhënie me institucionet e tjera shtetërore apo subjekte të tjera që veprojnë në fushën e strehimit.

17. Kryetari i raporton çdo vit dhe sa herë kërkohet Kryeministrit për veprimtarinë e KKS-së.

18. Kryetari informon me shkrim institucionet e tjera publike që veprojnë në fushën e strehimit apo fusha të ndërlidhura me strehimin, prefektët dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe çdo subjekt tjetër publik që ushtron veprimtari në fushën e strehimit për rekomandimet e miratuara nga KKS-ja.

19. KKS-ja bashkëpunon me organet e tjera të administratës shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura dhe partnerë të tjerë për procesin e këshillimit të linjave kryesore në sektorin e strehimit, sipas ligjit "Për strehimin social".

20. KKS-ja, në ushtrim të kompetencave të saj, ka të drejtë të kërkojë informacione nga ministritë, institucionet qendrore të administratës shtetërore, institucionet e pavarura, prefektët, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e tjera publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

21. Me kërkesë të KKS-së, institucionet publike që ushtrojnë kompetenca në fushën e strehimit social apo të lidhura me të, marrin pjesë në grupe pune teknike për çështje që kërkojnë trajtim teknik ose për kryerjen e studimeve që kërkohen nga KKS-ja. Grupet e punës raportojnë për realizimin e

detyrave pranë kryetarit të KKS-së dhe drejtuesit të institucioneve të tyre.

V. DISPOZITË E FUNDIT

22. Ngarkohet ministria përgjegjëse për strehimin, ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe ministria përgjegjëse për çështjet vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM**
**Nr. 497, datë 24.6.2020**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI "RRJETI SHPËRNDARËS 20 kV NGA NËNSTACIONI 110/20 kV FIER I RI, FIDERAT 10 DERI 12, DHE NËNSTACIONI 110/20 kV, FIDERI 2, FIDERAT M1 DERI M10"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rrjeti shpërndarës 20 kV nga nënstacioni 110/20 kV Fier i Ri, fiderat 10 deri 12, dhe nënstacioni 110/20 kV, fideri 2, fiderat M1 deri M10".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës së kompensimit përkatës që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit tokë "Arë" dhe "Truall", me vlerë 1 382 390.31 (një milion e treqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e nëntëdhjetë pikë tridhjetë e një) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 382 390.31 (një milion e treqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e nëntëdhjetë pikë tridhjetë e një) lekësh, të përballohet nga fondet e buxhetit të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2020, për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë si dhe hartën treguese të regjistrimit, Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.

8. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara në kontratën e lidhur nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., me sipërmarrësin e punimeve.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, në bashkëpunim me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë në favor të shtetit (OSHEE).

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, si dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË PROJEKTIT "RRJETI SHPERNDARËS 20 KV NGA NËNSTACIONI 110/20 KV FIER I RI, FIDERAT 10 DERI 12 DHE NËNSTACIONI 110/20 KV FIDERI 2 FIDERAT M1 DERI M10**

**Qarku: Fier; Bashkia Fier**

**Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: Tokë 'Arë' dhe 'Truall'**

| Nr. | Numri i Kabinës | Të dhëna për pronësinë | | | | | | | Sip. që shpronësohet | Çmimi Lek/m² | Vlera e Shpronesimit në Lekë | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Emri | Atësia | Mbiemri | Zona Kadastrale | Nr. pasurisë | Lloji i pasurisë | Sasia sip. pronës m² | | | | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 |
| FIER , DRIZE, ZONA KADFASTRALE 1557 | | | | | | | | | | | | |
| 1 | K01/12 | Shtet | | | 1557 | 262/42 | Rruge | 1468 | 9.24 | | | Konfirmuar nga ZVRPP |
| 2 | K01/12 | Dhimitraq | Qendro | Shaka | 1557 | 262/75 | Are | 280 | 9.24 | 269 | 2485.56 | Konfirmuar nga ZVRPP |
| 3 | KO1/12 | Shtet | | | 1557 | 262/76 | are | 157 | 9.24 | | | Konfirmuar nga ZVRPP |
| FIER,MBYET ZONA KADASTRALE 2637 | | | | | | | | | | | | |
| 4 | K01/11 | Naile | Adem | Tahiri | 2637 | 72/1 | Are | 1000 | 9.87 | 269 | 2655.03 | Konfirmuar nga ZVRPP, ka shenimin "pa çertifikate pronesie" |
| 5 | K04/10 | Bylyre | Cobo | Bushi | 2637 | 62/26 | Are | 5936 | 9.24 | 269 | 2485.56 | Konfirmuar nga ZVRPP, ka shenimin "pa çertifikate pronesie" |
| 6 | K04/10 | Ymer | Sefer | Bushi | 2637 | 62/27 | Are | 2852 | 9.24 | 269 | 2485.56 | Konfirmuar ZVRPP |
| FIER,QYTET ZONA KADASTRALE 8532 | | | | | | | | | | | | |
| 7 | K04/11 | Bashke pronare Prifti | | | 8532 | 7/494 | **Truall** | **350** | **9.24** | **12458** | **115111.92** | Konfirmuar ZVRPP |
| 8 | K04/11 | Shtet | | | 8532 | 7/495 | Truall | 191 | 9.24 | | | Konfirmuar nga ZVRPP |
| FIER,QYTET ZONA KADASTRALE 8531 | | | | | | | | | | | | |
| 9 | **K05/10** | Erion | Baki | Shehaj | 8531 | 9/481 | Truall | 300 | 9.24 | 12458 | 115111.92 | Konfirmuar nga ZVRPP |
| 10 | **K05/10** | Shtet | | | 8531 | 9/482 | Truall | 1225.89 | 9.24 | | | Konfirmuar nga ZVRPP |
| FIER ,SHEQ I MADH ZONA KADFASTRALE 3981 | | | | | | | | | | | | |
| 11 | K01/M3 | Pandeli | Dudi | Kola | 3981 | 115/1 | ARE | 650 | 9.24 | 269 | 2485.56 | Konfirmuar nga ZVRPP |
| 12 | K02/M3 | Aleks | Miti | Llazi | 3981 | 115/16 | ARE | 3983 | 9.24 | 269 | 2485.56 | Konfirmuar nga ZVRPP |
| 13 | K02/M3 | SHTET | | | 3981 | 115/35 | RRUGE | 1927 | | | | Konfirmuar nga ZVRPP |
| 14 | K05/M4 | Astrit | Faik | Hoxhaj | 3981 | 68/1 | ARE | 2000 | 9.24 | 269 | 2485.56 | Konfirmuar nga ZVRPP |
| 15 | K07/M3 | Aleksander | Petraq | Doko | 3981 | 183/161 | ARE | 1677 | 9.24 | 269 | 2485.56 | Konfirmuar nga ZVRPP |
| 16 | K07/M3 | Leonard | Petraq | Doko | 3981 | 183/162 | ARE | 1677 | 9.24 | 269 | 2485.56 | Konfirmuar nga ZVRPP |
| 17 | K08/M3 | Agron | Miti | Prifti | 3981 | 183/4 | ARE | 2760 | 9.24 | 269 | 2485.56 | Konfirmuar nga ZVRPP |
| 18 | K10/M3 | Ferdinand | Skender | Ferko | 3981 | 154/22 | ARE | 12014 | 9.24 | 269 | 2485.56 | Konfirmuar nga ZVRPP |
| 19 | K04/M3 | Shtet | | | 3981 | 117/36 | Rruge | 1455 | 9.24 | | | Konfirmuar nga ZVRPP |
| 20 | K04/M3 | Shtet | | | 3981 | 430 | Kanal | 2532 | 9.24 | | | Konfirmuar nga ZVRPP |
| FIER ZONA KADFASTRALE 8532 | | | | | | | | | | | | |
| 21 | 02/M6 | Ferrik | Refat | Avdiaj | 8532 | 9/737 | Truall | 246.21 | 9.24 | 12458 | 115,111.92 | Konfirmuar nga ZVRPP |
| 22 | 02/M6 | Pronar i pavertetuar | | | 8532 | 9/738 | Truall | 246.1 | 9.24 | 12458 | 115111.92 | Konfirmuar nga ZVRPP |
| 23 | K07/M4 | Elsa | Selim | Baçi | 8532 | 3/655 | Truall | 194 | 9.24 | 12458 | 115111.92 | Konfirmuar nga ZVRPP |
| 24 | K07/M4 | Shtet | | | 8532 | 3/656 | Truall | 1544 | 9.24 | | | |
| 25 | K06/M6 | Elidon Tare Nivila Blerta Tajar Hoxhaj | | | 8532 | 1/873 | Truall | 750 | 9.24 | 12458 | 115111.92 | Konfirmuar nga ZVRPP |
| 26 | K01/M2 | OSHEE | | | 8532 | 8/535 | KE | 9.07 | | | | |
| 27 | K01/M2 | Pronar i pavertetuar | | | 8532 | 8/536 | truall | 176.3 | 9.24 | 12458 | 115111.92 | Konfirmuar nga ZVRPP |
| 28 | K02/M2 | Themi | Koli | Prifti | 8532 | 8/528 | truall | 200 | 9.24 | 12458 | 115111.92 | Komfirmuar nga Zvrpp |
| 29 | K02/M2 | Pronar i pavertetuar | | | 8532 | 8/529 | truall | 194 | 9.24 | 12458 | 115111.92 | Komfirmuar nga Zvrpp |
| 30 | K03/M2 | Shtet | | | 8532 | 8/186 | rruge | 12484 | 9.24 | | | Konfirmuar nga ZVRPP |

| Nr. | Numri i Kabinës | Të dhëna për pronësinë | | | | | | | Sip. që shpronësohet | Çmimi Lek/m² | Vlera e Shpronesimit në Lekë | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Emri | Atësia | Mbiemri | Zona Kadastrale | Nr. pasurisë | Lloji i pasurisë | Sasia sip. pronës m² | | | | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 |
| 31 | K08/M4 | Pronar i paverteuar | | | 8532 | 2/89 | truall | 2528 | 9.24 | 12458 | 115111.92 | Konfirmuar nga ZVRPP |
| | FIER ZONA KADFASTRALE 8533 | | | | | | | | | | | |
| 32 | K09/M6 | Qani | Maksut | Dika | 8533 | 2/293 | Truall | 100 | 9.24 | 11026 | 101880.24 | Konfirmuar nga ZVRPP |
| 33 | K09/M6 | Omer | Maksut | Dika | 8533 | 2/292 | Truall | 100 | 9.24 | 11026 | 101880.24 | Konfirmuar nga ZVRPP |
| 34 | K05/M6 | Shtet | | | 8533 | 2/264 | truall | 8752 | 9.24 | | | Konfirmuar nga ZVRPP |
| Total Shpronesimi | | | | | | | | | 213.15 | | 1,382,390.31 | |

**VENDIM**
**Nr. 498, datë 24.6.2020**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME TIRANË SHA, TË PASURIVE ME NR. 59/1, 59/3, 59/4, 59/5, 59/8, 59/9, 60/6, 701/17, ZONA KADASTRALE 1066, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a., të pasurive me nr. 59/1, 59/3, 59/4, 59/5, 59/8, 59/9, 60/6, 701/17, zona kadastrale 1066, me sipërfaqe totale 48207 $m^2$, Tiranë, sipas planit të rilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pasuritë e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, do të përdoren për ushtrimin e veprimtarisë së shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a.

3. Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a., i ndalohet t'i tjetërsojë apo t'ua japë në përdorim të tretëve pasuritë e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a. dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**




TË DHËNAT E BLLOKUT KADASTRAL
OBJEKT PËRMIRËSIM / PËRDITËSIM
DHE AFISHIM PUBLIK
ZONA KADASTRALE: 1066 (BABRRU)
SHKALLA 1:2000
INDEKSI I HARTËS: K-34-88-(235-A)
NR. I BLLOKUT TË PASURIVE 59
ADRESA E BLLOKUT TË PASURIVE: Bashkia KAMËZ
Qytet,Bashki,Fshat KAMËZ, KAMËZ, BABRRU.
SHËNIME TEKNIKE
LEGJENDA
Kufiri i pasurisë
Kufiri i ndërtesës
Kufiri i rrugës/kanalit
Kufiri i zonës kadastrale
Kufiri i bllokut 59
Z.K. 1066
PËRMBAJTJA E FLETËS
A - HTR ekzistuese e punës së A.SH.K.
Fleta nr.1
PËRGATITI
59/1
59/8
59/5
59/4
59/9
59/13
59/10

PLAN VENDOSJA E OBJEKTEVE NE IMPJANTIN E BOVILLES SHK.1:2500



PLAN RILEVIMI

EMERTIMI I OBJEKTIT: PLAN VENDOSJA E OBJEKTEVE NE IMPJANTIN E BOVILLES SIPAS VENDIMIT TE K.RR.T.SH Nr.44 Date 27.12.1994

PRONARI I TRUALLIT:

KERKUESI: UJESJELLES-KANALIZIME Sh.a Tirane

| ADRESA E PASURISE | POZICIONI KADASTRAL |
| --- | --- |
| FSHATI/KOMUNA: Babrru | ZONA KADASTRALE: 1066 |
| QYTETI: TIRANE | NR I PASURISE: 59/4,59/5, 59/8 ,59/1 |
| | INDEKSI I HARTES:K-34-88-(235-A) |

| KUFIZIMET: | DISTANCAT: |
| --- | --- |
| VERI: | VERI: |
| JUG: | JUG: |
| LINDJE: | LINDJE: |
| PERENDIM: | PERENDIM: |

TREGUESIT E PARCELES:

Siperfaqja e truallit (shesh ndertimi) = 35000 m2

DATA E PERGATITJES: 16.04.2019

PUNOI: Ing. topograf SOTIRAQ THAKA

LICENSE: T.1267/1,Date 30.11.2017

I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Vol 1, Fq 170

Kadastrale: 1066 NR.i PASURISE: 59/1

--> Vijon nga Vol ____, Fq ____

Indeksi i Hartes: K-34-100-(235-A)

Vijon në: Vol ____, Fq. ____ deri në: Vol ____, Fq. ____ -->

Adresa e Pasurisë: Rrethi TIRANË Q/F BABRRU

PERFUNDIMTARE (data): 15/8/1999

Rr/L ____ P/G ____ SH ____ K ____ Ap 0

- SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: PYLL Brenda V.K.N.: 0, Ref: ____

| Sip. Totale e Pasurisë: | Nga Sip. Totale: sa Trual | Nga Sip. Truall: sa Ndërtesë | Per pjesen e përbashkët: |
|---|---|---|---|
| 1. 17 000,00 m$^2$<br>Ref. LN JANAR 1 | 1. 0,00 m$^2$<br>Ref. LN JANAR 1 | 1. 0,00 m$^2$<br>Ref. LN JANAR | PALLAT<br>Kuota e pjesmarrjes: ____ % |
| 2. ____ m$^2$<br>Ref. ____ | 2. ____ m$^2$<br>Ref. ____ | 2. ____ m$^2$<br>Ref. ____ | Nr i Pasurise (pallat): |
| 3. ____ m$^2$<br>Ref. ____ | 3. ____ m$^2$<br>Ref. ____ | 3. ____ m$^2$<br>Ref. ____ | |
| 4. ____ m$^2$<br>Ref. ____ | 4. ____ m$^2$<br>Ref. ____ | 4. ____ m$^2$<br>Ref. ____ | Vol ____ Faqe. ____ |

Përshkrim i veçantë:

- SEKSIONI I PRONESISE

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Emri Atësia Mbiemri | Nr. Pasap | I/F/B | Adresa e Pronarit | Shuma e Paguar | Data e Lësh. Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| LN1998 | 11/01/1999 | SHTET | | I | VORE Hyrja 1 Apartamenti : | 0 | | | |

Shënim: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - përfaqesues i familjes; B - bashkëpronar (%)

SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Tipi | Përshkrimi | Data e Lesh. Certifikates | Shenime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 00004460 | 05/02/2019 | 14 | MBI KETE PASURI POZICIONOHET NDERTESA ME NR 59/1-ND1 VOL 26 FQ 131 | | L.LEG | |
| 00004459 | 05/02/2019 | 14 | MBI KETE PASURI POZICIONOHET NDERTESA ME NR 59/1-ND VOL 26 FQ 130 | | L.LEG | |

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Tipi | Përshkrimi | Data e Lesh. Certifikates | Shenime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME DIT
Adresa: Rruga 11 Nentori,Lagj. Brigada 17 S (prane Prefektures)

dit, me ____ / 6 / 6 2019

SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tone

Në regjistrin Vol 1, Faqe 170, Zona Kadastrale 1066, Qyteti Dit

REGJISTRUESI

OFICER GJIROKASTER

I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Vol 3, Fq. 95

Kadastrale: 1066 NR.i PASURISE: 59/3

--> Vijon nga Vol ______, Fq. ______

Indeksi i Hartes: K-34-100-(235-A)

Vijon në: Vol ______, Fq. ______ deri në: Vol ______, Fq. ______ -->

Adresa e Pasurisë: Rrethi TIRANË BABRRU

PERFUNDIMTARE (data): 15/8/1999

Rr/L ______ P/G ____ SH ____ K ____ Ap 0

Përshkrim i veçantë:

- SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: ARE Brenda V.K.N. : 0, Ref: ______

| Sip. Totale e Pasurisë: | Nga Sip. Totale: sa Trual | Nga Sip. Truall: sa Ndërtesë | Per pjesen e përbashkët : |
|---|---|---|---|
| 1. 3 075,00 $m^2$<br>Ref LN.JANAR.! | 1. 0,00 $m^2$<br>Ref LN.JANAR.! | 1. 0,00 $m^2$<br>Ref LN.JANAR.! | PALLAT |
| 2. ______ $m^2$<br>Ref ______ | 2. ______ $m^2$<br>Ref ______ | 2. ______ $m^2$<br>Ref ______ | Kuota e pjesmarrjes:<br>______ % |
| 3. ______ $m^2$<br>Ref ______ | 3. ______ $m^2$<br>Ref ______ | 3. ______ $m^2$<br>Ref ______ | Nr i Pasurise (pallat): |
| 4. ______ $m^2$<br>Ref ______ | 4. ______ $m^2$<br>Ref ______ | 4. ______ $m^2$<br>Ref ______ | Vol ____ Faqe. ____ |

- SEKSIONI I PRONESISE

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Emri Atësia Mbiemri | Nr. Pasap | I/F/B | Adresa e Pronarit | Shuma e Paguar | Data e Lësh. Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| LN98 | 03/02/1999 | SHTET | | I | VORE Hyrja 1 Apartamenti ! | 0 | 03/02/1999 | | |

Kolona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik, F - përfaqesues i familjes, B - bashkëpronar (%)

D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE,
SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Tipi | Pershkrimi | Data e Lesh. Çertifikates | Shenime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Tipi | Pershkrimi | Data e Lesh. Çertifikates | Shenime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME DIT
Adresa: Rruga 11 Nentori,Lagj. Brigada 17 S (prane Prefektures)

dit, me ____/ 6 / 6 2019

SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tone

Në regjistrin Vol 3, Faqe 95, Zona Kadastrale 1066, Qyteti Dit

REGJISTRUESI
OFICER G[illegible]IROKASTER

KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Vol 1, Fq. 172

Kadastrale: 1066 NR. i PASURISE: 59/4

–> Vijon nga: Vol ______, Fq. ______

Indeksi i Hartes: K-34-100-(235-A)

Vijon në: Vol ______, Fq. ______ deri në: Vol ______, Fq. ______ –>

Adresa e Pasurisë: Rrethi TIRANË Q/F BABRRU

PERFUNDIMTARE (data): 15/8/1999

Rr/L ______ P/G ____ SH ____ K ____ Ap 0

Përshkrim i veçantë:

- SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: SHESH Brenda V.K.N.: ______, Ref: ______

| Sip. Totale e Pasurisë: | Nga Sip. Totale: sa Trual | Nga Sip. Truall: sa Ndërtesë | Per pjesen e përbashkët: |
|---|---|---|---|
| 1. 7 688,00 $m^2$ Ref. LN JANAR 1 | 1. 0,00 $m^2$ Ref. LN JANAR 1 | 1. 0,00 $m^2$ Ref. LN JANAR | PALLAT |
| 2. 0,00 $m^2$ Ref. - | 2. 0,00 $m^2$ Ref. - | 2. 0,00 $m^2$ Ref. - | Kuota e pjesmarrjes: ______ % |
| 3. ______ $m^2$ Ref. ______ | 3. ______ $m^2$ Ref. ______ | 3. ______ $m^2$ Ref. ______ | Nr i Pasurise (pallat): |
| 4. ______ $m^2$ Ref. ______ | 4. ______ $m^2$ Ref. ______ | 4. ______ $m^2$ Ref. ______ | Vol ____ Faqe ____ |

- SEKSIONI I PRONESISE

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Emri Atësia Mbiemri | Nr. Pasap | I/F/B | Adresa e Pronarit | Shuma e Paguar | Data e Lësh. Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| LN1998 | 11/01/1999 | SHTET | | I | VORE Hyrja 1 Apartamenti : | 0 | | | |

Shënim: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - përfaqesues i familjes, B - bashkëpronar (%)

D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Tipi | Pershkrimi | Data e Lesh. Certifikates | Shenime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Tipi | Pershkrimi | Data e Lesh. Certifikates | Shenime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME DIT
Adresa: Rruga 11 Nentori,Lagj. Brigada 17 S (prane Prefektures)

dit, me ___/ 6 / 6 2019

SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tone

Në regjistrin Vol 1, Faqe 172, Zona Kadastrale 1066, Qyteti Dit

REGJISTRUESI

OFICER GJIROKASTER

Nr. 519, Date 7.11.1994

KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol 1, Fq. 173

...I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

--> Vijon nga: Vol ____, Fq. ____

Vijon në: Vol ____, Fq. ____ deri në: Vol ____, Fq. ____ -->

Zona Kadastrale: 1066 NR.i PASURISE: 59/5

Indeksi i Hartes: K-34-100-(235-A)

Adresa e Pasurisë: Rrethi TIRANË Q/F BABRRU

PERFUNDIMTARE (data): 15/8/1999

Rr/L ____ P/G ____ SH ____ K ____ Ap 0

Përshkrim i veçantë:

SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: SHESH Brenda V.K.N. : 0 , Ref: ____

| Sip. Totale e Pasurisë: | Nga Sip. Totale: sa Trual | Nga Sip. Truall: sa Ndertes( |
|---|---|---|
| 1. 40 312,00 m² Ref. LN JANAR 1 | 1. 0,00 m² Ref. LN JANAR 1 | 1. 0,00 m² Ref. LN JANAR 1 |
| 2. ____ m² Ref. ____ | 2. ____ m² Ref. ____ | 2. ____ m² Ref. ____ |
| 3. ____ m² Ref. ____ | 3. ____ m² Ref. ____ | 3. ____ m² Ref. ____ |
| 4. ____ m² Ref. ____ | 4. ____ m² Ref. ____ | 4. ____ m² Ref. ____ |

Per pjesen e përbashkët: PALLAT

Kuota e pjesmarrjes: ____ %

Nr i Pasurise (pallat):

Vol ____ Faqe ____

SEKSIONI I PRONESISE

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Emri Atësia Mbiemri | Nr. Pasap | I/F/B | Adresa e Pronarit | Shuma e Paguar | Data e Lësh. Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| LN1998 | 11/01/1999 | SHTET | | I | VORE Hyrja 1 Apartamenti : | 0 | | | |

Shënim: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - përfaqësues i familjes; B - bashkëpronar (%)

D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Tipi | Përshkrimi | Data e Lësh Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| [illegible] | 22/01/2018 | RB | MBI KETE PASURI POZICIONOHET NDERTESA ME NR 995 ND, VOL 124, FQ 77 | | L.LEG | |

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Tipi | Përshkrimi | Data e Lësh Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME DIT
Adresa: Rruga 11 Nentori,Lagj. Brigada 17 S (prane Prefektures)

dit, me ___ / 6 / 6 2019

SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tone

Në regjistrin Vol 1, Faqe 173, Zona Kadastrale 1066, Qyteti Dit

REGJISTRUESI

PROKURORIA TIRANE

Nr. 519, Datë 7.11.1994

# KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Vol 1, Fq. 175

Kadastrale: 1066 NR.i PASURISE: 59/8

--> Vijon nga: Vol ____, Fq. ____

Indeksi i Hartes: K-34-100-(235-A)

Vijon në: Vol ____, Fq. ____ deri në: Vol ____, Fq. ____ -->

Adresa e Pasurisë: Rrethi TIRANË Q/F BABRRU

PERFUNDIMTARE (data): 15/8/1999

Rr/L ____ P/G ____ SH ____ K ____ Ap 0

Përshkrim i veçantë:

KSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

i Pasurisë: SHESH Brenda V.K.N.: ____, Ref: ____

| Totale e Pasurisë: | Nga Sip. Totale: sa Trual | Nga Sip. Truall: sa Ndërtesë | Per pjesen e perbashket: |
|---|---|---|---|
| 5 438,00 m² LN JANAR 1 | 1. 0,00 m² Ref. LN JANAR 1 | 1. 0,00 m² Ref. LN JANAR | PALLAT |
| 0,00 m² - | 2. 0,00 m² Ref. - | 2. 0,00 m² Ref. - | Kuota e pjesmarrjes: ____ % |
| ____ m² | 3. ____ m² Ref. ____ | 3. ____ m² Ref. ____ | Nr i Pasurise (pallat): |
| ____ m² | 4. ____ m² Ref. ____ | 4. ____ m² Ref. ____ | Vol ____ Faqe ____ |

SEKSIONI I PRONESISE

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Emri Atësia Mbiemri | Nr. Pasap | I/F/B | Adresa e Pronarit | Shuma e Paguar | Data e Lësh. Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| LN1998 | 11/01/1999 | SHTET | | 1 | VORE Hyrja 1 Apartamenti : | 0 | | | |

Shënim: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik F - përfaqësues i familjes; B - bashkëpronar (%)

## D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Tipi | Përshkrimi | Data e Lësh. Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |

## E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Tipi | Përshkrimi | Data e Lësh. Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME DIT

Adresa: Rruga 11 Nentori, Lagj. Brigada 17 S (prane Prefektures)

dit, me ___/ 6 / 6 2019

SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tone

Në regjistrin Vol 1, Faqe 175, Zona Kadastrale 1066, Qyteti Dit

REGJISTRUESI

OFICER GJ ROKASTER

KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Vol 3, Fq. 91

Kadastrale: 1066 NR.i PASURISE: 701/17

--> Vijon nga Vol ____, Fq. ____

Indeksi i Hartes: K-34-100-(235-C)

Vijon në: Vol ____, Fq. ____ deri në: Vol ____, Fq. ____ -->

Adresa e Pasurisë: Rrethi TIRANË Q/F BABRRU

PERFUNDIMTARE (data): 15/8/1999

Rr/L ____ P/G ____ SH ____ K ____ Ap 0

- SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: PYLL Brenda V.K.N.: 0, Ref: ____

| Sip. Totale e Pasurisë: | Nga Sip. Totale: sa Trual | Nga Sip. Truall: sa Ndërtesë |
|---|---|---|
| 1. 5 562,00 $m^2$ Ref. LN.JANAR.! | 1. 0,00 $m^2$ Ref. LN.JANAR.! | 1. 0,00 $m^2$ Ref. LN.JANAR.! |
| 2. ____ $m^2$ Ref. ____ | 2. ____ $m^2$ Ref. ____ | 2. ____ $m^2$ Ref. ____ |
| 3. ____ $m^2$ Ref. ____ | 3. ____ $m^2$ Ref. ____ | 3. ____ $m^2$ Ref. ____ |
| 4. ____ $m^2$ Ref. ____ | 4. ____ $m^2$ Ref. ____ | 4. ____ $m^2$ Ref. ____ |

Per pjesen e përbashkët: PALLAT

Kuota e pjesmarrjes: ____ %

Nr i Pasurise (pallat): ____

Vol ____ Faqe ____

Përshkrim i veçantë:

- SEKSIONI I PRONESISE

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Emri | Atësia | Mbiemri | Nr. Pasap | I/F/B | Adresa e Pronarit | Shuma e Paguar | Data e Lesh. Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| LN98 | 03/02/1999 | SHTET | | | | I | VORE Hyrja 1 Apartamenti ! | 0 | 03/02/1999 | | |

Shënim: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - përfaqesues i familjes; B - bashkëpronar (%)

D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Tipi | Përshkrimi | Data e Lësh. Certifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Tipi | Përshkrimi | Data e Lësh. Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME DIT
Adresa: Rruga 11 Nentori,Lagj. Brigada 17 S (prane Prefektures)
dit, me ___/6___/6___2019
SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tone
Në regjistrin Vol ___3___, Faqe ___91___, Zona Kadastrale ___1066___, Qyteti Dit

REGJISTRUESI
OFICER GJIROKASTER

K. M. Nr. 319, Date 7.111994

# KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol 2, Fq 211

- SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

--> Vijon nga: Vol ____, Fq ____

Zona Kadastrale: 1066 NR.i PASURISE: 60/6

Vijon në: Vol ____, Fq ____ deri në: Vol ____, Fq ____ -->

Indeksi i Hartes: K-34-100-(235-A)

PERFUNDIMTARE (data): 15/8/1999

Adresa e Pasurisë: Rrethi TIRANE Q/F BABRRU

Rr/L ____ P/G ____ SH ____ K ____ Ap 0

Përshkrim i veçantë:

- SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: ARE Brenda V.K.N.: 0, Ref: ____

| Sip. Totale e Pasurisë: | Nga Sip. Totale: sa Truall | Nga Sip. Truall: sa Ndërtes | Per pjesën e përbashkët: |
|---|---|---|---|
| 1. 0,00 m² Ref. - | 1. 0,00 m² Ref. - | 1. 0,00 m² Ref. - | PALLAT |
| 2. 1 562,00 m² Ref. LNJANAR1! | 2. 0,00 m² Ref. LNJANAR1! | 2. 0,00 m² Ref. LNJANAR1! | Kuota e pjesmarrjes: ____ % |
| 3. ____ m² Ref. ____ | 3. ____ m² Ref. ____ | 3. ____ m² Ref. ____ | Nr i Pasurise (pallat): |
| 4. ____ m² Ref. ____ | 4. ____ m² Ref. ____ | 4. ____ m² Ref. ____ | Vol ____ Faqe ____ |

- SEKSIONI I PRONESISE

| Nr.Dok | Data Regjistrimit | Emri Atësia Mbiemri | Nr. Pasap | I/F/B | Adresa e Pronarit | Shuma e Paguar | Data e Lësh. Çertifikatës | Shënime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| LNJANAR98 | 04/02/1999 | SHTET | | I | VORE Hyrja 1 Apartamenti 5 | 0 | | | |

Shenim: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik, F - përfaqesues i familjes, B - bashkëprouar (%)

**VENDIM**
**Nr. 499, datë 24.6.2020**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 359, DATË 4.5.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, DHE SHKËMBIMIN E PRONËS, NË FUNKSION TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT, PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE LAÇ, BASHKIA KURBIN"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", të vendimit nr.7, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për kushtet dhe procedurat për shpronësimet dhe/ose shkëmbimin e pronës për interes publik në funksion të procesit të rindërtimit", të vendimit nr. 8, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për caktimin e kushteve dhe të kritereve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje", si dhe të vendimit nr. 46, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësinë administrative Laç, Bashkia Kurbin, dhe caktimin e Entit Kombëtar të Banesave si njësi zbatuese", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 359, datë 4.5.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në tabelën bashkëlidhur vendimit shtohen numrat rendorë 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35 dhe te pasuritë pronë shtet hiqen pasuritë me numrat rendorë 10, 25, 33, 37, përkatësisht, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pikat 3 dhe 4 ndryshohen si më poshtë vijon:

"3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës së kompensimit përkatës që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit tokë "arë", "kultura bujqësore", si dhe për pasuritë e llojit tokë "truall", referuar shënimit në tabelë, me vlerë 44 889 589 (dyzet e katër milionë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 44 889 589 (dyzet e katër milionë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekësh, të përballohet nga zëri "Fondi për rindëritimin", i miratuar për vitin 2020.".

3. Pika 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"14. Shpenzimet procedurale, në vlerën 140 000 (njëqind e dyzet mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.".

4. Pas pikës 15 shtohet pika 15/1, me këtë përmbajtje:

"15/1. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të kryejë kalimin në pronësi të Entit Kombëtar të Banesave të të gjitha pronave shtet të listuara në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.".

5. Pika 16 ndryshohet si më poshtë vijon:

"16. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij vendimi.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

# LISTA EMËRORE PËRFUNDIMTARE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, DUKE KOMPENSUAR NË VLERË OSE DUKE SHKËMBYER PASURINË PRIVATE ME NJË PASURI TJETËR TË ARDHSHME, TË PALUAJTSHME, NË PRONËSI TË SHTETIT PËR ZHVILLIMIN E DETYRUAR "ZONË TË RE PËR ZHVILLIM" NË ZONËN 1/1, NJËSIA ADMINISTRATIVE LAÇ, BASHKIA KURBIN

| Nr. | PRONARI: Emri | PRONARI: Atësia | PRONARI: Mbiemri | TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas ASHK): ZK | Nr.Pas | Lloji | Sip. Totale (m2) | Shpronësim tokë "arë": Sip. (m2) | Çmimi (lekë/m2) | Vlera (lekë) | Shpronësim tokë "truall": Sip. (m2) | Çmimi (lekë/m2) | Vlera (lekë) | Ndërtesë banimi (shtëpi): Sip. Ndërt. konf. ASHK (m2) | Çmimi mes. sh/blerjeve sipas zvrpp (l/m2) | Vlera (lekë) | Ndërtesë jo banimi: Sip. Nd. konf.nga ASHK (m2) | Vlera sipas Preventivit (lekë) | Vlera e Kulturës bujqësore dhe Drufrutorë: Vlera (lekë) per shperblim | VLERA TOTALE (lekë) | VLERA E KOMPENSIMIT (lekë) | VLERA E SHKEMBIMIT (lekë) | Konpensim/Shkëmbim | SHËNIME |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| PRONE PRIVAT | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | Ndue | Pashk | Suti | 2364 | 3/714/ND | Ndertese | 325.28 | | | | | | | 325.28 | 27,863 | 9,063,276.64 | | | | 9,063,276.64 | | 9,063,276.64 | Shkembim | Konfirmuar ASHK, 6.02.2020 |
| 2 | Agostin | Preng | Bardhi | 2364 | 4/801 | Truall | 5,808 | | | | 618 | 1,620 | 1,001,160 | | | - | | | | 1,001,160 | 1,001,160 | | Kompesim ne vlere | Konfirmuar ASHK, 6.02.2020 |
| 3 | Vlash | Nikoll | Suti | 2364 | 3/720/2 | Are | 600 | 600 | 321 | 192,600 | | | - | | | - | | | 167,326 | 359,926 | 359,926 | | Kompesim ne vlere | Konfirmuar ASHK, 4.02.2020 |
| 4 | Emiljan Genti Anila Frange | LekLek Lek Kol | SutiSuti VelaSuti | 2364 | 3/714/1 | Are | 2,100 | 2,100 | 321 | 674,100 | | | - | | | - | | | 105,100 | 779,200 | 779,200 | | Kompesim ne vlere | Konfirmuar ASHK, 4.02.2020 |
| 5 | Ndue | Pashk | Suti | 2364 | 3/720/6 | Are | 1,809 | 1,809 | 321 | 580,689 | | | - | | | - | | | 57,014 | 637,703 | 637,703 | | Kompesim ne vlere | Konfirmuar ASHK, 4.02.2020 |
| 6 | Vlash | Nikoll | Suti | 2364 | 3/716/1 | Are | 1,550 | 1,550 | 321 | 497,550 | | | - | | | - | | | | 497,550 | 497,550 | | Kompesim ne vlere | Konfirmuar ASHK, 5.02.2020 |
| 7 | Ndue | Pashk | Suti | 2364 | 3/713/2 | Are | 942 | 942 | 321 | 302,382 | | | - | | | - | | | | 302,382 | 302,382 | | Kompesim ne vlere | Konfirmuar ASHK, 3.02.2020 |
| 8 | Zef | Pal | Suti | 2364 | 3/827-ND | Ndertese | 104.43 | | | - | | | - | 104.43 | 27,863 | 2,909,733.09 | | | | 2,909,733.09 | | 2,909,733.09 | Shkembim | Konfirmuar ASHK, 4.02.2020 |
| 9 | DhimiterMarte | NdokZef | Trokthi Trokthi | 2364 | 4/1578/ND | Ndertese | 270.26 | | | - | | | - | 270.26 | 27,863 | 7,530,254.38 | | | | 7,530,254.38 | | 7,530,254.38 | Shkembim | Konfirmuar ASHK, 4.02.2020 |
| 10 | Mark | Gjin | Zymaj | 2364 | 4/634/1 | Truall | 3,375 | | | - | 3,375 | 1,620 | 5,467,500 | | | - | | | | 5,467,500 | 5,467,500 | | Kompesim ne vlere | Konfirmuar ASHK, 5.02.2020 |
| 11 | Mhill | Gjok | Gjinaj | 2364 | 4/802 | Truall | 750 | | | - | 750 | 1,620 | 1,215,000 | | | - | | | | 1,215,000 | 1,215,000 | | Kompesim ne vlere | Ne proces gjyqesor. Ne seksionin E ka shenimin: "Mbi kete truall ka nje ndertim te pa ligjshem" / eshte pronar me vertetim hipotekor |
| 12 | Llesh Preng | PjeterNdue | Zima Zymaj | 2364 | 3/397 | Truall | 1,228.50 | | | - | 1,228.5 | 1,620 | 1,990,170 | | | - | | | | 1,990,170 | 1,990,170 | | Kompesim ne vlere | Konfirmuar ASHK, 5.02.2020 Urdher per venin e sekuestros konservative date 04.02.2014, Z. Perbarimore Kurbin / eshte pronar |
| 13 | Llesh Preng | PjeterNdue | Zima Zymaj | 2364 | 4/634/2 | Truall | 265 | | | - | 265 | 1,620 | 429,300 | | | - | | | | 429,300 | 429,300 | | Kompesim ne vlere | Konfirmuar ASHK, 4.02.2020 |
| 14 | Fran | Ndrek | Suti | 2364 | 3/435 | Are+Truall | 348 | 248 | 321 | 79,608 | 100 | 1,620 | 162,000 | 60 | 27,863 | 1,671,780.00 | | | 93,590 | 2,006,978 | 335,198 | 1,671,780 | Shkembim per ndertesen/ dhe kompesim ne vlere per truallin, token "are" dhe kulturat bujqesore | "Kufizohen veprime mbi pasurinë për shkak të mungesës së dokumentacionit tekniko-ligjor" |
| 15 | Pal | Ndrek | Suti | 2364 | 3/386 | Truall | 200 | | | | 200 | 1,620 | 324,000 | 82 | 27,863 | 2,284,766.00 | | | 66,720 | 2,675,486 | 390,720 | 2,284,766 | Shkembim per ndertesen/ dhe kompesim ne vlere per truallin dhe kulturat bujqesore | Konfirmuar ASHK, 5.02.2020 Shenime ne seksionin E :' Mbi kete truall ka 2 ndertimi te paligjshme dhe Urdher sekuestro Nr.793 dhe Nr. 349, data 15.07.2019, Permbarues A.M.A. |
| 16 | DodZef | VlashVlash | Zymaj Zymaj | 2364 | 3/396 | Truall | 520 | | | | 520 | 1,620 | 842,400 | | | | 800 | 23,927,766 | | 24,770,166 | 24,770,166 | | Kompesim ne vlere | Mbi kete truall rezulton objekt me Leje Ndertimi Nr. 4, date 07.05.2010 me afat kohor deri me date 20.05.2011. Plotesim dokumentacioni. |
| 17 | FranGjok Gjon Llesh MarkNdoc NikollPreng | NdueNdueVlashPjeterGjinVlash PjeterNdue | Zymaj Zymaj | 2364 | 3/398 | Truall | 412.50 | | | | 412.50 | 1,620 | 668,250 | | | | | | | 668,250 | 668,250 | | Kompensim ne vlere | Konfirmuar ASHK, 4.02.2020 Ne seksionin e ka shenimin; "Urdher per venien e Sekuestros konservative date 04.02.2014, Zyra |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7 | Leonard | Lek | Trokthi | 2364 | 4/1253 | Njesi | 253.15 | | | | | | | | | | 253.15 | 834,732 | | 834,732.00 | | | Shkembim | Me shkresen e ASHK, DV Lezhe, nr. 1341/1, date13.02.2020 ka shenimin:Objekt shteteror i privatizuar. |
| 8 | Mikel | Ndok | Trokthi | 2364 | 4/1578 | Njesi | 274.00 | | | | | | | | | | 274 | 1,288,816 | | 1,288,816.00 | | | Shkembim | Me shkresen e ASHK, DV Lezhe, nr. 1341/1, date13.02.2020 ka shenimin:Objekt shteteror i privatizuar. |
| SHUMA PER PASURITE NE PROCES LEGALIZIMI NE ASHK | | | | | | | | | | | | | | | | 14,836,211.61 | | 6,016,429 | | 20,852,640.61 | | | | |
| PRONE SHTET | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | Shtet | | | 2364 | 3/722/1 | Truall | 261.00 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2 | Shtet | | | 2364 | 4/1222/2 | Truall | 6,899.00 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 3 | Bashkia Kurbin | | | 2364 | 3//1 | Ndertese | 4,585.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 4 | Republika e Shqiperise | | | 2364 | 3/394 | Truall + Ndertese | 2,981.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 5 | Shtet | | | 2364 | 4/1207 | Truall | 1,722.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 6 | Shtet | | | 2364 | 4/1226 | Trotuare | 75.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 7 | Shtet | | | 2364 | 3/822 | Trotuare | 68.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 8 | Shtet | | | 2364 | 3/824 | Trotuare | 25.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 9 | Shtet | | | 2364 | 3/713/3 | Are | 1,230.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 10 | Shtet | | | 2364 | 3/732 | Trotuare | 241.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 11 | Shtet | | | 2364 | 3/733 | Trotuare | 155.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 12 | Shtet | | | 2364 | 4/1221 | Trotuare | 432.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 13 | Shtet | | | 2364 | 3/735 | Trotuare | 410.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 14 | Shtet | | | 2364 | 3/826 | Truall | 25.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 15 | Shtet | | | 2364 | 3/825 | Shesh | 574.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 16 | Shtet | | | 2364 | 3/717 | Kanal | 1,547.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 17 | Shtet | | | 2364 | 3/720/7 | Truall | 30.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 18 | Shtet | | | 2364 | 3/720/5 | Are | 1,147.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 19 | Shtet | | | 2364 | 4/107 | Rruge | 135.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 20 | Shtet | | | 2364 | 3/823 | Truall | 59.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 21 | Shtet | | | 2364 | 4/1210 | Truall | 65.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 22 | Shtet | | | 2364 | 3/710 | Truall | 236.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 23 | Shtet | | | 2364 | 3/714/2 | Are | 561.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 24 | Shtet | | | 2364 | 4/1215 | Truall | 364.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 25 | Shtet | | | 2364 | 4/1218 | Truall | 1,951.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 26 | Shtet | | | 2364 | 4/1217 | Truall | 443.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 27 | Shtet | | | 2364 | 4/1216 | Truall | 398.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 28 | Shtet | | | 2364 | 4/1225 | Shesh | 233.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 29 | Shtet | | | 2364 | 4/109 | Rruge | 148.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 30 | Shtet | | | 2364 | 3/715 | Truall | 1,449.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 31 | Shtet | | | 2364 | 3/721 | Truall | 218.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 32 | Shtet | | | 2364 | 3/828 | Are | 375.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 33 | Shtet | | | 2364 | 3/711 | Truall | 463.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 34 | Shtet | | | 2364 | 3/729 | Truall | 626.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 35 | Shtet | | | 2364 | 4/1208 | Shesh | 1,265.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 36 | Shtet | 2364 | 3/718 | Rruge | 2,647.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 37 | Shtet | 2364 | 4/1206 | Truall | 335.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 38 | Shtet | 2364 | 4/1211 | Truall | 33.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 39 | Shtet | 2364 | 4/097 | Truall | 68.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |
| 40 | Shtet | 2364 | 4/1212 | Shesh | 169.00 | | | | | | | | | | | | | 0 | | | | |

Çmimet për shpronësim tokë "arë" është llogaritur sipas shkresësme nr.2135/1 prot datë 20.2.2020 ardhur nga Agjencia e Trajtimit të Pronave dhe çmimi tokë "truall" janë llogaritur sipas vendimit nr. 89, datë 3.2.2016 "*Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë*", çmimet për ndërtesa banimi janë llogaritur sipas çmimit mesatar të shit/blerjeve sipas ZVRPP-sëreferuar shkresës me nr. prot 674/1 datë 6.2.2020 (ASHK Kurbin), ndërsa vlera e "*kulturë bujqësore dhe drufrutorë*" u llogarit në bazë të udhëzimit nr.1, datë 5.10.2000 "*Për kriteret teknike të përllogaritjes së vlerës së bimëve drufrutorë që shpronësohen për interes publik, në rastet kur mungojnë treguesit e deklarurar të shitblerjes*", çmimet për "njësi" janë llogaritur me situacion nga komisioni i ngritur nga Njësia Zbatuese EKB.

**VENDIM**
**Nr. 500, datë 24.6.2020**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I OBJEKTIT “SISTEMIM, ASFALTIM RRUGA HYRËSE BERAT” (SHTESAT)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorin të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i objektit “Sistemim, asfaltim rruga hyrëse Berat” (shtesat).

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, prone private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqiten në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, me vlerë të përgjithshme prej 2 493 068 (dy milionë e katërqind e nëntëdhjetë e tre mijë e gjashtëdhjetë e tetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 493 068 (dy milionë e katërqind e nëntëdhjetë e tre mijë e gjashtëdhjetë e tetë) lekësh, të përballohet nga fondet buxhetore të miratuara në zërin “Shpronësime” për Autoritetin Rrugor Shqiptar, në programin buxhetor “Transporti rrugor”, për vitin 2020.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga fondet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shpenzimi në vlerën 329 000 (treqind e njëzet e nëntë mijë) lekë, për botimin në gazetë, të përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

7. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara në projekt.

8. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

11. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I OBJEKTIT "SISTEMIM, ASFALTIM RRUGA HYRËSE BERAT" (SHTESAT)

| Nr. | Emër mbiemër | Lloji i pasurisë | Zona kadastrale | Nr. i pasurisë | Sip. totale truall (m²) | Sip. truall i prekur (m²) | Çmimi truall lekë/m² | Vlera në lekë | Shënime në kartelë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ruzhdi Oriza | Truall | 8501 | 2/175 | 38 | 31.00 | 4183 | 129,673.0 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 2 | Pranvera Tosun Sojati dhe Vladimir Avni Sojati | Truall | 8501 | 2/164 | 220.60 | 83.00 | 4183 | 347,189.0 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 3 | Besim Barjam Sherifi | Truall | 8501 | 2/166 | 66 | 20.00 | 4183 | 83,660.0 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 4 | Besim Barjam Sherifi | Truall | 8501 | 2/176 | 49 | 15.00 | 4183 | 62,745.0 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 5 | Ganimete Kamber Oriza | Truall | 8501 | 5/1 | 9224 | 447.00 | 4183 | 1,869,801.0 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| | Total | | | | | 596 | m² | 2,493,068 | lekë |

Shënim:
1. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, dt. 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

## VENDIM
## Nr. 501, datë 24.6.2020

## PËR MIRATIMIN E REKOMANDIMEVE PRIORITARE PËR PROKURORIN E PËRGJITHSHËM, NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT, PËR VITIN 2020

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 103, të ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", dhe të pikës 32, të nenit 6, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2020, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet ministri i Drejtësisë t'ia përcjellë menjëherë Prokurorit të Përgjithshëm rekomandimet prioritare, si dhe t'ua bëjë ato të njohura drejtuesve të prokurorive të të gjitha shkallëve, në një mbledhje të përbashkët, jo më vonë se një muaj nga data e miratimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet ministri i Drejtësisë të ndjekë, në vazhdimësi, mënyrën e zbatimit të këtyre rekomandimeve, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

## REKOMANDIME PRIORITARE
PËR PROKURORIN E PËRGJITHSHËM, NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2020, TIRANË, QERSHOR 2020

Në zbatim të nenit 103, të ligjit nr. 97, datë 6.10.2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", Këshilli i Ministrave miraton dhe i përcjell Prokurorit të Përgjithshëm, Rekomandimet Prioritare, që duhen ndjekur për vitin në vazhdim në luftën kundër kriminalitetit.

Ministri i Drejtësisë ua bën të njohura Rekomandimet e Këshillit të Ministrave, drejtuesve të prokurorive të të gjitha shkallëve, në një mbledhje të përbashkët. Këshilli i Ministrave, nëpërmjet ministrit të Drejtësisë, ndjek në vazhdimësi mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna prej tij.

Rekomandimet kanë për qëllim dhe synojnë garantimin e funksionimit efektiv të organit të prokurorisë, parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të të drejtave të njeriut.

Rekomandimet Prioritare adresuar Prokurorit të Përgjithshëm, janë mbështetur në Programin Qeverisë, 2017–2021[1], Strategjinë Ndër-sektoriale të Drejtësisë, 2017–2020, dhe të planin

[1] Publikuar në faqen zyrtare: https://kryeministria.al/wwp-content/uploads/2017/11/PROGRAMI.pdf.

e saj të veprimit[2]; analizën e dokumenteve strategjike qeveritare, si: Plani Kombëtar për Integrimin Evropian, 2019–2021[3]; Rekomandimet e Progresraportit për Shqipërinë të Komisionit Evropian; Plani i Veprimit, 2018–2020, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit[4]; Strategjinë e Drejtësisë për të Mitur dhe Planin e Veprimit 2018–2021[5]; Planin Kombëtar kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit, 2017–2020[6], raportet e organizmave ndërkombëtarë joqeveritarë[7], që lidhen me monitorime për çështjet e korrupsionit, krimit të organizuar dhe trafikut të lëndëve narkotike.

Në përgatitjen e paketës së rekomandimeve janë përfshirë edhe kontributet e propozuara nga strukturat e pushtetit ekzekutiv (Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, si dhe Ministria e Mjedisit), institucione të cilat kanë në përbërje të tyre personel, që me ligj iu është njohur cilësia e policisë gjyqësore, si dhe statistikat e dërguara nga organi i prokurorisë, në zbatim të nenit 38/germa "h", të ligjit nr. 97/2016[8].

Referuar nenit 6, pika 32, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", ndryshuar me ligjin 40/2017, ministri i Drejtësisë ndjek në vazhdimësi mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, duke analizuar dhe duke vlerësuar përmbushjen e tyre. Problematikat e evidentuara gjatë vitit 2019, në përmbushjen e këtyre rekomandimeve, kanë shërbyer, gjithashtu, si bazë për rekomandimet e vitit 2020 për Prokurorinë e Përgjithshme.[9] Këto rekomandime i përcillen Prokurorit të Përgjithshëm, i cili bashkëpunon me SPAK-në për administrimin e informacionit në lidhje me luftën kundër kriminalitetit, informacion të cilin ia përcjell ministrit të Drejtësisë, në kuadër të raportimit mbi ecurinë e zbatimit të Rekomandimeve Prioritare.

Krijimi i një sistemi drejtësie efektiv është një nga prioritetet e qeverisë shqiptare dhe lufta kundër krimit të organizuar, garantimi i të drejtave të njeriut dhe përmirësimi në fushën e bashkëpunimit ndërinstitucional vijojnë të jenë në fokus me qëllim ndërtimin e një sistemi drejtësie të aftë, të pavarur, të përgjegjshëm dhe efektiv.

Rekomandimet prioritare kanë si qëllim forcimin e luftës ndaj kriminalitetit, konsolidimin e procesit të rregullt ligjor në të gjitha fazat e procesit penal, duke garantuar liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, reflektimin e standardeve më të mira të Bashkimit Evropian dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar.

Në vijim të arritjes së rezultateve në zbatimin e reformës në drejtësi, të gjitha institucionet përgjegjëse duhet të japin maksimumin e tyre për të

---

[2] Miratuar me VKM-në nr. 773, datë 2.11.2016, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 278, datë 19.12.2017.

[3] Miratuar nga Këshilli i Ministrave në datën 10.4.2019.

[4] Miratuar me VKM-në nr. 241, datë 20.4.2018, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 68, datë 20.4.2018.

[5] Miratuar me VKM-në nr. 541, datë 19.9.2018, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 138, datë 20. 9.2018.

[6] Miratuar me VKM-në nr. 248, datë 29.3.2017, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 63, datë 29. 3.2017, ndryshuar me VKM-në nr. 313, datë 31.5.2018, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 81, datë 31.5.2018.

[7] Progresraporti për Shqipërinë i Komisionit Evropian, i vitit 2019, "*Report, Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2019 Communication on EU Enlargement Policy*", publikuar në faqen zyrtare: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf; Indeksi vjetor i korrupsionit i *Transparency International, Corruption perception Index 2019*, publikuar në faqen zyrtare: https://www.transparency.org/cpi2019; Raporti shtesë i Komiteti të ekspertëve të MONEVAL "*Anti-money laundering and counter-terrorist financing measures* Albania - *1st Enhanced Follow-up Report*", publikuar në faqen zyrtare: https://rm.coe.int/anti-money-laundering-and-counter-terrorist-financing-measures-albania/16809988c0; Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit - *International Narcotics Control Strategy Report Volume 1-Drug and Chemical Control*, publikuar në faqen zyrtare: https://www.state.gov/wp-content/uploads/2020/03/Tab-1-INCSR-Vol.-I-Final-for-Printing-2-25-20-508.pdf dhe *Volume 2- Money Laundering and Financial Crimes*, publikuar në faqen zyrtare: https://www.state.gov/wp-content/uploads/2020/03/Tab-2-INCSR-Vol-2-508.pdf .

[8] Ministria e Drejtësisë ka kërkuar me shkresën nr. 535 prot., datë 25.1.2020, kontribut nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, si dhe Ministria e Mjedisit. Gjithashtu, me shkresën nr. 156/1 prot., datë 19.2.2020 ka kërkuar statistikat për vitin 2019 nga Prokuroria e Përgjithshme, të cilat janë dërguar pranë Ministrisë së Drejtësisë, me shkresën nr. 1493 prot., datë 4.3.2020.

[9] Ministria e Drejtësisë, me shkresat e saj nr. 6203 prot., datë 6.9.2019 dhe nr. 156 prot., datë 13.1.2020, i ka kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm informacion lidhur me ecurinë e zbatimit të Rekomandimeve të vitit 2019. Prokuroria e Përgjithshme ka informuar me shkresat e saj nr. 1368/23, datë 11.11.2019 dhe nr. 535/2 prot., 26.2.2020.

forcuar pavarësinë, llogaridhënien dhe profesionalizmin në sistemin e drejtësisë, si garanci për një drejtësi funksionale dhe efektive nëpërmjet rezultateve të matshme, si dhe rikthimin e besimit të qytetarëve në sistemin gjyqësor.

Vijimi i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve *(vetting)* synon të largojë nga sistemi i drejtësisë gjyqtarët dhe prokurorët, të cilët nuk plotësojnë kriteret për të qenë pjesë e një sistemi të ngritur në bazë të integritetit dhe profesionalizimit.

Krijimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë në dhjetor 2018 dhe funksionimi i rregullt i tij, si një ndër institucionet kryesore të qeverisjes së sistemit të prokurorisë, institucion me kompetenca dhe përgjegjësi të reja, i hapi rrugën krijimit të Strukturës së Posaçme Antikorrupsion[10], Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe zgjedhjes së Prokurorit të Përgjithshëm të Përhershëm[11], institucione këto shumë të rëndësishme në funksionimin e sistemit të reformuar të drejtësisë.

Ngritja e Prokurorisë së Posaçme më 18 dhjetor 2019, si institucion i ri, krahas gjykatave të posaçme kundër korrupsionit, si mekanizma të posaçëm për luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe ndëshkimit të zyrtarëve të lartë, të cilët deri më tani në Shqipëri kanë qenë problematikë dhe kanë ndikuar në pavarësinë e sistemit të drejtësisë, përbën një hap të rëndësishëm në forcimin e luftës dhe ndëshkueshmërisë kundër këtyre fenomeneve.

Në fillim të vitit 2020 u emërua Inspektori i Lartë i Drejtësisë[12], institucion i ri i parashikuar nga reforma në drejtësi, i cili është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve/prokurorëve. Krijimi dhe fillimi i funksionimit të këtij institucioni me kapacitete të plota, krahas plotësimit të vakumit institucional, synon forcimin e kontrollit dhe të llogaridhënies së gjyqtarëve dhe të prokurorëve, me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë dhe përmirësimin e cilësisë së hetimeve.

Zbatimi i Reformës në Drejtësi gjatë vitit 2019, për sa u përket kontrollit dhe llogaridhënies së magjistratëve, krahas ngritjes së institucioneve, ka vijuar dhe me plotësimin e kuadrit ligjor, të mbetur vakant në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", duke plotësuar parashikimet ligjore për shkeljet disiplinore me ligjin nr. 48/2019[13]. Këto ndryshime plotësuan nevojën për të garantuar zbatimin e parimeve të llogaridhënies dhe të përgjegjshmërisë së magjistratëve, bazuar në elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas standardeve më të mira ndërkombëtare, si dhe garantimin e mirëfunksionimit normal dhe në përputhje me kompetencat e parashikuara në ligj, të institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe të prokurorisë.

Qeveria shqiptare ka dhënë dhe do të vijojë të japë gjithë mbështetjen e nevojshme infrastrukturore dhe financiare për funksionimin optimal të institucioneve të sistemit të drejtësisë, si dhe do të vazhdojë t'u japë mbështetjen maksimale organeve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, si një garanci për ndërtimin e një sistemi drejtësie të drejtë, të pavarur dhe të denjë për një shtet evropian.

Në funksion të realizimit të këtij synimi, qeveria mbështet dhe kërkon angazhimin maksimal të institucioneve ligjzbatuese, në marrjen e masave për luftën kundër korrupsionit, goditjen e krimit të organizuar në të gjitha format e tij, intensifikimin e luftës kundër terrorizmit dhe krimit ndërkombëtar, në respekt të plotë të lirive

[10] Me vendimin nr. 10/1, datë 7.1.2019, KLP-ja shpalli fillimin e procedurave për shpalljen e vendeve vakante për prokurorë të Prokurorisë së Posaçme. Me vendimin nr. 57, datë 5.4.2019, miratoi listën paraprake të 25 kandidatëve, që plotësojnë kushtet ligjore që do të vazhdojnë garën e mëtejshme për prokurorë të Prokurorisë së Posaçme dhe më 25 nëntor 2019, KLP-ja vendosi që tetë kandidatët për prokurorë të SPAK-së, të cilët e kanë kaluar procesin e rivlerësimit dhe kanë marrë konfirmimin në detyrë me vendim të formës së prerë, të emërohen si prokurorë të SPAK-së.

[11] Më datën 5.12.2019, me vendimin nr. 138/2019, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë zgjodhi në funksionin e Prokurorit të Përgjithshëm, z. Olsian Çela, kandidat i cili është renditur i pari edhe nga vlerësimi i KLP-së.

[12] Më datën 20.1.2020, Kuvendi, me vendimin nr. 2/2020, zgjodhi z. Artur Metani, Inspektor të Lartë të Drejtësisë. Aktualisht, Zyra e Inspektoratit të Lartë ka publikuar thirrje edhe për 6 inspektorë të rinj (jo magjistratë) dhe 5 ndihmës inspektorë (jo magjistratë), me qëllim funksionimin e plotë të këtij institucioni.

[13] Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 34, datë 10.4.2017, ka vendosur shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të dispozitave të ligjit nr. 96/2016, në lidhje me shkeljet disiplinore të magjistratëve, me qëllim plotësimin e parashikimeve ligjore; me ligjin nr. 48/2019 u miratuan ndryshimet përkatëse në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

dhe të drejtave të individit, barazinë e shtetasve përpara ligjit dhe angazhimeve të saj ndërkombëtare.

Për sa më sipër, Rekomandimet Prioritare që Këshilli i Ministrave adreson për t'u ndjekur nga organi i prokurorisë, në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020, jepen në këto drejtime me 43 rekomandime në tërësi:

Drejtimi i parë: Garantimi i pavarësisë dhe i përgjegjshmërisë së prokurorit

Drejtimi i dytë: Lufta kundër korrupsionit

Drejtimi i tretë: Lufta kundër krimit të organizuar

Drejtimi i katërt: Respektimi i të drejtave të njeriut

Drejtimi i pestë: Bashkëpunimi ndërinstitucional

**1. Garantimi i pavarësisë dhe i përgjegjshmërisë së prokurorit**

Krijimi i një organi të ndjekjes penale të pavarur dhe të paanshme është një nga parimet kryesore të një sistemi drejtësie efektiv dhe një parim thelbësor i procesit penal. Pavarësia dhe paanshmëria janë jo vetëm një kërkesë bazë për ekzistencën e procesit penal, por kanë një rol të rëndësishëm për gjithë sistemin e drejtësisë penale, pasi fillimi i hetimit dhe ndjekja në tërësi e të gjithë procesit në zbatim rigoroz të legjislacionit me profesionalizëm dhe objektivitet ndikon në luftën kundër kriminalitetit dhe vënien përpara përgjegjësisë së autorëve të veprave penale. Roli i prokurorisë në procesin penal ndikon drejtpërdrejt në besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, si dhe passjell efekt në funksionimin e të gjitha strukturave të shoqërisë.

Krijimi i Prokurorisë së Posaçme (SPAK) përbën një gur themeli në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, veçanërisht korrupsionin e zyrtarëve të lartë, problematikë, e cila përbën sfidën për progresin e Shqipërisë drejt integrimit në Bashkimin Evropian. Gjatë muajit korrik 2019, Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) përzgjodhi 15 kandidatët për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme dhe më 12 dhjetor 2019, u emëruan tetë kandidatët prokurorë pranë kësaj prokurorie, të cilët kishin kaluar procesin e rivlerësimit dhe ishin konfirmuar në detyrë, me vendim të formës së prerë. Me vendimin nr. 281, datë 19.12.2019, drejtuesi i këtij institucioni u emërua Arben Kraja. Në vijim të ngritjes së Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), si dhe të emërimit të drejtuesit të saj, ka filluar procesi për emërimin e drejtuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH), institucion i cili do të ketë në përbërje rreth 60 hetues.

Veprat penale, të cilat përfshihen në kompetencën lëndore të SPAK-së, të përcaktuara nga Kodi i Procedurës Penale dhe legjislacioni i posaçëm[14], janë vepra penale me një rëndësi të veçantë, për shkak të kategorisë së veprës penale ose/dhe subjektit nga i cili ato kryhen[15]. Fillimi i funksionimit të këtij institucioni, i cili është i pavarur nga organi i prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm, do të adresojë këtë problematikë, duke synuar rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Ndërkohë, në vijim të zbatimit të reformës në drejtësi dhe krijimit të institucioneve të posaçme në luftën kundër korrupsionit, ka përfunduar ushtrimi i funksioneve nga prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda[16].

Me krijimin e Prokurorisë së Posaçme, kompetenca e hetimit për kategoritë e veprave penale kundër korrupsionit, veprat penale të krimit

[14] Ligji nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".

[15] Neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale:
*Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon:*
*a) krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e;*
*b) çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal;*
*c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj;*
*ç) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.*

[16] Me vendimin nr. 282, datë 19.12.2019, "Për miratimin e rregullave të transferimit të personelit administrativ të prokurorive të krimeve të rënda", KLP-ja ka përcaktuar rregullat për transferimin e personelit administrativ nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, në funksion të krijimit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH).

të organizuar dhe veprat penale të kryera nga zyrtarë të lartë, i kalojnë këtij institucioni, duke sjellë një ndarje nga juridiksioni i prokurorive të përgjithshme[17].

Në këto kushte, me konstituimin dhe me fillimin e funksionimit të Prokurorisë së Posaçme, lind nevoja për konsolidimin e raportit ndërinstitucional me këto prokurori, lidhur me identifikimin e kompetencës materiale, kalimin e kompetencës midis prokurorive, me synimin e garantimit të efektivitetit të hetimit dhe të vënies përpara përgjegjësisë së autorëve të tyre.

Reforma në sistemin e drejtësisë garanton pavarësinë e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës, megjithatë kjo reformë, krahas decentralizimit të sistemit të prokurorisë dhe forcimit të pavarësisë së prokurorit, ka parashikuar dhe krijimin e mekanizmave të kontrollit disiplinor. Gjatë vitit 2019, pas një periudhe vakumi ligjor dhe institucional, kuadri disiplinor u plotësua dhe pritet funksionimi i tij.

Me qëllim plotësimin e tyre, duke reflektuar dhe vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese, me ligjin nr. 48/2019, u miratuan ndryshimet ligjore, të cilat parashikojnë shkeljet disiplinore në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Gjatë kësaj periudhe, në mungesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, bazuar në nenin 160, paragrafi 5 i këtij ligji parashikonte, se deri në krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Prokurori i Përgjithshëm heton shkeljet disiplinore nëpërmjet inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm, bazuar në procedurën dhe kriteret e pjesës V dhe të dispozitës kalimtare të këtij ligji. Pavarësisht ekzistencës së këtyre kompetencave, gjatë periudhës tranzitore rezulton që Prokuroria e Përgjithshme nuk ka ushtruar plotësisht përgjegjësitë e saj.

Në fillim të vitit 2020, përfundoi me sukses krijimi i institucioneve të drejtësisë, sikurse parashikohej në aktet e reformës së drejtësisë. Gjatë vitit 2019 filluan procedurat për zgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe u finalizua në datën 20 janar 2020, kur Kuvendi i Shqipërisë, me vendimin nr. 2/2020 emëroi Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Aktualisht, bazuar në nenin 147/d të Kushtetutës, ILD-ja është institucioni përgjegjës për hetimin e shkeljeve disiplinore të kryera nga gjyqtarët dhe prokurorët e çdo niveli.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr. 138/, të datës 5.12.2019, emëroi Prokurorin e Përgjithshëm. Prokuroria funksionon si një organ i decentralizuar, ndaj roli i Prokurorit të Përgjithshëm është i nevojshëm për të garantuar mbarëvajtjen e veprimtarisë së prokurorisë nëpërmjet respektimit të pavarësisë së brendshme të prokurorëve në ushtrimin e ndjekjes penale, në përfaqësimin e akuzës në gjyq dhe në plotësimin e funksioneve të tjera të dhëna me ligj. Kuadri i ri ligjor aktual garanton pavarësinë dhe autonominë e nevojshme për marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit nga prokurorët të funksionit të tyre kushtetues e ligjor, pavarësisht ndikimit të paligjshëm të brendshëm apo të jashtëm nga çdo autoritet publik a privat, si dhe kontrollin e ushtrimit të funksioneve të tyre për të shmangur çdo sjellje që bie ndesh me funksionin e prokurorit.

Me qëllim forcimin e pavarësisë së prokurorit dhe rritjes së efektivitetit të hetimit paraprak, në muajin prill 2019, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 25/2019, "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore", i cili parashikon rregullat dhe parimet e përgjithshme në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, veprimtarinë e tyre hetimore dhe raportet me prokurorinë dhe me institucionet shtetërore ku bëjnë pjesë. Rritja e rolit të policisë gjyqësore, në funksion të zhvillimit të hetimit dhe të zbatimit të urdhrave të prokurorit, synon të garantojë efikasitet të plotë në hetimin paraprak dhe rritje të përgjegjshmërisë së tyre gjatë hetimeve.

Pavarësisht se në Rekomandimet Prioritare për vitin 2019 nuk është parashikuar rekomandimi për garantimin e pavarësisë së prokurorit, nga të dhënat e përcjella nga organi i prokurorisë[18], lidhur me zbatimin e rekomandimeve prioritare të dhëna për vitin 2019 janë paraqitur të dhënat në lidhje me aktet nënligjore të nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm, në zbatim të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit, me asistencën e projektit

[17] Ligji nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", përcakton raportin midis Prokurorisë së Posaçme dhe prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm.

[18] Me shkresat e tyre nr. 1368/23 prot., datë 11.11.2019 dhe nr. 1368/42 prot., datë 26.2.2020, regjistruar me tonat përkatësisht nr. 6203/1 prot., datë 12.11.2019 dhe nr. 156/2 prot., datë 26.2.2020.

*Euralius V*. Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar 4 akte nënligjore: udhëzimin nr. 5, datë 30.7.2019, "Marrëdhëniet me publikun në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm"; udhëzimin nr. 8, datë 4.12.2019, "Për garantimin e pavarësisë së prokurorit, marrëdhëniet ndërmjet tij me drejtuesit e prokurorisë dhe informimin në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm"; udhëzimin nr. 9, datë 11.12.2019, "Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë për krime të rënda dhe në prokuroritë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm me fillimin e funksionimit të Prokurorisë së Posaçme"; si dhe urdhrin nr. 101, datë 12.6.2019, "Për emërimin e zëvendësdrejtuesit të prokurorisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm". Këto akte nënligjore, të publikuara në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme, u janë shpërndarë të gjithë prokurorëve, si dhe drejtuesve të prokurorive, në zbatim të kompetencave të tyre ligjore janë udhëzuar për marrjen e masave, me qëllim garantimin e pavarësisë së prokurorit në ushtrimin e funksionit dhe për të siguruar eficiencën, ligjshmërinë dhe transparencën në veprimtarinë e prokurorive të cilët drejtojnë.

Sa më sipër, pavarësisht arritjeve pozitive dhe adresimit të sfidave në vlerësim të prioriteteve të BE-së, politikave në fushën e së drejtës, me qëllim garantimin e pavarësisë së prokurorit, Këshilli i Ministrave i rekomandon Prokurorit të Përgjithshëm:

1. Marrjen e masave për respektimin e standardeve etike dhe profesionale, në zbatim të kuadrit të plotësuar ligjor për përgjegjësinë disiplinore, në funksion të forcimit të integritetit, eficiencës dhe përgjegjshmërisë së prokurorëve, krahas garantimit të pavarësisë së tyre;

2. Marrjen e masave për forcimin e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të rasteve të hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë;

3. Rritjen e rolit të prokurorit në drejtimin e policisë gjyqësore dhe kontrollin e hetimit paraprak, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe të llogaridhënies së strukturave të policisë gjyqësore;

4. Marrjen e masave për rritjen profesionale, me qëllim njohjen dhe zbatimin e drejtë të ndryshimeve ligjore për specializimin e prokurorëve, sipas organizimit të prokurorive;

5. Marrjen e masave për garantimin e paanshmërisë dhe shmangien e çdo lloj influence ose ndikimi ndaj prokurorit gjatë kryerjes së hetimeve;

6. Forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe llogaridhënies së prokurorit;

7. Marrjen e masave për miratimin e akteve unifikuese/udhëzuese, me qëllim zbatimin e drejtë dhe të unifikuar të dispozitave të reja të Kodit Penal.

**Lufta kundër korrupsionit**

Lufta ndaj korrupsionit është një nga sfidat kryesore për garantimin e pavarësisë së institucioneve dhe organeve publike, zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin shoqëror të Shqipërisë. Finalizimi i integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian mund të arrihet vetëm duke vendosur një standard të lartë në luftën kundër korrupsionit. Për më tepër, krijimi i një historiku solid me hetime, ndjekje penale dhe dënime për korrupsion, sidomos në nivele të larta, është një ndër kushtet e vendosura nga Bashkimi Evropian për integrimin e Shqipërisë.

Qeveria shqiptare, vitet e fundit, ashtu si dhe gjatë vitit 2019, ka rritur fokusin e saj në luftën kundër korrupsionit dhe ka ndërmarrë një sërë masash, në lidhje me luftimin e aktiviteteve korruptive, në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale Antikorrupsion, 2015–2020[19]. Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 241, datë 20.4.2018,[20] "Për miratimin e planit të veprimit, 2018–2020, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015–2020, e të Pasaportës së Indikatorëve, krijimin, funksionimin dhe detyrat e Komitetit Koordinator për Zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015–2020, dhe Task Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion", Ministria së Drejtësisë është caktuar në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit. Në lidhje me zbatimin e Planit të Veprimit kundër Korrupsionit, 2018–2020, Ministria e Drejtësisë ka ndjekur realizimin e objektivave të vendosur në këtë plan, si dhe ka publikuar raportin vjetor lidhur me ecurinë në

[19] Miratuar me VKM nr. 247, datë 20. 3.2015, miratuar në Fletoren Zyrtare nr. 47, datë 20.3.2015.

[20] Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 68, datë 14.05.2018.

luftën kundër korrupsionit[21]. Ndërkohë, në bashkëpunim me të gjitha institucionet publike të përfshira në strategjinë kundër korrupsionit dhe me asistencën teknike të Bashkimit Evropian, është përgatitur një draft i Planit të Veprimit për periudhën 2019–2023[22], i cili është në proces konsultimi publik.

Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 241, datë 20.4.2018, është krijuar Task Forca Ndërinstitucionale Antikorrupsion, përgjegjëse për inspektimet ndërinstitucionale, sipas Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, e cila kryesohet nga ministri i Drejtësisë. Gjatë vitit 2019, aktiviteti i Task Forcës Antikorrupsion, i cili ka në përbërje të saj një sërë institucionesh që angazhohen në kryerjen e kontrolleve dhe të inspektimeve të vazhdueshme, ka arritur rezultate shumë të mira në drejtim të identifikimit dhe të ndëshkimit të punonjësve të administratës të përfshirë në afera korruptive, ku janë rekomanduar: 168 masa administrative, 192 masa disiplinore dhe 36 referime në prokurori. Në lidhje me këto referime, nga informacioni i përftuar nga Prokuroria e Përgjithshme, rezulton se disa çështje janë pushuar ose është vendosur mosfillim nga prokuroria, ndërsa pjesa tjetër vijojnë të jenë në proces hetimi.

Gjithashtu, pranë Ministrisë së Drejtësisë funksionon edhe një strukturë e veçantë antikorrupsioni: Drejtoria e Programeve dhe Projekteve në Fushën Antikorrupsion, e miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 114, datë 4.9.2019, e cila monitoron, ndjek dhe raporton lidhur me ecurinë e projekteve në luftën kundër korrupsionit në strukturat e drejtësisë dhe institucionet e tjera të pavarura të përfshira.

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit i publikuar në mars 2020, "Volumi 1 – Kontrolli i narkotikëve dhe lëndëve kimike",[23] dhe "Volumi 2 – Pastrimi i parave dhe krimet financiare"[24], ndër të tjera përmend, se: "Një vend kryesor i pastrimit të parave përkufizohet si vend, institucionet kryesore të të cilit përfshihen në transaksione financiare me shuma të konsiderueshme të ardhurash nga trafiku ndërkombëtar i narkotikëve". Për vitin 2019, një ndër vendet/juridiksionet e renditura në këtë kategori është edhe Shqipëria".

Shkalla e lartë e papunësisë në Shqipëri, sundimi i dobët i ligjit dhe korrupsioni endemik janë faktorët kryesorë që ndikojnë në përpjekjet e vendit për luftën kundër narkotikëve. Rrjetet shqiptare të krimit të organizuar përdorin të ardhurat nga trafiku i narkotikëve për të korruptuar sistemin gjyqësor dhe institucionet e tjera për të shpëtuar nga ndëshkueshmëria.

Është thelbësore që Shqipëria të vijojë të implementojë reformën në drejtësi dhe të vijojë punën për shfarosjen e krimit të organizuar.

Në vitin 2019 Shqipëria ka bërë pak përparim në drejtim të parandalimit të pastrimit të parave dhe krimeve financiare. Shqipëria mbetet e ndjeshme ndaj pastrimit të parave, për shkak të korrupsionit, rrjeteve të krimit të organizuar dhe institucioneve të dobëta. Vendi ka një ekonomi kryesisht informale, me remitanca të konsiderueshme nga jashtë vendit. Veprat që gjenerojnë të ardhura janë trafiku i drogës, evazioni fiskal dhe kontrabanda. Vijimi i reformës gjyqësore, përfshirë vetingun e gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe krijimin e njësive të specializuara të policisë për krimet ekonomiko-financiare, kanë përmirësuar adresimin e këtyre veprave. Megjithatë, këto përpjekje akoma nuk kanë dhënë rezultatet e duhura, për shkak të sfidave të institucioneve të reja

21 Draftraporti vjetor i monitorimit i SNKK-së, janar–dhjetor 2019, publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë: http://www.drejtesia.gov.al/strategjia-ndërsektoriale-kundër-korrupsionit/.

22 Drafti i planit të veprimit, 2019–2023, është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë: http://drejtesia.gov.al/newsroom/njoftime/ministria-e-drejtësisë-koordinatori-kombëtar-kundër-korrupsionit-përfundoj-procesin-e-rishikimit-të-planit-të-veprimit-2019-2023-në-zbatim-të-strategjisë-ndërsektoriale-kundër-korrupsionit/http://drejtesia.gov.al/newsroom/njoftime/ministria-e-drejtësisë-koordinatori-kombëtar-kundër-korrupsionit-përfundoj-procesin-e-rishikimit-të-planit-të-veprimit-2019-2023-në-zbatim-të-strategjisë-ndërsektoriale-kundër-korrupsionit/.

23 *2020 International Narcotics Control Strategy Report, Volume 1 drug and Chemical Control,* publikuar në faqen: https://www.state.gov/wp-content/uploads/2020/03/Tab-1-INCSR-Vol.-I-Final-for-Printing-2-25-20-508.pdf.

24 *2020 International Narcotics Control Strategy Report, Volume 2 Money Laundering and financial crimes,* publikuar në faqen zyrtare: https://www.state.gov/wp-content/uploads/2020/03/Tab-2-INCSR-Vol-2-508.pdf.

të drejtësisë dhe të korrupsionit që cenon sundimin e ligjit.

Shqipëria duhet të zbatojë ligjet ekzistuese në mënyrë efektive dhe të vazhdojë të zhvillojë aftësinë e policisë dhe prokurorëve për t'u përqendruar në luftën kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe krimeve ekonomike. Është e nevojshme të mbahen në mënyrë të plotë, të centralizuar dhe sistematike statistika për hetimet, ndjekjet penale, dënimet dhe sekuestrimet.

Progresraporti për Shqipërinë 2019[25], për luftën kundër korrupsionit, konstaton se: "Shqipëria ka bërë një progres të mirë në luftën kundër korrupsionit, veçanërisht me miratimin e Planit të Ri të Veprimit, 2018–2020, për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër korrupsionit. Shqipëria duhet të bëjë përparim të mëtejshëm drejt krijimit të një historiku solid të sekuestrimit dhe të konfiskimit të pasurive kriminale, që rezultojnë nga veprat penale të korrupsionit, të rrisë më tej përdorimin e hetimeve financiare; të finalizojë procedurat për ngritjen e organeve të specializuara antikorrupsion, të përbëra nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) dhe Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) dhe Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, të sigurojnë burime të mjaftueshme dhe bashkëpunim midis këtyre strukturave të reja. Të vazhdohet përmirësimi i aksesit në regjistrat elektronikë për prokurorinë dhe policinë, duke ngritur një sistem të integruar të menaxhimit të çështjeve midis policisë, prokurorisë dhe gjykatave.

Sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit të *Transparency International* për vitin 2019[26], Shqipëria ka pësuar një rënie të lehtë në renditjen e shteteve për sa i përket korrupsionit në sektorin publik, duke u rankuar në vendin e 106, nga vendi i 99 që ka qenë në vitin 2018.

Fillimi i funksionimit dhe efektiviteti i Prokurorisë së Posaçme përbën një rol të padiskutueshëm në fushën e ndëshkimit të korrupsionit, të zyrtarëve të lartë dhe në gjyqësor, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave me origjinë kriminale, aseteve kriminale apo pasurisë së pajustifikuar të vënë nga korrupsioni zyrtar, parandalimin e korrupsionit në strukturat shtetërore dhe për rikthimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Gjithashtu, krijimi dhe funksionimi i Byrosë Kombëtare të Hetimit përbën një hallkë të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit, si një njësi e posaçme dhe e specializuar për hetimin e veprave penale në fushën e korrupsionit, e cila vepron pranë Prokurorisë së Posaçme.

Referuar analizës për vitin 2019, që Ministria e Drejtësisë ka kryer, rezulton se:

- Gjatë vitit 2019 janë hetuar 2050 çështje penale për veprat penale në fushën e korrupsionit[27], me një numër total prej 556 personash nën hetim dhe janë marrë të pandehur 293 persona. Rezulton se ka një rritje të numrit të hetimeve për veprat penale të korrupsionit në krahasim me vitin 2018, me 329 çështje më tepër, rritje të numrit të personave nën hetim me 184 persona më tepër nën hetim dhe një ulje të lehtë prej 7 personash të marrë si të pandehur më pak, krahasuar me të dhënat e vitit të kaluar[28]. Por, pavarësisht kësaj, rastet që dërgohen për gjykim mbeten gati në të njëjtat nivele ose krahasuar me numrin total rezulton më e ulët. Për vitin 2019 janë dërguar për gjykim vetëm 146 procedime penale ose rreth 7,12% të çështjeve të hetuara, me 283 të pandehur. Krahasuar me vitin 2018[29] konstatohet rënie e lehtë e numrit të çështjeve, me 2 çështje më pak dhe 2 të pandehur më pak. Për vitin 2019 ka përfunduar gjykimi për 101 çështje penale për veprat penale kundër korrupsionit, me një numër prej 182 të pandehurish, nga të cilët janë dënuar 162 persona, krahasuar me vitin 2018[30] ka një ulje prej 11

[25] *Albania 2019 Report, Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2019 Communication on EU Enlargement Policy.*

[26] Publikuar në faqen zyrtare të *Transparency International:* https://www.transparency.org/whatwedo/publication/corruption_perceptions_index_2019.

[27] Bazuar në 22 veprat penale të analizuara edhe në dy vitet paraardhëse 2017, 2018, ku përfshihen këto nene 164/a; 164/b; 244; 244/a; 245; 245/1; 248; 256; 257; 257/a; 259; 259/a ;260; 312;319;319/a'319/b; 319/c; 319/ç; 319/d; 319/dh; 319/e të K. Penal.

[28] Më 2018-ën ishin 1721 çështje në hetim me 372 persona nën hetim dhe 300 të pandehur.

[29] Në vitin 2018, numri i çështjeve të dërguara për gjykim për këto vepra ka qenë 148 (8.6% e rasteve) me 285 të pandehur.

[30] Në vitin 2018 kishin përfunduar gjykimin 112 çështje penale me 207 të pandehur, nga të cilët janë dënuar 165 persona.

çështjesh, 25 persona nën hetim më pak dhe 3 të dënuar më pak.

- Ndërkohë, vijon të mbetet i ulët roli i prokurorisë për sa u përket hetimeve proaktive ose hetimeve të filluara kryesisht për veprat penale të korrupsionit, duke përfshirë këtu edhe numrin e rasteve të përdorimit të metodave speciale të hetimit, të cilat zënë vetëm 12.7% të numrit total të çështjeve të filluara. Konkretisht, në vitin 2019, numri i përgjithshëm i veprave penale të referuara dhe të kallëzuara është 47341[31], nga të cilat vetëm 115[32] janë vepra penale të filluara kryesisht nga prokurori, ose rreth 0,24% e numrit të përgjithshëm. Nga 115 çështje penale të filluara kryesisht nga prokurori, vetëm 14 janë të filluara kryesisht për veprat penale në fushën e korrupsionit, ose rreth 12.17% e numrit të çështjeve kryesisht, ku vendin kryesor e zë vepra penale: "Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë", parashikuar nga neni 319/ç i K. Penal, me 9 çështje. Pra, konstatohet një ulje prej 8 çështjesh krahasuar me numrin e çështjeve të regjistruara kryesisht më 2018-ën në fushën e korrupsionit, ku kanë qenë regjistruar 22 çështje. Nëse shohim ecurinë e viteve të fundit trendi rezulton në rënie në numrin e çështjeve të filluara kryesisht në fushën e korrupsionit, pavarësisht rekomandimeve[33].

- Lidhur me asetet e sekuestruara/konfiskuara, rezulton se raporti i kërkesave për sekuestrim/konfiskim vijon të mos jetë në nivelet e kërkuara në raport me numrin e procedimeve penale të regjistruara për veprat penale të korrupsionit, megjithatë vlen të përmendet se ka pasur raste të hetimit dhe dënimit të zyrtarëve të lartë.

- Rezulton një rënie e numrit të çështjeve për veprat penale në fushën e pastrimit të parave (rreth 10.8% më pak) krahasuar me të dhënat e vitit 2018, pavarësisht rekomandimit për shtimin e numrit të hetimeve sistematike pasurore dhe rritjes së cilësisë së këtyre hetimeve. Ndërsa, në total, numri i çështjeve të regjistruara (kryesisht dhe me referim) për veprat penale të pastrimit të parave[34] është 236 çështje, me një numër total prej 28 personash nën hetim nga të cilët vetëm 13 prej tyre janë marrë si të pandehur. Krahasuar me të dhënat për vitin 2018[35] rezulton se ka një ulje prej 33 çështjesh të regjistruara më pak, me 7 persona nën hetim më pak dhe ulje të numrit të të pandehurve, me 2 të pandehur më pak.

- Ndërsa, nga të dhënat statistikore të dërguara nga organi i prokurorisë, rezulton se nga totali i çështjeve të filluara kryesisht, për veprën penale të pastrimit të parave rezultojnë 2 çështje[36], të cilat janë regjistruar për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", neni 287/1 i K. Penal dhe nuk është regjistruar asnjë çështje për veprën penale: "Përvetësimi i parave ose i mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale", neni 287/b i K. Penal.

- Lidhur me zbatimin e ligjit antimafia, gjatë vitit 2019 vihet re një rritje në shifra për sa u përket kërkesave për konfiskim dhe sekuestrim për subjektet e këtij ligji, me rreth 28% më tepër krahasuar me vitin 2018. Janë paraqitur të dhënat në lidhje me kërkesat e shteteve të huaja për produktet e veprës penale të kryera jashtë vendit, numri i të cilave është pothuajse i njëjtë me vitin 2018, pavarësisht rekomandimit të vazhdueshëm për rritjen e numrit të tyre dhe në ndjekje më të kujdesshme. Kjo do të përbëjë një sfidë për vitin 2020 për Prokurorinë e Posaçme dhe strukturat e saj hetimore.

Duke mbajtur në konsideratë problematikat sa më sipër të evidentuara, prioritetet e përbashkëta, Këshilli i Ministrave, për forcimin e luftës kundër korrupsionit, i rekomandon Prokurorit të Përgjithshëm:

1. Rritjen e numrit dhe të cilësisë së hetimeve për veprat penale në fushën e korrupsionit, duke pasur parasysh kompetencën lëndore midis prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Posaçme, si dhe rritjen e numrit të personave të dënuar me vendim të formës së prerë;

2. Koordinimin dhe bashkëpunimin me Prokurorinë e Posaçme për sa u përket hetimeve

---

[31] Një rritje prej 449 referimesh krahasuar me vitin 2018, ku ishin në total 46892 referime.

[32] Një rritje prej 6 çështje më tepër krahasuar me vitin 2018.

[33] Në vitin 2017 ishin 46 çështje të regjistruara kryesisht për veprat penale në fushën e korrupsionit.

[34] Nenet 287, 287/a dhe 287/b të Kodit Penal.

[35] Në vitin 2018, për këto tri vepra penale janë regjistruar 269 çështje, me 35 persona nën hetim dhe 15 të pandehur.

[36] Ka një ulje prej 3 çështjesh krahasuar me vitin 2018.

proaktive pasurore dhe financiare, veçanërisht për rastet që lidhen me veprat penale në fushën e korrupsionit në nivele të larta të politikës dhe administratës publike;

3. Shtimin e numrit të hetimeve proaktive (çështje të filluara kryesisht) dhe numrit të rasteve të përdorimit të metodave speciale të hetimit, me qëllim përmirësimin e cilësisë së hetimeve të veprave kundër korrupsionit;

4. Shtimin e numrit të hetimeve për veprat penale në fushën e korrupsionit të zyrtarëve të lartë nga Prokuroria e Posaçme dhe struktura e posaçme hetimore në bashkëpunim me agjencitë e tjera ligjzbatuese;

5. Shtimin e numrit të hetimeve sistematike pasurore dhe hetimit për veprat penale që gjenerojnë produkte/të ardhura, si dhe shtimin e aseteve të sekuestruara/konfiskuara;

6. Përmirësimin e cilësisë së mbajtjes së të dhënave dhe të raportimit, si dhe të dhënave statistikore dhe zhvillimin e sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit;

7. Forcimi i bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese vendëse dhe ndërkombëtare, me qëllim rritjen e numrit të hetimeve të suksesshme, sidomos për kryerjen e hetimeve pasurore financiare dhe që lidhen me veprat penale të korrupsionit;

8. Forcimin dhe rritjen e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta, me fokus në luftën kundër korrupsionit, me agjencitë e zbatimit të ligjit, si dhe me oficerët e policisë gjyqësore;

9. Rritjen e numrit dhe të cilësisë së hetimeve dhe të dënimeve për rastet e referuar nga Task Forca Ndërinstitucionale Antikorrupsion. Bashkëpunimi dhe koordinimi me Prokurorinë e Posaçme për ndjekjen dhe hetimin e këtyre rasteve, sipas kompetencës lëndore.

**Lufta kundër krimit të organizuar**

Krimi i organizuar ka qenë një shqetësim i viteve të fundit jo vetëm për shtetin shqiptar, por edhe më gjerë, ndaj lufta ndaj krimit të organizuar është përveçse një detyrim i brendshëm, edhe një detyrim ndaj organizatave ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është pjesë. Lufta pa kompromis dhe ndëshkimi i ashpër penal ndaj grupeve dhe organizatave kriminale, duke goditur çdo aset ekonomik të paligjshëm të tyre, është prioritet absolut i qeverisë.

Për këtë arsye, nëpërmjet aktit normativ nr. 1, datë 31.1.2020, "Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike", miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 18, datë 5.3.2020, ky akt normativ ka filluar zbatimin, duke dhënë edhe efektet e para në luftën e pakompromis me krimin e organizuar. Nxjerrja e këtij akti normativ nga Këshilli i Ministrave është diktuar nga nevoja për sanksionimin e marrjes së masave parandaluese me karakter personal, pasuror e ekonomik ndaj një kategorie të caktuar subjektesh, për të cilat ka dyshime apo informacion se janë të përfshira, ndihmojnë apo financojnë aktivitete të krimit të organizuar, krimeve të rënda, terrorizmit apo bandave të armatosura, duke përbërë rrezik e cenuar sigurinë publike.

Krijimi i Prokurorisë së Posaçme dhe kompetencat lëndore që ligji ia njeh këtij institucioni në bazë të nenit 75/a, pika "b" parashikojnë kalimin e hetimit të çdo vepre penale të parashikuar nga legjislacioni penal shqiptar të kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur. Pavarësisht se këto vepra kanë qenë objekt hetimi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, sërish nevoja për forcimin e luftës ndaj këtyre formave të bashkëpunimit kriminal ka vijuar të ekzistojë. Në këto rrethana, Prokuroria e Posaçme është institucioni i cili do të duhet të forcojë luftën kundër këtyre formave të bashkëpunimit kriminal, me qëllim vënien përpara përgjegjësisë së pjesëmarrësve në këto organizata dhe garantimin e sigurisë dhe të rendit publik.

Forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit me organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, në drejtim të luftës kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe terrorizmit, është shumë i rëndësishëm për të luftuar këtë fenomen kriminal. Në vijim të marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar nga Shqipëria në vitin 2018 me *Eurojust*-in, ratifikuar me ligjin nr. 113/2018, për bashkëpunimin efikas në aspektin hetimor dhe atë të shkëmbimit të informacionit gjyqësor, me qëllim luftimin e krimit të organizuar në mënyrë sa më të shpejtë, efektive dhe me pak kosto, me iniciativë të Ministrisë së Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme dhe

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në datën 25.2.2019[37], kanë nënshkruar Planin e Veprimit. Ky Plan Veprimi parashikon krijimin e "Regjistrit për komunikimet mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe *Eurojust*-it". Ky dokument është një mekanizëm për garantimin, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar të fushës së të drejtave të qytetarëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së organit të akuzës.

Një prioritet i qeverisë shqiptare vijon të jetë lufta kundër kultivimit të bimëve narkotike dhe trafikut të drogave të ndryshme. Plani Kombëtar kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit 2017–2020[38] vazhdon të jetë në fuqi, plan ky i cili mban në konsideratë faktorët bazë që nxisin kultivimin dhe trafikimin e lëndëve narkotike. Në kuadër të këtij plani, është e rëndësishme goditja e grupeve kriminale që kryejnë veprimtari në fushën e narkotikëve, në të gjitha format e kryerjes së këtyre veprave penale. Arritja e këtij objektivi kërkon konsolidimin e bashkëpunimit të brendshëm dhe ndërkombëtar, sidomos me agjencitë e specializuara në luftën kundër krimit të organizuar, shkëmbim të shpejtë të informacionit, kryerjen e operacioneve të përbashkëta në kuadër të efektivitetit të hetimit penal, mbrojtjen e të dhënave dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, përdorimin e metodave dhe të teknologjisë, si dhe rritjen e profesionalizmit të prokurorëve dhe të oficerëve të policisë gjyqësore.

Gjithashtu, me rëndësi vijon të mbetet zbatimi i kuadrit ligjor mbi sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave kriminale[39], me qëllim ndërprerjen e të ardhurave të grupeve kriminale, e mundësive për të ndërvepruar në terren apo për t'i shpëtuar drejtësisë. Prioritet duhet të jetë forcimi i kapaciteteve dhe i aftësive vepruese të agjencive të zbatimit të ligjit në hetimin financiar dhe garantimin e hetimit financiar si pjesë përbërëse e hetimit penal të përgjithshëm, identifikimi i sfidave dhe i mënyrës së adresimit të sistemeve informale të qarkullimit të parave, të cilat ndikojnë në mundësinë e pastrimit të produkteve të veprës penale.

Për herë të parë në sistemin e burgjeve ka hyrë në fuqi parashikimi ligjor që lidhet me regjimin e mbikëqyrjes së veçantë për të gjithë ata, të paraburgosur dhe të dënuar me rrezikshmëri të veçantë. Ligji nr. 108/2018, "Për një shtesë në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve", i miratuar në fund të vitit 2018[40], i cili ka hyrë në fuqi në 2019, ka parashikuar regjimin e posaçëm në burgun e sigurisë së lartë për personat që kanë kryer një kategori veprash penale me rrezikshmëri të lartë të cilët vijojnë të mbajnë kontakte me grupet e strukturuara kriminale, bandat e armatosura, grupet terroriste, etj. Me qëllim zbatimin dhe unifikimin në praktikë të këtij parashikimi, janë miratuar aktet nënligjore nga Prokurori i Përgjithshëm, i cili ka miratuar udhëzimin nr. 2, datë 24.5.2019, "Për zbatimin e ligjit lidhur me regjimin e posaçëm në burgun e sigurisë së lartë", si dhe nga ministri i Drejtësisë, i cili ka miratuar udhëzimin nr. 5, datë 28.6.2019, "Për procedurën e brendshme e trajtimit të kërkesave për vendosjen e të dënuarve dhe të paraburgosurve në regjimin e posaçëm në burgun e sigurisë së lartë". Procesi i përbashkët për vendosjen e këtyre subjekteve në regjimin e posaçëm, që ka filluar me Prokurorinë e Krimeve të Rënda, gjatë vitit 2020, do të vijojë të adresohet më tej me Prokurorinë e Posaçme, si strukturë përgjegjëse në këtë proces për të propozuar subjektet që duhet të jenë në këtë regjim.

Komiteti i ekspertëve të *Moneyval* të Këshillit të Evropës, në shtesën e raportit të raundit V vlerësues[41] për masat kundër pastrimit të parave dhe luftës kundër terrorizmit (në vijim të raportit për raundin V vlerësues) konstaton se: "... Në përgjithësi, Shqipëria ka bërë një përparim në adresimin e mangësive teknike të përputhshmërisë të identifikuara në raportin e saj të vlerësimit të ndërsjellë të raundit të 5-të dhe është rivlerësuar në

[37] Nr. 334 prot. të KDIMDP-së dhe nr. 623 prot. të PP-së, publikuar në faqen zyrtare: http://www.idp.al/wp-content/uploads/2019/03/Planveprimi_PP_KDIMDP.pdf.

[38] Plani kombëtar kundër kanabisit miratuar me VKM-në nr. 248, datë 29.3.2017, "Për miratimin e planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, 2017–2020", ndryshuar me VKM-në nr. 313, datë 31.5.2018.

[39] Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar.

[40] Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 197, datë 15.1.2019.

[41] Publikuar në dhjetor 2019, në faqen e Këshillit të Evropës: https://rm.coe.int/anti-money-laundering-and-counter-terrorist-financing-measures-albania/16809988c0.

6 rekomandime (6 përmirësime). ... Janë ndërmarrë masa për të përmirësuar përmbushjen e rekomandimeve të komitetit edhe pse mbeten disa boshllëqe, për të cilat Shqipëria inkurajohet të vazhdojë përmbushjen e tyre.

Shqipëria do të mbetet në ndjekje apo në monitorim të zgjeruar dhe do të vijojë të raportojë te *Moneyval* në vazhdimësi, për të forcuar zbatimin e masave kundër pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit. Shqipëria pritet që të raportojë sërish në seancë brenda një viti".

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit, i publikuar në mars 2020, "Volumi 1 – Kontrolli i narkotikëve dhe i lëndëve kimike"[42] dhe "Volumi 2 – Pastrimi i parave dhe krimet financiare"[43], vë theksin te nevoja e rritjes së hetimit dhe dënimit të rasteve të veprave penale për trafikim të lëndëve narkotike (droga të forta), si dhe hetimin e pastrimit të parave të krimit të organizuar në pasuri të paluajtshme dhe projekte zhvillimi. Konkretisht, në këtë raport theksohet, se: "Në vitin 2019, vëllimi i drogës së sekuestruar dhe numri i të arrestuarve nga autoritetet shqiptare ishte i lartë, nxitur nga bashkëpunimi i organeve ligjzbatuese me partnerët e ndërkombëtarë, presionin ndërkombëtar dhe përpjekjet për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

... Shqipëria është në proces miratimi të reformës në drejtësi për të rritur efektivitetin e ndjekjes penale dhe të dënimit të autorëve të trafikut të drogës duke shfrytëzuar lidhjen e tyre me krimin e organizuar.".

Trafiku i narkotikëve dhe veprat e paligjshme të grupeve të organizuara janë burimi kryesor i të ardhurave të paligjshme. Ndër metodat më të përhapura të pastrimit të parave janë investimi në pasuri të paluajtshme dhe projekte zhvillimi.

Nga 1 janari 2019 janë ndaluar me ligj të gjitha lojërat e fatit dhe bastet sportive, duke u hequr një mundësi kriminelëve për të fshehur ose për të pastruar të ardhura të paligjshme. Gjykatat shqiptare shpesh nuk dënojnë për pastrim parash në mungesë të akuzës për veprën penale "mëmë" edhe pse kjo nuk parashikohet në ligj. Implementimi i ndryshimeve në Kodin Penal mbetet sfidë dhe pavarësisht numrit të hetimeve për pastrimin e parave, numri i dënimeve mbetet i ulët.

Progresraporti 2019[44], në lidhje me pastrimin e parave, konstaton, se: "Nevojiten më shumë përpjekje për të luftuar pastrimin e parave dhe konfiskimin e pasurive, që rrjedhin nga krimi dhe pasuritë e tjera të pajustifikuara. Shqipëria duhet që, në veçanti, të bëjë përparim të mëtejshëm të prekshëm në çmontimin në mënyrë efektive të grupeve të krimit të organizuar, konfiskimin e të ardhurave të krimeve të kryera prej tyre, të miratojë një strategji dhe një plan të ri veprimi për drogat, të plotësojë boshllëkun legjislativ mbi prekursorët e drogës dhe të intensifikojë luftën kundër trafikimit të drogërave të forta, të miratojë një strategji të krimit kibernetik dhe të krijojë një përgjigje më efektive të zbatimit të ligjit, duke u përqendruar në zbulimin, gjurmueshmërinë dhe ndjekjen penale të kriminelëve".

Referuar analizës për vitin 2019 që Ministria e Drejtësisë ka kryer, rezultojnë se:

- Lidhur me veprat penale kundër krimit të organizuar jepen të dhëna për një rritje me 24.4% të regjistrimit të procedimeve, rritje prej 1,16 herësh të çështjeve të dërguara për gjykim dhe trefishim të numrit të personave të pandehur. Në lidhje me ekzekutimin e vendimeve janë ekzekutuar 89 vendime, të paraqitura sipas veprave penale konkrete.

- Konstatohet, gjithashtu, një rritje e hetimeve proaktive dhe e përdorimit të mjeteve speciale të hetimit, duke shënuar një rritje prej 23.6%, në krahasim me vitin 2018, por përsëri nevojitet angazhim i të gjitha strukturave ligjzbatuese dhe koordinim për rritjen jo vetëm të numrit, por edhe të hetimeve cilësore.

- Si nga rekomandimet e *Moneyval* dhe nga Komisioni Evropian, theksi vihet te lufta në

[42] *2020 International Narcotics Control Strategy Report, Volume 1 drug and Chemical Control,* publikuar në faqen https://www.state.gov/wwp-content/uploads/2020/03/Tab-1-INCSR-Vol.-I-Final-for-Printing-2-25-20-508.pdf.

[43] *2020 International Narcotics Control Strategy Report, Volume 2 Money Laundering and financial crimes,* publikuar në faqen zyrtare: https://www.state.gov/wwp-content/uploads/2020/03/Tab-2-INCSR-Vol-2-508.pdf.

[44] *Albania 2019 Report, Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2019 Communication on EU Enlargement Policy,* publikuar në faqen: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf.

mënyrë efektive e grupeve të krimit të organizuar dhe në hetimin për pastrimin e parave apo pasurive që rrjedhin nga krimi dhe pasuritë e pajustifikuara.

- Lidhur me veprat penale të trafikimit[45], për vitin 2019 rezulton se janë regjistruar 283 çështje penale me 55 persona në hetim, nga të cilët vetëm 16 janë marrë si të pandehur. Nga këto çështje janë dërguar për gjykim 26 çështje me 35 të pandehur ose rreth 9,18 % e çështjeve të regjistruara. Numrin më të madh të çështjeve të hetuara e zë vepra penale "Trafikimi i mjeteve motorike" parashikuar nga neni 141/a i K. Penal, me 170 çështje të regjistruara.

Nga analiza e të dhëna statistikore për veprat penale të trafikimit rezulton një rritje e numrit[46] të çështjeve të regjistruara, me 68 çështje më tepër dhe rritje e numrit të personave nën hetim me 19 persona më tepër dhe të personave të marrë si të pandehur, me 8 persona më tepër. Lidhur me numrin e çështjeve të dërguara për gjykim për vitin 2019, numri i tyre është rritur me 3 çështje më tepër, ndërsa numri i të pandehurve në gjykim është i njëjtë krahasuar me vitin 2019[47].

- Gjatë vitit 2019 janë regjistruar 51 çështje, me 57 persona nën hetim për veprat penale të krimit të organizuar, ku të gjitha çështjet janë regjistruar për veprën penale "Grupi i strukturuar kriminal", neni 333/a i K. Penal (të dy paragrafët). Për këto vepra penale, gjatë vitit 2019 janë dërguar për gjykim 13 çështje, me 126 të pandehur, të gjithë për veprën penale "Grupi i strukturuar kriminal", neni 333/a i K. Penal.

- Për këtë vepër penale, krahasuar me vitin 2018[48] konstatohet një rritje e numrit të çështjeve të regjistruara prej 10 procedimesh më tepër dhe i numrit të personave nën hetim, me 14 persona nën hetim më tepër, si dhe ka një rritje të numrit të çështjeve të dërguara për gjykim, me 7 çështje më tepër dhe 96 të pandehur më tepër[49].

- Për veprat penale kundër narkotikëve konstatohet se në vitin 2019 janë hetuar më shumë çështje penale se në vitin 2018 (me 99 çështje më tepër). Por edhe në këtë drejtim mbetet në nivele më të ulëta se viti 2018 numri i çështjeve të dërguara për gjykim. Lidhur me veprat penale në fushën e lëndëve narkotike[50], në vitin 2019 janë hetuar 2558 çështje penale ose 99 çështje penale më tepër se viti 2018. Rezulton se janë hetuar 1048 persona dhe janë marrë të pandehur 880 persona. Krahasuar me vitin 2018[51] rezultojnë 66 persona më pak të hetuar dhe 35 më pak të pandehur. Janë dërguar për gjykim 505 çështje ose 19,7 % e çështjeve, me 701 të pandehur, nga ku rezulton rënie krahasuar me vitin 2018 me 28 çështje më pak të dërguara për gjykim dhe 71 të pandehur më pak[52]. Numrin më të lartë të çështjeve në hetim e zë vepra penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", neni 283 K. Penal, me 1423 çështje në hetim, nga të cilat janë dërguar për gjykim 383 çështje.

- Konstatohet se vijon të mbetet i ulët numri i veprave penale kundër terrorizmit, pavarësisht kompleksitetit dhe vështirësisë që kanë në hetim këto vepra, pavarësisht rritjes me 1.5 herë të numrit të procedimeve të regjistruara. Lidhur me këtë kategori veprash penale[53], rezulton se janë regjistruar në total 8 çështje për vitin 2019 me 4 persona nën hetim dhe asnjë person i marrë si i pandehur. Nuk rezulton asnjë çështje e dërguar për gjykim për këtë kategori veprash për vitin 2019 sikurse në vitin e kaluar, edhe pse krahasuar me vitin 201854, vihet re një rritje e numrit të çështjeve të regjistruara me 4 çështje më shumë dhe në ndryshim nga 2018 ka 4 persona nën hetim.

- Sa i përket rritjes së hetimeve proaktive, për vitin 2019 janë kryer hetime proaktive dhe përdorim i mjeteve speciale të hetimit në 309 procedime penale, për vepra penale kundër krimit të organizuar, trafiqeve, pastrimit të parave dhe krimeve të tjera të rënda, duke pasur një rritje prej

[45] Nenet 109, 109/b, 110/a, 128/b, 138/a, 141/a, 278/a dhe 282/a të K. Penal.

[46] Në vitin 2018 ishin regjistruar 215 çështje penale, me 36 persona në hetim, nga të cilët 8 janë marrë si të pandehur.

[47] Në vitin 2018 ishin dërguar për gjykim 23 çështje, me 35 të pandehur për këtë kategori veprash penale.

[48] Në vitin 2018, për këto vepra ishin regjistruar 41 çështje, me 43 persona nën hetim.

[49] Në vitin 2018 janë dërguar për gjykim 6 çështje me 30 të pandehur.

[50] Ku janë përfshirë 283/a; 283/b; 284/cc; 285/a; 285/b; 286 dhe 286/a të K. Penal.

[51] Në vitin 2018 kanë qenë 2459 çështje të hetuara, me 1114 persona nën hetim dhe 915 të pandehur.

[52] Në vitin 2018 janë dërguar për gjykim 533 çështje me 772 persona të pandehur.

[53] Nenet 230–232/b të Kodit Penal.

[54] Në vitin 2018 ishin regjistruar 4 çështje penale, pa asnjë person nën hetim dhe asnjë të pandehur.

23.6% nga viti i kaluar; të cilat janë finalizuar me arrest/ndalim të 420 personave;

- Lidhur me veprat penale për nxitjen e urrejtjes dhe pjesëmarrjen në konfliktet e armatosura[55], për vitin 2019, janë regjistruar 4 çështje penale për veprën penale: "Nxitja e urrejtjes ose e grindjeve" parashikuar nga neni 265 i K. Penal, mirëpo nuk ka pasur persona nën hetim apo persona të marrë si të pandehur. Rezulton një rënie e numrit të çështjeve me 1 çështje më pak krahasuar me vitin 2018[56], por njësoj si gjatë vitit 2018 nuk rezulton asnjë çështje e dërguar për gjykim për këtë kategori veprash.

Sa më sipër, Këshilli i Ministrave, me qëllim forcimin e luftës kundër krimit të organizuar, i rekomandon Prokurorit të Përgjithshëm:

1. Hetimin në mënyrë efektive të grupeve të krimit të organizuar dhe hetimin për pastrimin e parave apo të pasurive që rrjedhin nga krimi dhe pasuritë e pajustifikuara nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokuroria e Posaçme;

2. Rritjen e rasteve hetimore, në zbatimin e gamës së plotë të masave të sekuestrimit dhe të konfiskimit, veçanërisht duke u përqendruar në palët e treta të përfshira në pastrimin e parave, nga profesionet e lira dhe nga vetë subjektet raportuese, si dhe për asetet që përfaqësojnë të ardhura indirekte;

3. Bashkëpunimin me strukturat shtetërore dhe agjenci të tjera vendëse që janë përgjegjëse dhe/ose disponojnë informacion për parandalimin e pastrimit të parave;

4. Krijimin e një sistemi statistikor të monitorimit të çështjeve të pastrimit të parave për të siguruar një bazë të besueshme për reforma të mëtejshme, për të rritur numrin e procedimeve penale dhe dënimeve për veprat penale të pastrimit të parave;

5. Përmirësimin e cilësisë së hetimeve për veprat penale në fushën e narkotikëve, e fokusuar te drogat e forta, nëpërmjet përdorimit të metodave speciale të hetimit dhe rritje të numrit të hetimeve proaktive për këto vepra;

6. Ashpërsim të politikës penale në drejtim të masave të sigurimit dhe të dënimit për veprat penale në fushën e narkotikëve;

7. Rritje të numrit dhe të cilësisë së hetimeve për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale dhe atë të pastrimit të parave, në funksion të rritjes së numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim;

8. Rritje të numrit dhe të cilësisë së hetimeve, duke përdorur teknikat speciale të hetimit, veçanërisht në rastet e hetimeve pasurore;

9. Vijimin e zbatimit të planit të veprimit, në lidhje me marrëveshjen me *Eurojust*, duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar, në kuadër të hetimit dhe duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me të dhënat personale;

10. Vijimin e zbatimi të planit të veprimit të qeverisë për masat në fushën e parandalimit të pastrimit të parave si rekomandime të raportit të *Moneyval*;

11. Rritjen e bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale, që lidhen sidomos me trafikimin e narkotikëve, pastrimit të parave, financimin e terrorizmit, trafikimin e qenieve njerëzore etj.;

12. Bashkëpunimi i Prokurorisë së Posaçme me Policinë e Shtetit dhe OFL-në për zbatimin e objektit dhe qëllimin e ligjit për masat parandaluese, në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike;

13. Forcim të kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve në këtë fushë, duke përfshirë edhe trajnime të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore.

**Forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut**

Respektimi i të drejtave të njeriut është një nga objektivat kryesorë të shtetit shqiptar, jo vetëm si një prioritet i vendosur nga Bashkimi Evropian, por si detyrim kushtetues për garantimin e të drejtave të çdo personi.

Në garantim të të drejtave të njeriut, fokusi vendoset më tepër te grupet vulnerabël, si pjesë e shoqërisë e cila kërkon mbrojtje dhe kujdes të veçantë. Një nga grupet më vulnerabël të cilët kërkojnë një vëmendje dhe mbrojtje të veçantë nga shteti janë të miturit. Garantimi dhe mbrojtja e të drejtave të tyre ka qenë një mision i qeverisë shqiptare, e cila ka miratuar Strategjinë e Drejtësisë

[55] Nenet 265–265/c të K. Penal.

[56] Në vitin 2018 janë regjistruar 5 çështje penale me 2 persona të pandehur.

për të Miturit[57], me propozim të Ministrisë së Drejtësisë shoqëruar me Planin e Veprimit, 2018–2021, duke përbërë dokumentin e parë të politikave strategjike të qeverisë shqiptare për të drejtësinë penale për të miturit, e cila ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2018 dhe përcakton shtyllat bazë të reformës së drejtësisë për të miturit. Kuadri ligjor për mbrojtjen e të miturve është tashmë i plotë dhe synon promovimin e mbrojtjen e drejtave dhe nevojave të të miturve në konflikt me ligjin, viktima apo dëshmitarë të veprave penale, në të gjitha proceset gjyqësore. Të gjitha organet ligjzbatuese që kanë në fushën e tyre të përgjegjësisë trajtimin dhe procedimin me persona të mitur në zbatim të ligjit, duhet të forcojnë bashkëpunimin ndërinstitucional, me qëllim garantimin e interesit më të lartë të të miturve në çdo fazë apo pozicion procedural të procesit penal.

Dhuna në familje ka qenë dhe është, gjithashtu, një nga drejtimet ku qeveria ka fokusuar punën e saj nëpërmjet programeve, iniciativave dhe strategjive për adresimin më të mirë të rasteve të dhunës në familje. Një ndër rekomandimet e vitit 2019 ka qenë pikërisht ashpërsimi i masave të sigurimit dhe të dënimit për këto vepra, ndërkohë që, për shkak të ngjarjeve të rënda, ka pasur propozime për ndryshime ligjore, me qëllim ashpërsimin e mëtejshëm të dispozitës së Kodit Penal dhe të ndalimit të masës së garancisë pasurore për këtë vepër, ndryshime këto të paraqitura në Kuvend në vitin 2020[58] dhe të miratuara me ligjin nr. 35/2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar[59].

Në vitin 2019, me ligjin nr. 44/2019, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, u bë ndërhyrja në Kodin Penal, duke ndryshuar dispozitat ekzistuese dhe duke shtuar dispozita të reja në lidhje me veprat penale në fushën e mjedisit. Ndryshimi i veprave penale ekzistuese dhe shtimi i dispozitave të reja është bërë në kuadër të përafrimit të legjislacionit të brendshëm me legjislacionin e Bashkimit Evropian, konkretisht më direktivën 2008/99/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, "Për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet legjislacionit penal"[60], me synimin e ashpërsimit të masave të dënimit për veprat penale në këtë fushë, penalizimin si vepra penale të sjelljeve/aktiviteteve të caktuara. Duke pasur parasysh periudhën e hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve, është e nevojshme njohja e elementëve të figurave të këtyre veprave penale dhe zbatimi në praktikë, duke zhvilluar hetime dhe marrjen në përgjegjësi penale.

Referuar analizës për vitin 2019 që Ministria e Drejtësisë ka kryer, rezulton se:

- Në lidhje me rekomandimin për zbatimin e urdhrit penal, marrëveshjes dhe gjykimit të drejtpërdrejtë me efektivitet, rezulton se krahasuar me vitin 2018, numri i çështjeve për të cilat është kërkuar miratimi i urdhrit penal dhe i marrëveshjes është relativisht i ulët. Gjatë vitit 2019[61] janë paraqitur 714 kërkesa për miratim të urdhrit penal për 735 të pandehur dhe 584 kërkesa për miratim të marrëveshjes me 595 të pandehur. Krahasuar me vitin 2018[62], rezulton një rritje e zbatimit të këtyre instituteve me 123 kërkesa për urdhër penal më tepër për 116 të pandehur më tepër dhe 14 kërkesa për marrëveshje më tepër, por 26 persona më pak të pandehur. Sipas të dhënave gjykata ka miratuar 82% të kërkesave për urdhrin penal dhe 75% të kërkesave për marrëveshje.

Gjithashtu, nga Prokuroria e Përgjithshme po përgatitet një projektudhëzim për marrëveshjen si institut i ri.

- Lidhur me rekomandimin për rritjen e kërkesave për dhënien e dënimeve alternative, Prokuroria e Përgjithshme evidenton se për vitin 2019, kërkesat e prokurorëve për caktimin e dënimit sipas neneve 59 dhe 63 të Kodit Penal, zënë 64.7% të të gjithë kërkesave për caktimin e

[57] Miratuar me VKM-në nr. 541, datë 19.9.2018, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 138, datë 19.9.2018.

[58] Projektligje në procedurë të propozuara në datat 10.1.2020 dhe 6.2.2020, publikuar në faqen e Kuvendit: https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje20NDRYSHUAR.pdf.

[59] Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 72, datë 23.4.2020.

[60] Indeksuar në faqen: https://eurlex.europa.eu/legalcontent/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32008L0099&from =EN.

[61] Të dhëna të paraqitura me shkresën nr. 1368/42 prot., datë 26.2.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, regjistruar me tonën nr. 156/2 prot., datë 26.2.2020.

[62] Në vitin 2018 kanë qenë 591 kërkesa për miratim të urdhrit penal me 619 të pandehur dhe 570 kërkesa për miratim të marrëveshjes me 621 të pandehur.

dënimeve, ndërsa vendimmarrja e gjykatës për dhënien e dënimeve alternative zë 69.2% të vendimeve për këtë grup veprash;

- Nga të dhënat statistikore rezulton se gjykimi i drejtpërdrejtë vijon të mbetet një nga llojet e gjykimeve më pak të kërkuara nga organi i prokurorisë. Organi i prokurorisë për vitin 2019 ka dërguar për gjykim 10396 çështje (nuk përfshihen çështjet e mbartura në gjykim), por vetëm për 218 prej tyre prokuroria ka kërkuar që të gjykohen me procedurë gjykimi të drejtpërdrejtë ose me rreth 2,09%. Rezulton një ulje e numrit të çështjeve të dërguara për gjykim krahasuar me vitin 2018[63], si dhe ulje e çështjeve për të cilat është kërkuar gjykimi i drejtpërdrejtë. Ndërkohë që, për vitin 2019 një nga rekomandimet e Këshillit të Ministrave ka qenë edhe rritja e rasteve të kërkuara nga organi i prokurorisë për gjykimin e drejtpërdrejtë.

- Në lidhje me rekomandimim për hetime të shpejta, efektive dhe ashpërsimin e dënimit për veprat penale, që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar udhëzimin e përgjithshëm nr. 3, datë 21.6.2019, "Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhjeve". Gjithashtu, janë përforcuar shërbimet e gatishmërisë në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm në periudhën zgjedhore. Referuar të dhënave statistikore në vitin 2019 janë regjistruar 23 procedime penale me 15 të pandehur për vepra penale, që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, janë dërguar për gjykim 2 çështje penale, me 5 të pandehur dhe janë dënuar 4 persona.

- Në lidhje me veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës[64] rezulton se për vitin 2019 janë regjistruar 1247 çështje penale me 368 persona nën hetim dhe janë marrë 708 të pandehur. Krahasuar me vitin 2018[65] rezultojnë 107 çështje më pak të regjistruara; 27 persona më pak nën hetim dhe 161 të pandehur më pak. Në lidhje me këtë kategori veprash rezulton se për vitin 2019 janë dërguar për gjykim 879 çështje me 936 të pandehur. Krahasuar me një vit më parë[66] ka një rënie prej 173 çështjesh më pak të dërguara për gjykim dhe 182 të pandehur më pak.

Në lidhje me veprën penale "Dhuna në familje", parashikuar nga neni 130/a i K. Penal, për vitin 2018 janë regjistruar 1140 çështje penale ose rreth 2,4% e të gjitha çështjeve penale të regjistuara[67] me 339 persona nën hetim dhe janë marrë në cilësinë e të pandehurit 685 persona. Krahasuar me vitin 2018[68] konstatohet një rënie e numrit të çështjeve të regjistruara me 69 çështje më pak, 14 persona nën hetim më pak dhe 157 të pandehur më pak.

Rezulton se në vitin 2019 janë dërguar për gjykim 834 çështje për këtë vepër penale, me total prej 888 të pandehurish, çka përbën një rënie prej 173 çështjesh dhe 181 të pandehurish më pak krahasuar me vitin 2018[69]. Numri i çështjeve të dërguara për gjykim për këtë vepër përbën rreth 8% të numrit total të çështjeve të dërguara për gjykim gjatë vitit 2019[70]. Nga këto çështje, për vitin 2019 janë gjykuar 734 çështje me 792 të pandehur, duke pësuar një rënie me 43 çështje më pak dhe 28 të pandehur më pak se në vitin 2018[71].

Lidhur me politikën e dënimit të ndjekur gjatë gjykimit, në çështjet e dërguara për gjykim nga prokuroria për dhunën në familje, nuk është kërkuar në asnjë rast dënimi maksimal i parashikuar nga paragrafi përkatës i dispozitës (në vitin 2018 është kërkuar në 12 raste). Gjithashtu: i. në ndryshim nga viti 2018 nuk është kërkuar në asnjë rast dënimi me gjobë; ii. për 11 të pandehur është kërkuar dënimi sa periudha e paraburgimit; iii. për 171 të pandehur është kërkuar dënimi minimal i parashikuar nga dispozita72; iv. për 294 të pandehur është kërkuar dënim mesatar73; v. për 13

[63] Për vitin 2018 janë dërguar për gjykim 11790 çështje, për 315 prej të cilave është kërkuar gjykimi i drejtpërdrejtë.

[64] Seksioni IX, nenet 124–130/a të Kodit Penal.

[65] Në vitin 2018 ishin regjistruar 1354 çështje me 395 persona nën hetim dhe 869 të pandehur.

[66] Në vitin 2018 ishin dërguar për gjykim 1052 çështje me 1118 të pandehur.

[67] Për vitin 2019 janë regjistruar në total 47341 çështje.

[68] Për vitin 2018 janë regjistruar 1209 çështje me 353 persona nën hetim dhe 842 persona në cilësinë e të pandehurit gjatë hetimeve.

[69] Në vitin 2018 janë dërguar për gjykim 1007 çështje me 1069 të pandehur.

[70] Numri total i çështjeve të dërguara në gjyq në vitin 2019 është 10396 çështje.

[71] Në vitin 2018 janë gjykuar 777 çështje me 820 të pandehur.

[72] Në vitin 2018, dënimi minimal është kërkuar për 229 të pandehur.

[73] Në vitin 2018 dënimi mesatar i parashikuar nga dispozita është kërkuar për 298 të pandehur.

raste është kërkuar ulja e dënimit nën minimumin e parashikuar nga dispozita; vi. për 304 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit[74]. Nuk konstatohet ashpërsim i politikës penale, në lidhje me këtë vepër, pavarësisht rekomandimit të dhënë për vitin 2019.

Nga të dhënat statistikore rezulton se në çështjet penale të regjistruara gjatë vitit 2019, ka pasur 448 të pandehur të mitur të moshës 14–18 vjeç, nga të cilët 434 janë meshkuj dhe 14 femra, ndërsa kanë rezultuar 77 viktima të mitur, nga të cilët 41 meshkuj dhe 36 femra. Nga të dhënat e përcjella nga Prokuroria e Përgjithshme për të miturit për vitin 2019, në prokuroritë e rretheve gjyqësore janë regjistruar 397 procedime me 388 persona në hetim, nga ku 141 çështje janë dërguar për gjykim, duke shënuar një rënie me 26 procedime më pak dhe 93 persona nën hetim më pak krahasuar me vitin 2018[75]. Për sa u përket masave të sigurimit personal, rezulton se në 23 raste është caktuar masa e sigurisë personale: "Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i K. Pr. Penale, në 1 rast është caktuar masa e sigurisë "Arrest në shtëpi", parashikuar nga neni 237 i K. Pr. Penale, në 1 rast është caktuar masa e sigurisë "Vendosja në një shërbim të specializuar" parashikuar nga neni 84 i KDPM-së, dhe në 16 raste janë vendosur masa të tjera sigurimi. Në krahasim me masat e sigurisë të caktuara gjatë vitit 2018 konstatohet një ulje e numrit të masave të sigurimit të parashikuara nga neni 238 i K. Pr. Penale me 2 masa më pak; ulje e numrit të masës së sigurimit të parashikuar nga 237 i K. Pr. Penale me 10 më pak; si dhe ulje e masave të tjera të sigurimit të caktuara me 50 më pak[76]. Në lidhje me masën e sigurimit personal "arresti në burg" konstatohet se ajo është caktuar në rreth 52.27% të rasteve, një rritje kjo nga viti 2018[77].

- Në lidhje me veprat penale në fushën e mjedisit, krahasuar me vitin 2018, vihet re një rritje e lehtë e numrit të çështjeve, por sërish numri i çështjeve vijon të jetë i ulët. Numri më i madh i çështjeve penale vijon të jetë i regjistruar për veprën penale "Prerja e paligjshme e pyjeve" parashikuar nga neni 205 i K. Penal. Ulje ka pasur edhe mbi numrin e çështjeve të dërguara për gjykim për këtë grup veprash penale. Në lidhje me veprat penale në fushën e mjedisit[78], në vitin 2019 janë regjistruar 264 çështje penale ose 0,56% e totalit të çështjeve të regjistruara në këtë vit. Krahasuar me vitin 2018[79], vihet re një rritje e lehtë e numrit me 17 çështje më tepër, por sërish numri i çështjeve vijon të jetë i ulët. Numri më i madh i çështjeve penale vijon të jetë i regjistruar për veprën penale "Prerja e paligjshme e pyjeve" parashikuar nga neni 205 i K. Penal me 163 çështje të regjistruara.

- Lidhur me rekomandimin e përmirësimit të aftësive profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve, me fokus specializimin dhe krijimin e profesionistëve që administrojnë procesin e drejtësisë penale për të mitur Shkolla e Magjistraturës dhe SIDA, në kuadër të projektit shqiptaro-sudez për drejtësinë penale për të mitur kanë zhvilluar 11 aktivitete trajnuese, ku kanë marrë pjesë 33 prokurorë, 15 kandidatë për prokurorë dhe 4 oficerë të policisë gjyqësore.

Këshilli i Ministrave, me qëllim forcimin e respektimit të të drejtave të njeriut, i rekomandon Prokurorit të Përgjithshëm:

1. Vijimin e rritjes së numrit të rasteve të zbatimit të instrumenteve të reja penale, siç janë urdhri penal, marrëveshja, si dhe rritjen e rasteve të gjykimit të drejtpërdrejtë, me synim hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale në një afat sa më të shpejtë, duke mbajtur në konsideratë kompleksitetin dhe rrezikshmërinë e veprës, ruajtur efikasitetin dhe cilësinë e hetimeve;

2. Rritja e aplikimit të dënimeve alternative në rastet e veprave penale dhe/ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, veçanërisht në rastet e të miturve;

3. Ashpërsim të masave të sigurimit dhe masës së dënimit për veprat me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese, si dhe për rastet e

[74] Në vitin 2018, pezullimi i ekzekutimit është kërkuar për 299 të pandehur.

[75] Në vitin 2018 në prokuroritë e rretheve gjyqësore janë regjistruar 423 procedime, me 481 persona të mitur në hetim.

[76] Në vitin 2018 në 25 raste është caktuar masa e sigurisë personale "Arrest në burg" parashikuar nga neni 238 i K. Pr. Penale, në 11 raste është caktuar masa e sigurisë "Arrest në shtëpi" parashikuar nga neni 237 i K. Pr. Penale dhe në 66 raste janë vendosur masa të tjera sigurimi.

[77] Në vitin 2018 masa e sigurimit persona "arresti në burg" është caktuar në rreth 24% të rasteve.

[78] Nenet 201–207 të Kodit Penal, përfshirë ndryshimet e reja të vitit 2019.

[79] Në vitin 2018 ishin regjistruar 247 çështje penale.

keqtrajtimit/abuzimit/shfrytëzimit e trafikimit të fëmijëve;

4. Në kuadër të ndryshimeve të reja të Kodit Penal, në lidhje me veprën penale "Dhuna në familje", parashikuar nga neni 130/a i Kodit, rritjen e cilësisë së hetimeve dhe ashpërsimin e politikës penale për këtë vepër.

5. Njohja me kuadrin e ri ligjor, pjesë e ndryshimeve të Kodit Penal, në lidhje me veprat penale në fushën e mjedisit dhe zbatimi efektiv në praktikë i tyre. Rritja e numrit dhe cilësisë së hetimeve për këtë kategori veprash penale;

6. Rritja e numrit të trajnimeve të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, veçanërisht për veprat penale me bazë gjinore, seksuale dhe përfshirjen e të miturve;

7. Vijim i punës me fokus në kryerjen e hetimeve të shpejta, efektive dhe ashpërsim të politikës së dënimit për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve. Kryerje e hetimeve cilësore dhe rritje e numrit të çështjeve të dërguara për gjykim.

**Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional**

Mënyra më efektive për të luftuar kriminalitetin dhe për të kryer hetime cilësore që finalizohen me vënien para drejtësisë të personave përgjegjës, është bashkëpunimi ndërinstitucional ndërmjet agjencive ligjzbatuese të brendshme por edhe ndërkombëtare.

Lufta ndaj grupeve të strukturuara kriminale, organizatave kriminale apo terroriste është më e lehtë dhe premisat për të pasur sukses janë më të mëdha në rastet kur organet ligjzbatuese bashkëpunojnë më njëra-tjetrën. Bashkëpunimi i organeve të hetimit me ILDKPKI-në, KLSH-në, DPPPP-në, ASHK-në apo edhe subjekteve private, të tilla si: bankat, firmat e ndërtimit, agjencitë e pasurive të paluajtshme, agjencive turistike etj. është një parakusht për suksesin e luftës kundër kriminalitetit. Shumë i rëndësishëm është edhe bashkëpunimi ndërkombëtar me agjencitë analoge, sidomos për veprat penale me natyrë ndërkombëtare si terrorizmi, krimi i organizuar, krimi ndërkufitar, parandalimi i krimeve kompjuterike të përdorura për pastrimin e të ardhurave nga aktivitete kriminale në përgjithësi, si dhe ato për financimin e terrorizmit, si dhe bashkëpunimet e posaçme për personat që i fshihen drejtësisë.

Bashkëpunimi ndërkombëtar në formën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritet e huaja në fushën penale është, gjithashtu, i rëndësishëm dhe kërkon fillimisht koordinimin ndërinstitucional midis organit të prokurorisë dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese apo institucioneve të tjera që marrin pjesë aktive në këtë proces me qëllim finalizimin me sukses dhe në një kohë sa më të shpejtë të bashkëpunimit me autoritetet e huaja.

Institucionet të cilat kanë në varësi të tyre struktura që kanë statusin e oficerëve të policisë gjyqësore shprehin shqetësimin e tyre, në lidhje me bashkërendimin e punës me institucionet e tjera në luftën kundër kriminalitetit. Problematikat lidhen me forcimin e bashkëpunimit dhe përfshirjen e oficerëve në hetimin e çështjeve ose në grupe hetimore të përbashkëta, veçanërisht në çështjet komplekse të krimit të organizuar dhe korrupsionit, përmirësimin e kapaciteteve profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore dhe koordinimin me prokurorinë në funksion të rritjes së efektivitetit dhe cilësisë së hetimeve që kryhen prej tyre.

Nga statistikat e prokurorisë për vitin 2019 konstatohet se numri më i madh i referimeve ka ardhur nga policia e shtetit me 36360 çështje të referuara, ndërkohë që referimet e policive të tjera janë si vijon: 66 çështje të referuara nga policia e ndërtimit[38] çështje të referuara nga policia financiare; 30 çështje të referuara nga policia pyjore; 2 çështje të referuara nga policia elektrike; dhe 264 çështje të referuara nga policitë e tjera. Përveç referimeve nga policia e shtetit, numri i referime të tjera vijon të jetë i ulët edhe pse konstatohet një rritje e lehtë në krahasim me vitin 2018[80].

Bashkëpunimi i organeve të hetimit dhe përfshirja e tyre në hetim shmang hetimet joefektive dhe të dështuara, duke krijuar kështu historik suksesi mbi referimet dhe hetimin e veprave penale, duke çuar në përfundimin final që është dhënia e drejtësisë efektive, në afate të arsyeshme.

Një rëndësi kyçe, sidomos për veprat penale të rënda si veprat në fushën e korrupsionit apo krimit të organizuar, ka edhe bashkëpunimi ndërkombëtar, shkëmbimi i informacionit dhe i

[80] Të dhënat për vitin 2018 kanë qenë: 36511 referime nga policia e shtetit; 36 referime nga policia financiare; 20 referime nga policia elektrike; 19 referime nga policia pyjore; dhe 249 referime nga policitë e tjera, nuk ka pasur referime nga Policia e Ndërtimit.

përvojës, organizimi i operacioneve të përbashkëta dhe mbështetja logjistike dhe financiare nga partnerët ndërkombëtarë.

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve prioritare të dhëna për vitin 2019 në drejtim të bashkëpunimit ndërinstitucional, nga organi i prokurorisë rezulton:

- Për sa i përket rekomandimit për rritjen e bashkëpunimit me policinë gjyqësore në funksion të përmirësimit të cilësisë së veprimeve hetimore në muajin korrik 2019, në zbatim të ligjit 25/2019, "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore" u ngrit dhe nisi funksionimin Komisioni i Policisë Gjyqësore, si dhe sekretariati teknik për funksionimin e tij. Komisioni ka filluar punën për nxjerrjen e akteve nënligjore, si dhe ka trajtuar kërkesat e ardhura nga institucionet përkatëse për lëvizje, emërime, transferime dhe komandime të oficerëve të policisë gjyqësore. Gjithashtu, komisioni në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme po punon për të siguruar koordinimin, shkëmbimin e informacionit dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë në të gjitha institucionet që kanë shërbime të policisë gjyqësore. Në Prokurorinë e Përgjithshme është ngritur grupi i punës për hartimin e udhëzimit, riorganizimin e seksioneve të policisë gjyqësore dhe koordinimin e punës, për shkak të shfuqizimit të udhëzimit të përbashkët me ministrin e Brendshëm nr. 1227/1, datë 1.4.2008, "Për funksionimin e shërbimeve të policisë gjyqësore". Ndërkohë, në Policinë e Shtetit ende nuk janë ngritur ende strukturat hetimore, ndaj në bashkëpunim me projektin *Euralius V* është parashikuar ky udhëzim në 6-mujorin e vitit 2020.

- Në lidhje me rekomandimet për forcimin e bashkëpunimit me të gjitha agjencitë ligjzbatuese kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe bashkëpunimin me autoritetet gjyqësore vendëse dhe të huaja kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, sërish jepen të dhëna në lidhje me marrëveshjen e vitit 2018 me Ministrinë e Brendshme, e cila ka përfunduar me krijimin e Prokurorisë së Posaçme më 18 dhjetor 2019. Në lidhje me bashkëpunimin me agjencitë ligjzbatuese referohen në të dhënat e paraqitura për veprat penale kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe trafikimeve. Në vitin 2019 është nënshkruar një marrëveshje e re me shtetin italian për ngritjen e grupit hetimor për çështjet e organizatave kriminale, me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike. Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, si pikë kontakti i rrjetit në *Eurojust* dhe Rrjetin Europian të Prokurorëve (EJN), gjatë vitit 2019 ka administruar 21 kërkesa nga autoritetet e huaja anëtare të *Eurojust*. Në lidhje me marrëdhëniet juridisionale me jashtë, paraqiten të dhënat ku rezultojnë 180 ekstradime nga jashtë, 157 ekstradime për jashtë; 625 letërporosi nga jashtë; 639 letërporosi për jashtë. Në bashkëpunim me *Euralius* V, është ngritur një grup pune për hartimin e një udhëzimi për bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në fushën e krimit kibernetik.

- Në lidhje me zbatimin e rekomandimit për organizimin e trajnimeve të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore, me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale, Komisioni i Policisë Gjyqësore, së bashku me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Shkollën e Magjistraturës ka bashkërenduar punën, me qëllim hartimin e një kalendari trajnimesh për tema të caktuara, hartimin e programeve përkatëse dhe organizimin e trajnimeve.

- Në lidhje me zbatimin e rekomandimit të forcimit të koordinimit ndërinstitucional, në lidhje me të dhënat statistikore në fushën e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar, pastrimit të parave, organi i prokurorisë ka koordinuar dhe bashkëpunuar me institucionet e tjera shqiptare dhe ka përgatitur statistikat e harmonizuara për periudha 6-mujore dhe vjetore. Statistikat në prokurori mblidhen në mënyrë manuale dhe raportohen në Prokurorinë e Përgjithshme. Sektori i Studimeve në Prokurorinë e Përgjithshme, pas ndryshimit të legjislacionit procedural, ka analizuar nevojën për ndryshime në formatin statistikor, si dhe po punohet për nxjerrjen e të dhëna nga sistemi i Menaxhimit të Çështjeve (CAMS). Në muajin nëntor 2019 Instituti i Statistikave dhe Prokuroria e Përgjithshme nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi, ku parashikohet marrja e të dhënave të detajuara nga ana e INSTAT-it.

**Nga vlerësimi që Ministria e Drejtësisë ka kryer për rekomandimet e propozuara nga ministritë e linjës që kanë në përgjegjësi agjencitë ligjzbatuese**, që ushtrojnë funksione të policisë gjyqësore, në lidhje me bashkëpunimin me organin e prokurorisë është evidentuar progresi i

arritur dhe forcimi i bashkëpunimit; si dhe kanë paraqitur sugjerimet e tyre me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi, me qëllim finalizimin me sukses të hetimit penal.

**Ministria e Brendshme**[81], bën me dije se gjatë vitit 2019 është rritur bashkëpunimi me prokurorinë, duke u reflektuar dhe rezultate të suksesshme: rritje të referimeve, hetimeve proaktive, operacioneve policore dhe analizave të përbashkëta. Bashkëpunimi është rritur dhe në luftën kundër korrupsionit, duke zhvilluar kapacitetet hetimore dhe shkëmbimi i informacionit. Në kuadër të përmirësimit të mëtejshëm të bashkëpunimit, ky institucion sugjeron: i. forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet Prokurorisë, Policisë, si dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese në funksion të hetimeve; ii. hetime më të thelluara financiare për veprat penale që gjenerojnë të ardhura; iii. zbatimi i ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, duke sekuestruar që në fazat fillestare pasurinë kriminale; iv. shtimin e përdorimit të metodave speciale të hetimit, veçanërisht për veprat penale të pastrimit të pasurisë; v. realizimin e ndërlidhjes midis sistemeve të menaxhimit të çështjeve në prokurori dhe në Policinë e Shtetit në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit midis këtyre dy institucioneve; vi. nxjerrjen e akteve nënligjore të përbashkëta midis Prokurorit të Përgjithshëm dhe drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit për zgjidhjen e problematikës së krijuar për ruajtjen e automjeteve prova materiale të aksidenteve rrugore; vii. forcimin e kontrollit dhe të masave disiplinore ndaj oficerëve të policisë gjyqësore; viii. rritjen e bashkëpunimit midis prokurorive dhe SHÇBA-së dhe përfshirjen e tyre në trajnime, me qëllim forcimin e kapaciteteve edhe të këtyre strukturave.

Lidhur me çështjet e pastrimit të parave, strukturat e Ministrisë së Brendshme[82], konkretisht Drejtoria për Krimet Ekonomike e Financiare në Policinë e Shtetit, sugjerojnë: i. përmirësimin e cilësisë së hetimeve për veprat penale të korrupsionit, pastrimit të parave, financimit të terrorizimit dhe krimet kibernetike; ii. përmirësimi i hetimeve pasurore, rritje e numrit të sekuestrimeve/konfiskimeve dhe shtimi i masave pasurore të marra në kuadër të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, të ndryshuar; si dhe iii. krijimi dhe mbajtja e një baze të dhënash të konsoliduar, veçanërisht për veprat penale të mësipërme.

**Ministria e Financave dhe Ekonomisë**, konkretisht Drejtoria Përgjithshme e Tatimeve[83], pasi bën me dije kuadrin ligjor dhe statusin e punonjësve të Njësive të Hetimit Tatimor, lidhur me bashkëpunimin ndërinstitucional sugjeron: i. shtimin e aplikimit të masës së sekuestros preventive/konservative, me qëllim rritjen e efikasitetit të procesit penal; ii. forcimin e bashkëpunimit midis prokurorisë dhe strukturave tatimore; si dhe iii. mundësinë e administrimit nga organi procedues të akteve të nevojshme me qëllim vijimin e procedurave/kontrolleve administrative ndaj subjektit ose të tretëve.

**Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave (DPPPP)**[84] ka paraqitur këto sugjerime në lidhje me bashkëpunimin me organin e prokurorisë: i. qartësim i zbatimit në praktikë të dispozitës ligjore të parashikuar nga neni 287 i K. Penal si vepër penale e pavarur dhe, në veçanti, rastet kur kjo vepër kryhet nga familjarët apo persona të tretë; ii. shtim i rasteve të hetuara dhe gjykuara për veprat penale të pastrimit të produkteve të veprës penale dhe rritje të numrit të aseteve të konfiskuara në përfundim të gjykimit; iii. specializimin e prokurorëve për këtë kategori veprash penale dhe unifikimin e veprimeve procedurale gjatë hetimit të kësaj kategorie veprash penale.

**Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit**[85] vlerëson bashkëpunimin midis dy institucioneve dhe sugjeron: i. forcimin e këtij bashkëpunimi nëpërmjet dhënies prej tyre të informacionit dhe ekspertizës në fushën e lojërave të fatit: ii. rritjen e hetimeve proaktive edhe për veprat penale që lidhen me veprat penale në fushën e lojërave të fatit si veprat penale në fushën e tatimeve, pastrimit të parave, korrupsionit etj.; si

[81] Me shkresën e saj nr. 632/5 prot., datë 18.2.2020, regjistruar me tonën nr. 535/2 prot., datë 19.2.2020.

[82] Përcjellë nga Ministria e Punëve të Brendshme në formë elektronike, në datën 4.2.2020.

[83] Me shkresën e tyre nr. 2602/1, datë 10.2.2020, ku është përcjellë kontributi në fushën e taksave dhe tatimeve.

[84] Me shkresën e MFE-së nr. 1939/4 prot., datë 28.4.2020, regjistruar me tonën nr. 535/5 prot., datë 30.4.2020.

[85] Me shkresën e MFE-së nr. 1939/4 prot., datë 28.4.2020, regjistruar me tonën nr. 535/5 prot., datë 30.4.2020.

dhe iii. rritjen e numrit të çështjeve të dërguara për gjykim për këtë kategori veprash penale me qëllim reduktimin e këtij fenomeni.

**Ministria e Mbrojtjes**[86], në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me organin e prokurorisë, sugjeron: i. krijimin e strukturave të posaçme të policisë ushtarake pranë strukturës së prokurorive dhe në Prokurorinë e Përgjithshme, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi; ii. organizimin e trajnimit fillestar dhe vazhdues për oficerët e policisë gjyqësore ushtarake; si dhe iii. përfshirje më të madhe të strukturave të policisë ushtarake në hetimin e çështjeve penale të referuara prej tyre.

**Ministria e Turizmit**[87] sugjeron koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit midis organeve ligjzbatuese: prokurorisë dhe policisë dhe njësive të qeverisjes vendore, me qëllim hetimin dhe marrjen e masave për të gjitha veprat penale të konstatuara në fushën mjedisore.

Një problematikë e veçantë është paraqitur nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve[88], me organin e prokurorisë në lidhje me: i. interpretimin dhe vendimmarrjet e ndryshme të veprës penale të parashikuar nga neni 324/a i K. Penal, "Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim", në lidhje me referimet e kryera nga ky institucion; ii. mungesën e delegimit të kryerjes së veprimeve hetimore pranë oficerëve të policisë gjyqësore pranë SHKBB-së, të cilët kanë kryer referimin fillestar; iii. dërgimi në kohë i urdhrave të ekzekutimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, me qëllimin marrjen e masave për transferimin nga ambientet e caktuara për të paraburgosurit në ambientet e vuajtjes së dënimit.

**Shërbimi i Provës** bën me dije problematikat e konstatuara në lidhje me bashkëpunimin me organin e prokurorisë: i. dërgimi në kohë i urdhrit të ekzekutimit të dënimit, në rastin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim në bazë të nenit 59 të K. Penal; ii. mungesën e informacionit në lidhje me raportet e mospërmbushjes së hartuara nga Shërbimi i Provës, për rastet e dënimeve alternative.

[86] Me shkresën e saj nr. 913/2 prot., datë 6.3.2020, regjistruar me tonën nr. 535/3 prot., datë 9.3.2020.

[87] Me shkresën e tyre nr. 2756 prot., datë 8.4.2020, regjistruar me tonën nr. 535/4 prot., datë 10.4.2020.

[88] Me shkresën e tyre nr. 1246 prot., datë 15.7.2019, regjistruar me tonën me nr. 5318 prot., datë 15.7.2019.

Sa më sipër, Këshilli i Ministrave, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional i rekomandon Prokurorit të Përgjithshëm:

1. Rritjen e bashkëpunimit me Policinë e Shtetit dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese në funksion të hetimit të specializuar, të shpejtë dhe të gjithanshëm të grupeve kriminale me rrezikshmëri të lartë shoqërore, në fushën e krimit të organizuar dhe, kryesisht, të trafikimit të narkotikëve, krimeve të rënda me ndikim të lartë shoqëror, krimit kundër korrupsionit dhe atij financiar, sekuestrimin e aseteve kriminale;
2. Forcimin e bashkëpunimit me të gjitha agjencitë ligjzbatuese dhe institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare në funksion të hetimeve proaktive, që lidhen me veprat penale në fushën e pastrimit të parave, pastrimit të ardhurave nga aktivitetet kriminale dhe terrorizmit;
3. Forcim i bashkëpunimit në funksion të rritjes së efektivitetit të hetimeve ndaj subjekteve që priren të kryejnë evazion fiskal, por edhe nëpunësve publikë të administratës tatimore;
4. Rritjen e rasteve të përfshirjes në kryerjen e veprimeve të përbashkëta hetimore të oficerëve të shërbimeve të tjera të policive gjyqësore, sidomos për rastet e referuara në prokurori prej tyre;
5. Trajnime të përbashkëta me oficerët e policive gjyqësore me fokus rritjen e kapaciteteve profesionale të këtyre të fundit në drejtim të ligjshmërisë së veprimeve hetimore dhe vlerës së provave, veçanërisht, në rastet e hetimeve financiare, evazionit fiskal dhe krimit kibernetik;
6. Përmirësim të koordinimit ndërinstitucional, në lidhje me të dhënat statistikore, sidomos në fushën e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar, pastrimit të parave, në kuadër të raportimeve që lidhen me procesin e integrimit të vendit;
7. Marrja e masave për vënien në funksion së bashku me Ministrinë e Drejtësisë të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve për prioritizimin sistematik të letërporosive për të gjitha autoritetet e përfshira.

**VENDIM**
**Nr. 502, datë 24.6.2020**

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE "REGJISTRI ELEKTRONIK I EKSPERTËVE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", dhe të neneve 224/a, paragrafi i dytë, e 224/d, pika 1, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore "Regjistri elektronik i ekspertëve" (këtu e në vijim "REE").

2. REE-ja ka si qëllim ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të dhënave në formë elektronike për ekspertët që përmbushin kushtet për t'u regjistruar në REE, sipas përcaktimit të nenit 224/d, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, duke i grupuar sipas fushës së tyre të ekspertizës dhe vendit ku punojnë.

3. Në REE regjistrohen ekspertët, për të cilët ligjet e posaçme, që rregullojnë organizimin dhe funksionin e profesionit ose të një fushe të caktuar, parashikojnë licencimin e tyre.

4. REE-ja, si bazë e të dhënave shtetërore, bëhet në formatin *web-based* dhe hostohet në datacenterin qeveritar që ndodhet në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

5. Të dhënat, që përmban REE-ja, ndahen në të dhëna parësore e dytësore.

6. Të dhëna parësore konsiderohen të dhënat e mëposhtme:

a) numri rendor;

b) numri i protokollit dhe data e regjistrimit;

c) fusha e ekspertizës;

ç) numri i licencës;

d) data e lëshimit të licencës;

dh) data e përfundimit të vlefshmërisë së licencës, në rast se është e zbatueshme;

e) autoriteti lëshues i licencës;

ë) vitet e përvojës profesionale;

f) vitet e përvojës si ekspert në gjykatë;

g) gjykatat, për të cilat eksperti është i disponueshëm;

gj) data e regjistrimit fillestar në regjistër;

h) data e rishikimit të ardhshëm;

i) statusi i regjistrimit, duke përfshirë të dhëna mbi fazën e shqyrtimit të aplikimit ose të ushtrimit të ekspertizës;

j) sistemi i pikëzimit për vlerësimin e ekspertit nga palët.

7. Të dhëna referenciale të marra nga deklarimi i subjektit konsiderohen adresa e *email*-it si dhe numrat e kontaktit, numri i telefonit kryesor dhe dytësor.

8. Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat që merren nga një bazë tjetër të dhënash, ku ato janë parësore, dhe kanë të bëjnë me:

a) të dhëna nga regjistri i gjendjes civile, si numri personal, emri, mbiemri, atësia, vendlindja, datëlindja, gjinia, bashkia/njësia administrative dhe adresa;

b) të dhëna nga regjistri i QKB-së, si emri i subjektit, numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS), bashkia/njësia administrative, si dhe adresa ku ushtron aktivitetin profesional: numri, rruga, qyteti;

c) të dhëna nga regjistri i tatimeve, për subjektet e regjistruara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;

ç) të dhëna nga regjistri i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për marrjen e të dhënave mbi kontributet shoqërore;

d) çdo bazë tjetër të dhënash, që mund të ndërveprojë me REE-në.

9. Institucioni administrues i REE-së është Ministria e Drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 224/d, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar. Dhënës të informacionit për REE-në janë kërkuesit dhe çdo palë tjetër e interesuar, sipas përcaktimit të këtij vendimi.

10. Niveli i aksesit në bazën e të dhënave të REE-së është, si më poshtë vijon:

a) Ministria e Drejtësisë ka të drejta të plota administrative mbi bazën e të dhënave, në rolet:

i. administrator;

ii. editues;

iii. lexues.

b) Gjyqtarët e gjykatave të rretheve gjyqësore, të juridiksionit të përgjithshëm ose administrativ, në

rolin e lexuesit, për të përzgjedhur dhe vlerësuar ekspertin;

c) Gjyqtarët e gjykatave të apelit, për aq sa shqyrtojnë çështje si gjykatë në shkallë të parë, në rolin e lexuesit, për të përzgjedhur dhe vlerësuar ekspertin;

ç) Ekspertët/kërkuesit, në rolin e lexuesit;

d) Palët e interesuara, në rolin e lexuesit mbi veprimtarinë që kryejnë për vlerësimin e ekspertit.

11. Ministria e Drejtësisë kujdeset, që:

a) të mundësohet grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave;

b) të hostohet regjistri në bashkëpunim dhe bashkërendim të punës me AKSHI-n;

c) të mbikëqyrë dhe të ofrojë asistencë teknike për përdorimin e regjistrit;

ç) të ofrojë mundësinë e gjenerimit automatik të statistikave dhe të raporteve nga regjistri, për të dhënat e hedhura;

d) të trajnojë përdoruesit e regjistrit lidhur me raportimin, hedhjen e të dhënave dhe përditësimin e tyre, si dhe për administrimin e përshtatshëm të regjistrit;

dh) të propozojë masa për rritjen e efikasitetit të regjistrit dhe përmirësimin e tij në të ardhmen.

12. Përdoruesit e përcaktuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 10, të këtij vendimi, janë përgjegjës për saktësinë dhe përditësimin e të dhënave të hedhura nëpërmjet llogarisë së tyre në REE.

13. Përdoruesit e përcaktuar në shkronjat “ç” dhe “d”, të pikës 10, të këtij vendimi, plotësojnë rubrikat dhe të dhënat e tyre nëpërmjet llogarive të tyre personale në portalin qeveritar e-Albania.

14. AKSHI, si autoriteti rregullator koordinues i bazave të të dhënave shtetërore, regjistron, auditon dhe koordinon ndërveprimin me bazat e të dhënave shtetërore.

15. Subjekti përgjegjës për administrimin e regjistrit, në cilësinë e “kontrolluesit”, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, dokumenton masat tekniko-organizative të përshtatura e të zbatuara për garantimin e mbrojtjes të të dhënave personale.

16. Ministri i Drejtësisë miraton rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës të të dhënave të REE-së, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.

17. Përdorimi i REE-së fillon nga data e vënies në funksionim të tij.

18. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

## VENDIM
## Nr. 503, datë 24.6.2020

## PËR MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË INFORMACIONIT ELEKTRONIK SHËNDETËSOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 30, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë mënyrën e administrimit të informacionit elektronik shëndetësor.

2. Informacioni elektronik shëndetësor përbëhet nga dokumentet elektronike shëndetësore, që krijohen nga institucionet ofruese të kujdesit shëndetësor, publike dhe jopublike, të vlefshme sipas legjislacionit në fuqi.

3. Dokumentet elektronike shëndetësore, pjesë të sistemit elektronik të integruar të informacionit shëndetësor, janë si më poshtë vijon:

a) historiku i gjendjes shëndetësore të pacientit;

b) receta elektronike/përshkrimi dhe dispecimi në farmaci;

c) rezultatet e ekzaminimeve laboratorike;

ç) rezultatet e ekzaminimeve imazherike;

d) fletëdalja e pacientit nga institucione të kujdesit shëndetësor me shtretër.

4. Dokumentet e përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, aksesohen, si më poshtë vijon:

a) nga qytetarët, nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*;

b) nga profesionistët e shëndetësisë për shqyrtimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve, nëpërmjet sistemit përkatës elektronik, në mënyrë të sigurt sipas legjislacionit në fuqi.

5. Aksesi i dokumenteve elektronike shëndetësore nga mjeku bëhet vetëm me miratimin e pacientit. Formati i miratimit të pacientit, që miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, arkivohet pranë mjekut që ofron shërbimin shëndetësor dhe përfshihet në kartelën e pacientit.

6. Shkëmbimi i dokumenteve elektronike shëndetësore do të bëhet nëpërmjet platformës qeveritare të ndërveprimit nga profesionistët e shëndetit në institucionet ofruese të kujdesit shëndetësor, të cilët regjistrojnë të dhënat shëndetësore të pacientëve.

7. Formati dhe përmbajtja e dokumenteve elektronike shëndetësore përcaktohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

8. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe të gjithë institucionet e ofrimit të kujdesit shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 504, datë 24.6.2020**

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE TË STUDENTËVE, TË CILËT STUDIOJNË JASHTË VENDIT, DHE SHTETASVE TË HUAJ ME ORIGJINË SHQIPTARE, TË CILËT PËRFITOJNË BURSA NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore"; të shkronjës "a", të nenit 5, të ligjit nr. 16/2018, "Për diasporën"; të pikës 1, të nenit 6, të ligjit nr. 115/2017, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës", me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë.

2. Baza e të dhënave shtetërore, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përmban të dhëna personale, për:

a) shtetasit shqiptarë, të cilët kryejnë studimet e arsimit të lartë jashtë vendit;

b) shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, të cilët janë përfitues të programeve të financuara nga Republika e Shqipërisë;

c) shtetasit shqiptarë, të cilët kanë përfituar bursat e studimit, të cilat u ofrohen Shqipërisë nga shtete, organizata ndërkombëtare dhe jofitimprurëse në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara apo dokumente të tjera, ku Republika e Shqipërisë është palë.

3. Të dhënat që përmban baza e të dhënave shtetërore e studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, si më poshtë vijojnë:

a) Të dhëna parësore konsiderohen ato të dhëna, të cilat grumbullohen nga ky regjistër dhe përfshijnë:

i. periudhën e studimeve;

ii. shtetin pritës;

iii. institucionin e arsimit të lartë pranë të cilit studion;

iv. fushën e studimeve;

v. burimin e financimit të bursës;

vi. adresën e postës elektronike *(email)*;

vii. të dhënat e shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, sipas shkronjës "b", të pikës 2, të këtij vendimi:

- emri;
- mbiemri;
- atësia;
- adresa;
- gjinia;
- vendlindja;
- datëlindja.

b) Të dhënat dytësore, që shkëmbehen me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (DPGJC), janë si më poshtë vijojnë:
i. NID-i i shtetasit;
ii. emri;
iii. mbiemri;
iv. atësia;
v. adresa;
vi. gjinia;
vii. vendlindja;
viii. datëlindja.

4. Baza e të dhënave shtetërore e studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, ka si institucion administrues Agjencinë Kombëtare të Diasporës.

5. Baza e të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, ndërvepron me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (DPGjC) dhe *database*-t e tjera shtetërore, të cilat, në aktin e krijimit të tyre, parashikojnë ndërveprimin me bazën e të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë.

6. Dhënës të informacionit për bazën e të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, janë ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për punët e jashtme.

7. Vlerësimi i rezultateve të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, realizohet nga një komision i veçantë me 9 (nëntë) anëtarë, nga institucionet përgjegjëse, i cili ngrihet me urdhër të Kryeministrit. Ai drejtohet nga ministri përgjegjës për diasporën. Komisioni realizon një raport vjetor për Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë. Dhënia e bursave shtetasve të huaj me origjinë shqiptare bëhet nga Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe rregullohet me akte të tjera.

8. Baza e të dhënave shtetërore aksesohet nga të gjitha institucionet e interesuara nëpërmjet kërkesës drejtuar Agjencisë Kombëtare të Diasporës, në përputhje me rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore të përcaktuar nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, ministri i Shtetit për Diasporën dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

## UDHËZIM
## Nr. 17, datë 23.6.2020

## PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 15.5.2019, "PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 1, të shkronjës "C", të kreut II, togfjalëshi "... deri në 7 (shtatë)" zëvendësohet me togfjalëshin "... deri në 10 (dhjetë)".

b) Në pikën 1, të shkronjës "E", të kreut II, togfjalëshi " ... deri në 5 (pesë)" zëvendësohet me togfjalëshin " ... deri në 10 (dhjetë)".

c) Në pikat 2 dhe 5, të shkronjës "A", të kreut III, togfjalëshi "... 6 faza 48-orëshe", zëvendësohet respektivisht me togfjalëshin " ... 7 (shtatë) faza 48-orëshe".

d) Në pikat 2 dhe 5, të shkronjës "D", të kreut III, togfjalëshi "... 4 faza 48-orëshe", zëvendësohet respektivisht me togfjalëshin " ... 5 (pesë) faza 48-orëshe".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe IAL-të publike dhe jopublike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
**Besa Shahini**

## UDHËZIM
## Nr. 376, datë 18.6.2020

## PËR KRITERET E DHËNIES DHE MEKANIZMIN E MONITORIMIT TË NDIHMËS SHTETËRORE TË NDËRMARRJES SOCIALE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26, të ligjit 65/2016, "Për ndërmarrjet sociale në RSH" dhe të nenit 22 të vendimit nr. 789, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave,

UDHËZOJ

1. Aplikimi, për një nga format e mbështetjes së ndërmarrjeve sociale, bëhet pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale (më poshtë në tekst "ministria"), me anë të një kërkese me shkrim, bazuar në kriteret e përcaktuara në thirrjen publike në faqen zyrtare të ministrisë.

2. Aplikimi shoqërohet me një projektpropozim ose planbiznes, të shoqëruar me një relacion shpjegues mbi rëndësinë strategjike të projektit, si dhe përshkrimin e detajuar të elementeve të mëposhtme:

a) vlerën totale të parashikuar të subvencionit;

b) kohën e nevojshme për realizimin e projektit;

c) produktivitetin dhe vlerën e shtuar që do të sjellë ky projekt;

ç) mundësitë e punësimit dhe hapjen e vendeve të reja të punës që parashikohen si pasojë e mbështetjes financiare;

d) përputhshmërinë e projektit me politikat dhe prioritetet ekonomike sektoriale;

dh) mundësitë e zhvillimit ekonomik rajonal dhe lokal që paraqet investimi;

e) mundësitë e zhvillimit dhe të përmirësimit të kushteve e standardeve për prodhimin e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve që paraqet investimi;

ë) rritjen e nivelit të përgjithshëm të sigurisë dhe të cilësisë së jetës së qytetarëve të komunitetit, si pasojë e realizimit të këtij investimi;

f) vetëdeklarim që ndërmarrja është e aftë për zbatimin e duhur dhe në kohë të aktiviteteve të propozuara;

g) informacion zyrtar nga autoriteti përgjegjës (Komisioni i Ndihmës Shtetërore), për të gjitha llojet e financimit, në kuadër të fondeve shtetërore që ka marrë subjekti aplikues.

3. Aplikimi me shkrim shoqërohet dhe me dokumentacione të tjera shtesë, përkatësisht:

i. urdhri i ministrit përgjegjës për miratimin e statusit të ndërmarrjes sociale të lëshuar jo më vonë se tre muaj para datës së aplikimit;

ii. fotokopje të vendimit të regjistrimit të gjykatës dhe të statutit të organizatës;

iii. ekstrakti i gjykatës (i cili merret në Zyrën e Regjistrimit të OJF-ve, pranë Gjykatës së Qarkut, Tiranë);

iv. dëshmi nga gjykata që organizata nuk është në situatë falimentimi, likuidimi, përfundim aktiviteti; janë në gjendje të falimentimit, likuidimit, ndërprerjes së veprimtarisë, falimentimit ose të marrëveshjes me donatorët/kreditorët ose ndonjë situatë të ngjashme, që lind nga një procedurë e të njëjtit lloj ose që i nënshtrohen një procedure të të njëjtit lloj (*online* tek *e-Albania*/te tatimet që kanë status aktiv);

v. formulari i plotësuar i aplikimit, i vulosur dhe i nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i organizatës (formulari duhet firmosur në çdo faqe);

vi. numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT-in);

vii. CV të organizatës (të firmosur dhe vulosur nga përfaqësuesi ligjor i OJF-së) dhe licencën e lëshuar nga autoritetet publike, në rast se ka aktivitete të parashikuara në projekt, të cilat nuk mund të kryhen pa zotëruar licencën përkatëse;

viii. kopje të pasqyrave financiare të vitit paraardhës, në rast se organizata e ushtron aktivitetin prej më shumë se një viti dhe/ose formularët e deklarimeve dhe pagesave për personat fizikë;

ix. vërtetim nga dega e tatim-taksave për shlyerjen e detyrimeve tatimore (origjinal ose me vulë digjitale (*online* tek *e-Albania*/te tatimet), për aq kohë sa ushtron veprimtarinë, por jo më gjatë se për një periudhë kohore njëvjeçare nga çasti i aplikimit;

x. informacion mbi numrin e të punësuarve dhe nivelin e pagës së dhënë për çdo person, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi për pagat në sektorin publik;

xi. vërtetimin për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesit, të specifikuar për tre muajt e fundit;

xii. një kopje të aktit të inspektimit në punë në rast se organizata ka ushtruar më parë aktivitetin e saj;

xiii. vërtetim bankar (ku pasqyrohen numri IBAN dhe numri i llogarisë së organizatës, në lekë), si dhe emrin/emrat e personave të autorizuar të kryejnë veprime bankare.

xiv. vërtetim bankar që vërteton që ndërmarrja ka në llogari bankare një shumë të barabartë me 30% të buxhetit të planbiznesit, për formën e subvencionit "të zhvillimit të veprimtarisë";

xv. bilanci financiar i vitit të fundit (*online* tek *e-Albania*/te tatimet).

4. Bazuar në kriterin e përshtatshmërisë së biznesit me skemën e ndihmës shtetërore, subjekti duhet të përmbushë faktorët si më poshtë vijojnë:

a) aftësi për financim 30% të kostove të projektit të propozuar, në fazën e aplikimit, për formën e subvencionit të zhvillimit të veprimtarisë;

b) ka në objektin e veprimtarisë së tij një nga veprimtaritë që përfshihen në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 12.1.2018;

c) të punësojë minimalisht 3 punonjës të rinj nga kategoritë e grupeve të pafavorizuara, sipas përcaktimeve të bëra në vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 56/2018, "Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara", brenda 12 muajve nga momenti i përfitimit të subvencionit dhe kohëzgjatja e kontratës të jetë jo më pak se 2 vjet;

ç) ka selinë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

5. Përfitimi nga fonde të akorduara nga donatorët apo institucione financiare ndërkombëtare, për këto sipërmarrje, nuk përbën pengesë për përfitime dhe nga fondi për ndërmarrjet sociale. Subjektet duhet të vetëdeklarojnë se nuk janë duke përfituar financim nga donatorë të tjerë për të njëjtin projekt.

6. Rimbursimin e skemës, sipas kostove të miratuara në përputhje me udhëzimet e mëposhtme:

a) lidhur me formën e parë të subvencionit "për zhvillimin e veprimtarisë";

b) një ndërmarrje mund të përfitojë 70% të fondit të kërkuar, maksimalisht 1,500,000 lekë për një projekt;

c) fondi për zhvillimin e veprimtarisë mbulon deri në 70% të kostove të pranuara brenda limitit të mësipërm;

d) pagesa e fondit të përfituar bëhet 70% në miratimin e aplikimit dhe 30% në përfundim të projektit, kundrejt faturës/faturave, e cila/të cilat vërteton/vërtetojnë shpenzimet e kryera të cilat do të dorëzohen në përfundim të projektit;

e) fondi nuk mund të jepet më tepër se një herë për të njëjtën sipërmarrje;

f) fondi për krijimin e vendeve të reja të punës është deri në 100.000 lekë për çdo vend të ri pune, i cili duhet të përdoret për mjete pune, lëndë të parë dhe materiale konsumi.

g) pagesa e fondit të përfituar bëhet 50% në miratimin e aplikimit dhe 50% në përfundim të projektit, kundrejt faturës/faturave, e cila/të cilat vërteton/vërtetojnë shpenzimet e kryera, të cilat do të dorëzohen në përfundim të projektit;

h) fondi për sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve të ndërmarrjeve sociale, që u përkasin grupeve të pafavorizuara mbulon në masën 100% të pjesës së kontributit të punëdhënësit dhe të punëmarrësit, me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se dy vjet;

i) ky financim bëhet drejtpërdrejt në degën e sigurimeve shoqërore, sipas procedurave përkatëse;

j) pranimi i aplikimeve është subjekt i disponueshmërisë së fondeve dhe mund të pezullohet në çdo kohë në rast se fondet kanë mbaruar. Në rast të tillë, thirrja për aplikime dhe miratimi i subvencionit mund të fillojë/rifillojë vetëm pas miratimit të fondit në mbështetje të ndërmarrjeve sociale, me fonde.

7. Mbulimin nga skema të kostove, për:
a) investime në makineri dhe pajisje për realizimin e prodhimit/shërbimit;
b) kualifikim dhe trajnim për rritjen e aftësive profesionale të punonjësve të rinj nga kategoritë e grupeve të pafavorizuara;
c) mbulimin deri në 50% të pagës minimale për punonjësit e rinj nga kategoritë e grupeve të pafavorizuara për një periudhë 6-mujore.
8. Nuk mund të mbulohen nga skemat e përcaktuara në pikën 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 789/2019, kostot e mëposhtme:
i. zbavitje dhe dhurata;
ii. investim kapital;
iii. prodhim, duke përfshirë kampionë;
iv. shpenzime administrative
v. kosto të lindura para miratimit të subvencionit;
vi. kosto të lindura në vazhdimësi prej infrastrukturave dhe detyrimeve ekzistuese;
vii. aktivitete që mbështeten nga burime të palëve të treta, sikundër mund të jenë Bashkimi Evropian, Dhoma e Tregtisë apo të tjera të ngjashme;
viii. çdo aktivitet i paligjshëm;
ix. marketing të produktit dhe promovim (me përjashtim të reklamave elektronike dhe televizive);
x. pjesëmarrje në panair ose ekspozitë brenda apo jashtë shtetit, si ekspozues.
9. Për të siguruar rimbursimin, aplikantët e suksesshëm do të konsiderohen ata që:
i. respektojnë në mënyrë rigoroze dhe integrale të gjitha deklaratat e shprehura dhe angazhimet e përfshira në "Formularin standard në lidhje me kriteret e përjashtimit" dhe në formularin e aplikimit, sipas formateve të miratuara nga kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve;
ii. vënë në dispozicion të SHSSH-së dhe ministrisë çdo informacion që lidhet me zbatimin e projektit;
iii. paraqesin një kopje të raportit te Shërbimi Social Shtetëror dhe një kopje te sekretariati, në lidhje me përfundimin e projektit, faturat origjinale për shpenzimet (këto mund t'u kthehen ndërmarrjeve, pasi të jenë nxjerrë kopjet e certifikuara), si dhe çdo dokument të nevojshëm për të bërë të mundur kryerjen e pagesës;
iv. pranojnë çdo lloj monitorimi, vlerësimi dhe/apo auditimi për të cilat projekti i aprovuar mund të bëhet objekt, duke siguruar të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar;
v. përfundojnë projektin brenda kohës së parashikuar në marrëveshje/kontratë tip me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale.
10. Procedura për aplikim
10.1 Kërkesa paraqitet në Ministrisë nga vetë kërkuesi apo çdo person i autorizuar prej tij, sipas formatit të aplikimit, të miratuar nga kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve.
10.2 Dokumentet paraqiten në origjinal, në kopje me të njëjtën fuqi provuese me origjinalin ose në kopje të panjësuara me origjinalin, nën përgjegjësinë e plotë të aplikantit për vërtetësinë e akteve të marra si kopje të vërteta të origjinalit.
10.3 Kur kërkesa paraqitet nga personi i autorizuar, sipas pikës 1 të këtij neni, bashkë me dokumentet paraqitet edhe dokumenti që vërteton faktin e të qenit i autorizuar.
10.4 Aplikimi do të pajiset me një numër rendor dhe do të regjistrohet në protokollin e ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale.
10.5 Sekretariati i Komisionit është i detyruar të marrë në dorëzim çdo aplikim, të paraqitur sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.
10.6 Aplikimi do të pajiset me një numër aplikimi dhe do të regjistrohet në Regjistrin e Skemës së Subvencionit për Ndërmarrjet Sociale.
10.7 Sekretariati i Komisionit vlerëson dosjen sipas kritereve të përcaktuara në VKM nr. 789/2018 "Për krijimin e fondit mbështetës të ndërmarrjeve sociale dhe format e mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale', si dhe në këtë udhëzim.
10.8 Sektori i Financës, pranë Shërbimit Social Shtetëror, si pjesë e Sekretariatit, bën vlerësimin e planbiznesit që shoqëron dosjen që do të paraqitet Komisionit të Vlerësimit.
10.9 Komisioni i Vlerësimit do të marrë në dorëzim dhe do të analizojë aplikimin, për t'u siguruar në lidhje me plotësimin, siç duhet të aplikimit, si dhe me pranueshmërinë e aplikimit.
10.10 Vendimi për miratimin ose refuzimin e një aplikimi bazohet vetëm mbi dokumentet e paraqitura.
10.11 Komisioni gjatë shqyrtimit të çdo aplikimi merr në konsideratë raportin e përgatitur nga Sekretariati.

10.12 Vendimi për akordim të subvencionit merret me shumicë votash dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët prezentë të Komisionit.

10.13 Pas miratimit të projekteve, vendimi i Komisionit të Vlerësimit, së bashku me dosjet përkatëse, i paraqitet Sektorit të Financës pranë Drejtorisë së Buxhetit, i cili bën përllogaritjet e fondeve për vitin buxhetor dhe fillon procedurat për transferimin e fondeve Shërbimit Social Shtetëror.

10.14 Pas mbledhjes së Komisionit bëhet njoftim i aplikuesit sipas formatit të miratuar nga kryetari i Komisionit duke iu referuar në mënyrë specifike aplikimit, në një afat prej 5 ditësh pune, sipas një formati të miratuar nga Komisioni, se:

i. aplikimi është refuzuar nga Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve, duke listuar dhe arsyet e refuzimit;

ii. aplikimi është miratuar nga Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve;

iii. njoftimi bëhet me postë zyrtare sipas formatit të miratuar nga kryetari i Komisionit.

10.15 Pas njoftimit, ndërmarrjes së cilës i është miratuar kërkesa që paraqitet pranë ministrisë për të nënshkruar marrëveshjen kontraktuale (kontratat tip) për dhënien e subvencionit sipas formatit të miratuar nga kryetari i Komisionit, në të cilën do të përcaktohet dhe afati për përfundimin e projektit.

10.16 Kontratat tip rishkruhen rast pas rasti për çdo projekt të miratuar duke e përshtatur dhe detajuar sipas të dhënave përkatëse të projektit. Kontrata fillon efektet juridike pas çeljes së fondit.

10.17 Kontrata tip lidhet vetëm për vitin buxhetor. Për vazhdimin e projektit në vitin pasardhës do të lidhet një aneks shtesë që i bashkëngjitet kontratës tip në përputhje me fondet e miratuara atë vit. Kjo kontratë shtesë do të hartohet në pesë kopje origjinale me nënshkrimin në çdo faqe dhe vulën e titullarit të Ministrisë, si dhe nënshkrimin në çdo faqe dhe vulën e subjektit përfitues (ose personit të autorizuar prej tij).

10.18 Pas nënshkrimit të marrëveshjes ministria kalon në llogarinë bankare të ndërmarrjes përfituese vlera e shpenzimeve të përcaktuara në paragrafit 4, të këtij udhëzimi.

10.19 Me nënshkrimin e marrëveshjes së subvencionit, ndërmarrja përfituese angazhohet të përmbushë tërësisht dhe në kohë projektin e miratuar. Nëse për ndonjë arsye, ndërmarrja dëshiron të ndryshojë projektin pas nënshkrimit të kontratës, ajo duhet t'i paraqesë paraprakisht Ministrisë një kërkesë për anulimin e kontratës, e cila do të nënkuptojë mos rimbursimin e shpenzimeve të kryera nga ndërmarrja, si dhe detyrimin e ndërmarrjes për të kthyer shumën e përfituar pas nënshkrimit të marrëveshjes.

10.20 Vetëm pasi një procedurë e tillë anulimi të jetë përfunduar dhe konfirmuar me shkrim nga Ministria, ndërmarrja mund të bëjë një aplikim të ri. Ky aplikim do të ndjekë të gjitha procedurat sikurse treguar më lart, si dhe do të merret gjithmonë parasysh parimi se çdo shpenzim i lindur para datës së nënshkrimit të një marrëveshjeje të re do të konsiderohet si i pambulueshëm.

11. Monitorimi i Projektit

11.1 Me fillimin e zbatimit të projektit, Sekretariati, nëpërmjet strukturës përgjegjëse të buxhetit, pranë SHSSH-së hedh të dhënat për subjektin, pjesëmarrësit e punësuar në regjistrin e krijuar për monitorimin e formave të mbështetjes së ndërmarrjeve sociale që e gëzojnë këtë status.

11.2 Shërbimi Social Shtetëror monitoron ecurinë e projektit dhe auditimin financiar të tij. Raportet e monitorimin paraqiten pranë Komisionit në mënyrë periodike, të paktën një herë në 6 muaj, përmes Sekretariatit Teknik pranë këtij Komisioni.

11.3 Shërbimi Social Shtetëror dhe inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror janë struktura përgjegjëse për ushtrimin e kontrolleve, me qëllim që të verifikohet respektimi i dispozitave të këtij ligji nga ana e ndërmarrjeve sociale, në zbatim të VKM-së 716/2017 "Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së kontrollit të veprimtarisë së ndërmarrjeve sociale".

11.4 Për shkelje të dispozitave të legjislacionit të ndërmarrjeve sociale inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror vendos gjobë në masën e përcaktuar në nenin 23, të ligjit nr. 65/2016 "Për ndërmarrjet sociale". Në rast të parregullsive të rëndësishme ose të përsëritura inspektorati njofton Ministrinë dhe për parregullsi të konstatuara, por që nuk mbulohen në mënyrë të veçantë nga ky inspektorat, njofton autoritetin përgjegjës. Raportet e inspektimit paraqiten pranë Sekretariatit, si dhe një kopje depozitohet pranë SHSSH-së.

11.5 Ndërmarrjet sociale paraqesin pranë Sekretariatit dhe SHSSH-së raporte periodike për veprimtaritë e ushtruara, sipas përcaktimeve të bëra

në udhëzimin nr. 677, datë 27.7.2018 "Për përcaktimin e formave, afateve dhe mënyrave të raportimit periodik, për veprimtaritë e ushtruara dhe kategoritë e personave të punësuar nga ndërmarrjet sociale".

11.6 Financimi do të kryet vetëm për aktivitetet për të cilat është rënë dakord nga Komisioni i Vlerësimit.

12. Raportet mbi Projektin e ndërmarrjes

12.1 Pas përfundimit të projektit, ndërmarrja përgatit dhe paraqet pranë Ministrisë një Raport mbi Projektin.

12.2 Nëse ka dyshim për të dhënat e paraqitura, Ministria, nëpërmjet strukturave kontrolluese, të përcaktuara në pikën 11.3 të këtij udhëzimi organizon kontrollet në ndërmarrje ose të kërkojë dokumente shtesë për të vërtetuar të dhënat.

12.3 Struktura monitoruese, në rastin tonë auditi i SHSSH-së, duhet të kontrollojë dhe duhet të sigurohet që shpenzimet e miratuara janë të shoqëruara me fatura dhe praktikën përkatëse sipas llojit të shpenzimit.

12.4 Kur të dhënat e paraqitura në raport nuk kënaqin plotësisht kërkesat e skemës, raporti do t'i kthehet ndërmarrjes, i shoqëruar me komentet përkatëse dhe shpjegimet në lidhje me të dhënat ose detajimet suplementare që kërkohen.

12.5 Raportet përfundimtare për çdo subjekt, si dhe raporti vjetor miratohen nga ministri përgjegjës për çështjet sociale, përpara se të paraqitet në Komisionin e Ndihmës Shtetërore.

12.6 Aplikantët janë të detyruar të sigurojnë të dhëna në lidhje me rezultatet e asistencës së dhënë për një periudhë 2-vjeçare pas përfundimit të projektit.

12.7 Arkivimi i dosjeve të ndërmarrjeve sociale përfituese të statusit/fondeve të mbështetjes kryhet nga struktura përgjegjëse e protokoll-arkivit, duke respektuar legjislacionin në fuqi për Arkivin e Shtetit.

13. Procedura e pagesës

13.1 Pas miratimit të projekteve, vendimi i Komisionit të Vlerësimit, së bashku me dosjet përkatëse, i paraqitet Shërbimit Social Shtetëror, i cili bën përllogaritjet e fondeve për vitin buxhetor dhe fillon procedurat për transferimin e fondeve.

13.2 Pas nënshkrimit të marrëveshjes me Ministrinë, sipas procedurave të buxhetit të shtetit, do të kalojë në llogarinë bankare të ndërmarrjes përfituese:

i. për formën e subvencionit për zhvillimin e veprimtarisë 70% të vlerës së kërkuar, por jo më shumë se 1.050.000 lekë. Dokumentet e përdorura si bazë për justifikimin e shpenzimeve (investime në makineri dhe pajisje për realizimin e prodhimit/shërbimit) është fatura e thjeshtë tatimore me TVSH. Për të gjitha mallrat e blera do të hartohet dokument hyrje dhe për çdo proces të realizuar do të hartohet dokument dalje;

ii. për formën e subvencionit të hapjeve të vendeve të reja të punës 50% të vlerës të shpenzimeve të miratuara por jo më shumë se 750.000 (shtatëqind mijë) lekë. Dokumentet e përdorura janë të njëjtë si në pikën 13.2/I, të këtij udhëzimi;

iii. për formën e subvencionit për financimin vjetor në masën 100% të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, për punësimin e personave nga kategoritë e grupeve të pafavorizuara, për një periudhë dyvjeçare, kjo e vërtetuar dhe me lidhjen e kontratave të punës, financimi do të bëhet drejtpërdrejt në degën e sigurimeve shoqërore sipas procedurave përkatëse.

13.3 Pasi raporti përfundimtar shqyrtohet dhe miratohet nga Komisioni, vijohet me paraqitjen e kërkesës në thesar, nga ana e Shërbimit Social Shtetëror, për rimbursimin e shumave të mbetura sipas tri formave të subvencionit.

13.4 Në thesar, për rimbursim paraqiten dokumentet e kërkuara nga ana e Degës së Thesarit, sipas legjislacionit në fuqi.

13.5 Një ndërmarrje nuk mund të përfitojë më tepër se shuma e buxhetuar dhe e miratuar paraprakisht prej Komisionit të Vlerësimit.

13.6 Pagesa kryhet në monedhën lek shqiptar, si për shpenzimet e kryera brenda Shqipërisë, ashtu edhe për ato të kryera jashtë saj. Për shpenzimet e kryera në monedhë të huaj do të merret si bazë kursi i këmbimit, i shpallur nga Banka e Shqipërisë në ditën e kryerjes së shpenzimit.

14. Konfidencialiteti i të dhënave

14.1 Gjithë informacioni i dhënë nga aplikantët për ministrinë për qëllim të skemës, veçanërisht e gjithë korrespondenca e shkëmbyer është konfidenciale dhe nuk do të zbulohet. Ministria do të ruajë në mënyrë konfidenciale informacionet e marra nga ndërmarrjet.

14.2 Asnjë e dhënë e marrë prej Ministrisë nga ana e aplikuesve nuk do t'u bëhet e ditur palëve të treta pa miratimin e tyre.

14.3 Megjithatë, ndërmarrja duhet ta dijë se informacioni në lidhje me zbatimin e Skemës, në veçanti identifikimi i ndërmarrjeve të mbështetura, të dhënat e përgjithshme rreth buxhetit, financimit, veprimet e kryera, rezultatet e arritura, ndikimet dhe të tjera të ngjashme, mund të përdoren, të publikohen ose shpërndahen nga Ministria pa ndonjë kufizim.

14.4 Vetëm për raste të veçanta, të tilla si ngritja e ndërgjegjësimit, promovimi dhe shpërndarja, rastet studimore dhe të tilla të ngjashme, informacioni mund të zbulohet nga Ministria me marrëveshje të veçantë me ndërmarrjet e përfshira, të cilat, nga ana e tyre, angazhohen për të lehtësuar zbulimin e informacionit, në rastet kur nuk vihen në lojë interesat përkatëse tregtare dhe/ose sekretet e tyre.

15. Struktura e menaxhimit të Fondit të Mbështetjes së Ndërmarrjeve Sociale.

15.1 Procesi i miratimit/refuzimit është transparent. Aplikantët e refuzuar duhet të njoftohen në lidhje me arsyet e refuzimit të aplikimit të tyre.

15.2 Përgjegjësitë për menaxhimin e skemës do të jenë si më poshtë:

i. Komisioni i Vlerësimit të Subvencionit bën vlerësimin e aplikimeve dhe akordimin e subvencioneve për llogari të ndërmarrjeve përfituese;

Komisioni është përgjegjës, për:

- vlerësimin e aplikimit;
- miratimin e subvencionit për aplikuesit e suksesshëm;
- miratimin e raportit përfundimtar të përfituesit;
- miratimin e pagesave pas një përfundimi të suksesshëm të projektit nga ana e përfituesit të subvencionit;
- marrjen në shqyrtim të rasteve problematike me kërkesë të SHSSH-së;

Komisioni i Vlerësimit të Ndërmarrjeve Sociale miratohet nga ministri përgjegjës për çështjet sociale, kryesohet nga një nga zëvendësministrat dhe përbëhet nga anëtarë të drejtorisë përgjegjëse për programin e ndërmarrjeve sociale, një jurist nga Drejtoria e Kuadrit Rregullator, një përfaqësues nga SHSSH-ja.

Komisioni funksionon në bazë të rregullores së miratuar në mbledhjen e parë të saj. Vendimet e Komisionit janë të vlefshme vetëm kur janë prezentë më shumë se gjysma e anëtarëve të komisionit.

Komisioni gjatë shqyrtimit të çdo aplikimi mban në konsideratë kriteret e përcaktuara në

këtë udhëzim dhe në thirrjen publike.

Formati i formularit të vlerësimit nga Komisioni miratohet nga kryetari i tij. Aplikimi quhet i miratuar kur votojnë në favor të tij më shumë se gjysma e anëtarëve të komisionit prezentë në mbledhje, në rast barazimi votash, vota e kryetarit është përcaktuese.

ii. Sekretariati është përgjegjës, për:

- sigurimin e të gjithë dokumentacionit të kërkuar nga Komisioni, si dhe shpërndarjen e tij të paktën 1 ditë përpara mbledhjes të Komisionit;
- marrjen pjesë në mbledhjet e Komisionit, pa të drejtë vote, dhe hartimin e procesverbalit përkatës të mbledhjes, që i paraqitet për shqyrtim dhe vlerësim të mëtejshëm Komisionit;
- është përgjegjës për informimin e të interesuarve për paraqitjen e kërkesave në lidhje me fondin;
- hartimin e raporteve përfundimtare të paraqitura nga përfituesit e subvencioneve, të analizuara dhe të kontrolluara nga Komisioni dhe kërkimin e informacioneve të tjera dhe/ose dokumentacionit shtesë sa herë që e gjykon të nevojshme;
- është përgjegjës për njoftimin e vendimit përfundimtar të Komisionit të Aprovimit të subvencionit;
- paraqitjen e draftraportprogresit për miratim pranë ministrit përgjegjës për çështjet sociale, i cili përcillet pranë Komisionit të Ndihmës Shtetërore, bazuar në VKM-në nr. 513 “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore”’;

iii. menaxheri i skemës është drejtoria përgjegjëse për programin e mbështetjes së ndërmarrjeve sociale, është përgjegjës, për:

- promovimin e skemës – do të organizojë evenimente promocionale, publicitet, ndërlidhje me postë ose *e-mail* dhe faqe në internet (lista qarkulluese do të krijohet prej bazës së të dhënave të ndërmarrjeve që gjendet pranë Ministrisë);
- marrjen në dorëzim dhe mirëmbajtjen e gjithë aplikimeve;

- dërgimin e përgjigjeve në lidhje me kërkesat për informacion brenda afateve kohore të përcaktuara;

- përgatitjen e gjithë dokumentacionit të kërkuar nga ministri përgjegjës për çështjet sociale;

- mbajtjen e të dhënave në lidhje me zbatimin e skemës së subvencionit;

- mbajtjen e të dhënave të plota në lidhje me progresin dhe arritjet e ndërmarrjeve, të cilat kanë ardhur si rezultat i asistencës së dhënë;

- përgatitjen e draftraportit të progresit;

- analizimin dhe kontrollin e raporteve përfundimtare të paraqitura nga përfituesit e subvencioneve;

iv. struktura përgjegjëse pranë SHSSH-së, si pjesë e Sekretariatit, është përgjegjëse për:

- vlerësimin e kërkesës për subvencion dhe analizës financiare të planbiznesit/projektit, që shoqëron dosjen që do të paraqitet Komisionit të Vlerësimit;

- për auditimin/vlerësimin e faturave origjinale dhe dokumentacionit mbështetës përpara se ato t'i paraqiten për firmë drejtorit të përgjithshëm për miratimin përfundimtar të pagesës.

16. Ngarkohet Komisioni për vlerësimin e ndërmarrjeve sociale për miratimin e formatit të:

1) formatit të aplikimit;

2) formularit standard në lidhje me kriteret e përjashtimit;

3) formatit të refuzimit/miratimit të aplikimit;

4) kontratës tip.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
**Ogerta Manastirliu**

**VENDIM**
**Nr. 97, datë 15.6.2020**

## MBI MIRATIMIN E "KODIT TË RRJETIT TAP"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 13; 15, pika 1, germa "a"; 16, pika 24 dhe nenit 108, të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të 13 korrikut 2009; rregullores së Parlamentit Evropian dhe Këshillit 942/2019, të datës 5 qershor 2019; rregullores së Parlamentit Evropian dhe Këshillit 715/2009, të 13 korrikut 2009, të ndryshuar me vendimin e Komisionit të 24 gushtit 2012, rregullores së Komisionit të BE-së 312/2014, të datës 26 mars 2014; rregullores së Komisionit të BE-së 2017/459, të datës 16 mars 2014; vendimit të Komisionit Evropian të datës 16 maj 2013, i cili përmban "Përjashtimin e tubacionit Trans Adriatik nga kërkesat për qasjen e palëve të treta, rregullimin e tarifave dhe ndarjen e pronësisë", të përcaktuara në nenet 9, 32, 41(6), 41(8) dhe 41(10) të direktivës 2009/73/EC; dispozitave të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë mbi aplikimin e përjashtimit të TAP AG, datë 6 qershor 2013, lëshuar nga autoritetet sipas direktivës 2009/73/EC, (Opinioni Përfundimtar i Përbashkët), nenit 4.7.1, të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët; dispozitat e rregullores 715/2009 dhe të kodeve evropiane të rrjetit të cilat nuk janë në konflikt me Opinionin Përfundimtar të Përbashkët; letra dërguar nga TAP AG më datë 20 dhjetor 2019; letra dërguar nga TAP AG më datë 10 qershor 2020; si dhe neneve 15 dhe 26, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.6.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi "Miratimin e Kodit të Rrjetit TAP",

konstatoi se:

- Në datën 1 shtator 2011, TAP AG paraqiti pranë Entit Rregullator të Energjisë (ERE) Shqipëri "Aplikimin e përjashtimit për gazsjellësin Trans Adriatik" sipas nenit 22, të direktivës së gazit 2003/55/EC;

- Në muajin qershor 2013, ERE, Ministria Italiane, dhe RAE morën vendimin e përjashtimit duke miratuar Opinionin Përfundimtar të Përbashkët (këtu dhe më poshtë "FJO") një dokument që është shkruar në mënyrë të përbashkët nga ARERA, RAE dhe ERE (këtu dhe më poshtë: "Autoritetet") dhe e ndryshuan për t'u pajtuar me vendimin e Komisionit [C (2013)2949 përfundimtar] datë 16 maj 2013 dhe morën parasysh Opinionin 1/2013 të

Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, datë 14 maj 2013;

- Sipas nenit 4.7.1, të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, TAP AG është e detyruar t'u paraqesë për miratim Autoriteteve: ERE, ARERA, RAE, "Kodin e Rrjetit të TAP"(TAP NC), jo më vonë se 12 muaj para datës së vendosjes në funksion;

- Sipas nenit 4.7.1, Kodi i Rrjetit duhet të pajtohet me të gjitha dispozitat e rregullores 715/2009 dhe të kodeve evropiane të rrjetit, të cilat nuk janë në konflikt me kushtet e Opinionit Përfundimtar të Përbashkët;

- Sipas detyrimeve të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, në datën 7 gusht 2018, TAP AG, hapi te faqja e internetit konsultimet publike për Kodin e Rrjetit të TAP;

- Në muajin gusht, TAP AG publikoi një raport, në faqen e tij të internetit, ku paraqiteshin të gjithë rezultatet e procesit të konsultimit;

- TAP AG paraqiti në mënyrë zyrtare Kodin e Rrjetit, tek Autoritetet, për miratim, në datën 20 dhjetor 2019, së bashku me komentet e marra nga "Raporti i Konsultimit publik";

- Të tre Autoritetet kërkuan nga TAP AG të modifikojnë propozimet, në mënyrë që të përafrohemi më shumë me dispozitat e TNC-së, në përputhje të plotë me dispozitat e FJO-së dhe legjislacionit evropian;

- Nëpërmjet një letre, më datë 10 qershor 2020, TAP AG dërgoi propozimin zyrtar mbi azhurnimin e Kodit të Rrjetit të TAP, ashtu si edhe tregohet në aneksin A2;

- Propozimi i përmendur në paragrafin e mëparshëm përfshin, ndër të tjera, angazhimin e kompanisë TAP AG (aneks 5 në TNC) për të azhurnuar dhe integruar TNC-në sapo të fillojë aktivitetin tregtar, veçanërisht në pjesët që kërkojnë realizimin e përvojës operative.

Duke pasur parasysh që:

1. Kodi i Rrjetit TAP përputhet plotësisht me legjislacionin evropian dhe është hartuar në referencë të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, është e përshtatshme që të aprovohet "Kodi i Rrjetit TAP" mbi bazën e opinioneve të ndara me rregullatorët e tjerë, përfshirë Italinë (ARERA) dhe Greqinë (RAE), së bashku me aneksin A1.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të miratojë, së bashku me Rregullatorët e Italisë (ARERA) dhe Greqisë (RAE), "Kodin e Rrjetit TAP", bashkangjitur me aneksin A1 (bashkëlidhur në gjuhën angleze dhe atë shqip).

2. T'i përcjellë këtë vendim shoqërisë TAP AG, Autoriteteve Rregullatore të Italisë (ARERA), Greqisë (RAE), Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (EnC), Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Autoritetit të Konkurrencës dhe shoqërisë Albgaz sh.a.

3. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht) ka përparësi, në rast mosdakordësie në interpretim nga palët, të versionit Shqip.

4. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

## VENDIM

(*i shkurtuar*)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 235 (64-2020-874), datë 22.5.2020, vendosi shpalljen e vdekjes në datën 1.1.2005 të shtetasit Haxhi Tata, i datëlindjes 30.10.1981.

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2020 - Numri: 121
Datë: 2020/06/30 14:38:15
114c61bf-71a3-46b6-9a5f-d09d63068fa3

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 476 lekë